Rruga e Arbërit

32 faqe

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11-12 (126-127). NËNTOR-DHJETOR 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Prej Radomirës në Virxhinia - **një dibran i suksesshëm**

Portret / **Lefter Daku**



8

Prej balte me qenë, prej Dibre të jesh

Piktori **Serxho Petrela** i parë me sytë e një miku



16

Urim Truka, njeriu që kurrë nuk i tha "Jo" punës

Nga **Osman Xhili**



10

NË BRENDËSI: ■ **Dibra**: Ç'po ndodh? Çfarë i duhet? ■ **Konti Gjuric Vladani**, komandant i shquar i ushtrisë së Skënderbeut ■ **Reka e Epërme** në Festivalin e Odës Dibrane ■ **Portret** me fjalë ■ **Jufkat**, tradita dhe biznesi i dibranëve ■ **Sohodoll** të qofshim falë, me breza drite e zemërbardhë ■ **100-vjetori** i shkollës shqipe në fshatin Burim (Allajbegi) në Maqellarë ■ **"Katër kongreset** kombëtare për alfabetin e shqipes" ■ **Mbrojtja** e specieve endemike të rrezikuara të florës në rrethin e Bulqizës ■ **Shpresa** të thyera… ■ **Qyteti** ku gurgullon Drini ■ **Dhjetë** pako kafe… ■ **Kënga** e Hajredin Pashës, "pasaporta" e çdo dibrani" ■ **Poezia** si derdhje e lirë imazhesh ■ **Prova** e besës ■ **Sonete** nga Naim Berisha ■ **Tinguj** qe thyhen ■ **Unë zgjedh** të jetoj pa dhunë ■ **Hasan Hoxha**, ndihmësmjeku që shëroi mijëra jetë njerëzish ■ **Bujar Pata**, 40 vite jetë në minierën e Bulqizës ■ Lamtumirë i dashur **Xhevat Spahiu** ■ Ndahet nga jeta Profesor Doktor **Agim Tërshana**

Vazhdimi i Rrugës së Arbrit duhet të fillojë nga Tuneli i Murrizës



- **Kemi hyrë në vitin e katërt të mandatit të kësaj qeverie dhe asnjë kazëm nuk është hedhur në Rrugën e Arbrit, ndonëse kur morën votat premtuan se brenda mandatit të tyre do ta përfundonin këtë rrugë.**
- **Kaluan mbi 20 vite kur pushtetarët e të dy krahëve kanë marrë votat, duke u tallur me komunitetin dibran, me premtimin se do të ndërtojnë Rrugën e Arbrit. Në fakt jo vetëm nuk e përfunduan ndërtimin e kësaj rruge por e kanë sabotuar këtë rrugë që në fillim e më tej duke vazhduar të ndërtojnë një trase jashtë standardeve të rrugëve të kohës.**

Dibranët kanë veç një ëndërr: Rrugën e Arbrit!

Dibra mbetet të zhvillohet me paratë e privatëve, ndërsa fondet publike kanë tjetër destinacion

Deputeti Përparim Spahiu: E gjithë ekonomia e Qarkut të Dibrës varej dje, por varet edhe sot, vetëm nga një projekt super i rëndësishëm, siç është Projekti i Rrugës së Arbrit, i cili ka mbetur edhe sot, vetëm një projekt dhe një aspiratë teorike.

Lexoni në faqet 2,3,4,6

INTERVISTË / **MEXHIT PRENÇI**



Tri arsye pse i kam mohuar ato që kam shkruar sipas metodës së realizimit socialist

- Një vepër e ideologjizuar dhe politizuar jeton aq kohë sa ideologjia që e lindi, me rënien e saj bie edhe vepra.
- Akoma edhe sot pas dy dekadash e gjysmë në demokraci, letërsia e realizmit socialist shpjegohet, analizohet dhe gjykohet po me ato kritere si në kohën e diktaturës, nga kritikë e studiues, por sidomos nga mësuesit e të gjitha niveleve gjer te universitetet. Kjo është e papranueshme, sipas meje.
- Dikush mund ta pëlqejë kritikën time, dikush jo. Kështu jam i kënaqur. Sipas meje, një libër që pëlqehet nga të gjithë nuk ka vlera të larta, sepse njerëzit janë të ndryshëm në perceptim, përjetim, në gjykim, shije, bindje dhe vlerësim. Unë njerëzit nuk i shoh si kope. Vlerësoj ata që gjykojnë me kokën e tyre dhe janë vetvetja. Po fatkeqësisht këta nuk janë shumicë.

Lexoni në faqet 14-15

Redaksia e gazetës Ju uron lexuesve, bashkëpunëtorëve, kontribuesve dhe donatorëve të gazetës, Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri! Qoftë një vit i mbarë për të gjithë!

cyan magenta yellow black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11-12 (127-128). Nëntor / Dhjetor 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se mermi përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Kontribuan për këtë numër:
Bashkim LLESHI
Përparim SPAHIU
Dionis XHAFA
Beqir SHEHU
Avni ALCANI
Agim BAÇI
Beqir SINA
Halil RAMA
Selami NAZIFI
Afrim KAROSHI
Besnik ALKU
Shuaip MARKU
Mevlud BUCI
Samet ZAGRADI
Ramazan S. ILNICA
Danjel BICA
Arsim KOLARI
Qazim SHEHU
Xhelal ROÇI
Naim BERISHA
Alban TUFA
Argen CIBAKU
Ilda MUKA
Ygerta GJELESHI
Besjana MAZARI
Flamur DARDESHI
Destan RAMA
Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Kemi hyrë në vitin e katërt të mandatit të kësaj qeverie dhe asnjë kazëm nuk është hedhur në Rrugën e Arbrit, ndonëse kur morën votat premtuan se brenda mandatit të tyre do ta përfundonin këtë rrugë.

Kaluan mbi 20 vite kur pushtetarët e të dy krahëve kanë marrë votat, duke u tallur me komunitetin dibran, me premtimin se do të ndërtojnë Rrugën e Arbrit. Në fakt jo vetëm nuk e përfunduan ndërtimin e kësaj rruge por e kanë sabotuar këtë rrugë që në fillim e më tej duke vazhduar të ndërtojnë një trase jashtë standardeve të rrugëve të kohës.

Nga **BASHKIM LLESHI**



Kam shkruar shumë për ecurinë e punimeve të Rrugës së Arbrit dhe pas artikullit të shkurtit të vitit 2016, mendova të mos shkruaj më duke menduar se i kam thënë të gjitha, por artikujt e botuar në këtë gazetë në muajin tetor 2016 më bënë të rikthehem përsëri për të përsëritur e për t'u rikujtuar disave se ç'është bërë me Rrugën e Arbrit, duke e theksuar që në fillim se puna për vazhdimin e Rrugës Arbrit duhet të fillojë nga Tuneli i Murrizës.

Kemi hyrë në vitin e katërt të mandatit të kësaj qeverie dhe asnjë kazëm nuk është hedhur në Rrugën e Arbrit, ndonëse kur morën votat premtuan se brenda mandatit të tyre do ta përfundonin këtë rrugë.

Kaluan mbi 20 vite kur pushtetarët e të dy krahëve kanë marrë votat, duke u tallur me komunitetin dibran, me premtimin se do të ndërtojnë Rrugën e Arbrit. Në fakt jo vetëm nuk e përfunduan ndërtimin e kësaj rruge por e kanë sabotuar këtë rrugë që në fillim e më tej duke vazhduar të ndërtojnë një trase jashtë standardeve të rrugëve të kohës.

Siç dihet pas shumë përpjekjeve të komunitetit dibran u arrit që të përfundohet Studimi i Fizibilitetit në vitin 2003 e të miratohet në Këshillin Kombëtar të Rrugëve në vitin 2004. Fushata e zgjedhjeve të 3 korrikut 2005 ishte fushata e katërt parlamentare e vendore ku elektoratit dibran si premtim kryesor i është bërë ndërtimi i Rrugës së Arbrit. Përsëri liderët e dy partive kryesore filluan premtimet e tyre se me të fituar zgjedhjet do të fillojnë nga puna për ndërtimin e rrugës. Lideri i së djathtës, Sali Berisha në mitingjet e mbajtura në Peshkopi theksonte se: *"Ju jap fjalën e nderit se po të fitojmë do t'a ndërtojmë Rrugën e Arbrit"*, ndërsa lideri i së majtës Fatos Nano theksonte se: *"Këtë rrugë e kam në axhendën time"*.

Punimet për ndërtimin e kësaj rruge u filluan keq dhe u vazhduan akoma më keq. Në fund të muajit qershor 2005, 4 ditë para zgjedhjeve të korrikut ish kryeministri Nano vendosi një tabelë dhe preu një shirit të fillimit të punimeve të kësaj rruge, në dalje të Bulqizës, në afërsi të Gurëve të Skënderbeut, duke u tallur me komunitetin dibran brenda e jashtë vendit, sepse jo vetëm se punimet pas një muaji u ndërprenë, por edhe nuk kishte projekt zbatimi dhe akoma më keq se aksi i rrugës sipas Studimit të Fizibilitetit të miratuar po nga Kryeministri në Këshillin Kombëtar të Rrugëve duhet të kalonte në anën tjetër të luginës në drejtim të lagjes Dragun.

Zgjedhjet e vitit 2005 i fitoi e djathta dhe për fatin e dibranëve ministër transporti u emërua një anëtar i komunitetit dibran, Lulzim Basha. U deshën edhe tre vite të tjera për të filluar projektin e zbatimit të segmentit Bulqizë - Ura e Çerenecit dhe të fillojnë punimet për ndërtimin e kësaj rruge në fillim të vitit 2008. Për çudi, megjithëse projekti i zbatimit të kësaj rruge është bërë nga studioja që ka bërë Studimin e Fizibilitetit, në projektet e zbatimit jo vetëm që nuk u bënë përmirësime, por përkundrazi janë bërë ndryshime të aksit të miratuar duke kaluar në rikonstruksion të rrugës ekzistuese. Kështu traseja e rrugës Bulqizë-Ura e Çerenecit nuk mund të quhet trase e Rrugës së Arbrit.

Punimet për ndërtimin e kësaj rruge u filluan keq dhe u vazhduan akoma më keq. Në fund të muajit qershor 2005, 4 ditë para zgjedhjeve të korrikut ish kryeministri Nano vendosi një tabelë dhe preu një shirit të fillimit të punimeve të kësaj rruge, duke u tallur me komunitetin dibran brenda e jashtë vendit, sepse jo vetëm se punimet pas një muaji u ndërprenë, por edhe nuk kishte projekt zbatimi. Zgjedhjet e vitit 2005 i fitoi e djathta por u deshën edhe tre vite të tjera për të filluar projektin e zbatimit të segmentit Bulqizë - Ura e Çerenecit dhe të fillojnë punimet për ndërtimin e kësaj rruge në fillim të vitit 2008. Ppr në projektet e zbatimit jo vetëm që nuk u bënë përmirësime, por përkundrazi janë bërë ndryshime të aksit të miratuar duke kaluar në rikonstruksion të rrugës ekzistuese. Kështu traseja e rrugës Bulqizë-Ura e Çerenecit nuk mund të quhet trase e Rrugës së Arbrit.

Nga viti 2008 e në vazhdim janë të njohura përpjekjet e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ku nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit" ka ngritur vazhdimisht shqetësimet se rruga po vazhdon të ndërtohet jashtë standardeve të kohës.

Në korrik të vitit 2009 filloi puna për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Vashës. Në intervistën që ka marrë gazetari Bujar Karoshi në shkurt të vitit 2009 në studion "Infratransprojekt Ltd" thuhet: *"... Me një tunel në Qafën e Buallit 847m. Ajo del në luginën e Planit të Bardhë duke vazhduar deri tek Ura e Vashës..." (Bujar Karoshi shkurt 2009)* Në vazhdim jo vetëm se nuk u zbatua asnjë afat për ndërtimin e këtij segmenti, por për tunelin e Qaf Buallit filluan diskutimet në se duhet hapur apo jo dhe më në fund ai nga 850m në studimin e fizibilitetit e 847m në projektin teknik të zbatimit u reduktua në 460m. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2011 kur tuneli duhet të kishte përfunduar, ai nuk kishte filluar akoma.

Edhe vazhdimi i rrugës nga Bulqiza në tunelin e Qafë Buallit pësoi ndryshime duke e diskutuar se mund të bëhet me ose pa tunel, se tuneli është në formacione të shkatërruara, etj. duke mos ju përmbajtur aksit të vendosur në Studimin e Fizibilitetit dhe duke bërë jo vetëm ndryshim të aksit duke e ngritur atë mbi varrezat e Bulqizës e duke bërë një usek të pa nevojshëm në mes të fushës për të rritur volumet. U ngrit niveli i hyrjes së tunelit nga Bulqiza, rrjedhimisht u zvogëlua gjatësia e tunelit të Qafës së Buallit, u zvarrit ndërtimi i tij me lloj-lloj justifikimesh, u vendos ky tunel në vendin

Standardet e rrugës janë pronë e çdo qytetari të komunitetit dibran e jo dibran, e çdo qytetari shqiptar.

Vazhdimi i Rrugës së Arbrit duhet të fillojë nga Tuneli i Murrizës

Për të justifikuar vonesat në fillimin e punimeve të këtij tuneli filluan të dalin nëpër intervista pushtetarë të lartë e "specialistë" ku flisnin për problemet gjeologjike e hidrogjeologjike, të cilat kushtëzuan ngritjen e nivelit të tunelit në lartësinë 950, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3000-3500ml, në rreth 2400ml. Pavarësisht nga problemet gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike që janë përdorur për të justifikuar këto vonesa, pretendimet e paraqitura deri tani për pengesat që mund të lindin nga ujërat e shumta që mund të dalin gjatë hapjes, apo për formacione të shkatërruara e të pakalueshme në hyrje e në dalje të tunelit nuk qëndrojnë.



Të heqësh dorë nga hapja e tunelit të Murrizës (qoftë edhe e përkohshme), në kurriz të prishjes së standardeve të rrugës, për "ti qarë hallet shtetit të varfër" është një veprim që nuk mund t'a bëjë asnjë studiues apo projektues rrugësh.

Në foto: Një segment i rrugës së Arbrit ndërtuar sipas "standardeve". Foto: B.Karoshi

më të papërshtatshëm, si dhe u zgjat traseja e rrugës poshtë Urës së vjetër të Vashës, me justifikimin për të lidhur edhe Klosin, sikur kjo rrugë po bëhët për të lidhur Dibrën me Klosin e jo me Tiranën e Durrësin.

Kaluan mbi 10 vjet nga përfundimi e miratimi i Studimit të Fizibilitetit dhe rruga e shumë premtuar nga politikanët në të gjitha zgjedhjet vendore e parlamentare nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2014 nuk arriti të vihet në rrugën e drejtë të zgjidhjes përfundimtare. Vonesat në ndërtimin e kësaj rruge, në vitet 2011-2013, shumë politikanë edhe të lartë në biseda e takime të ndryshme dhe në media janë munduar ti justifikojnë, jo me neglizhencat e papërgjegjshmërinë e tyre për sigurimin e fondeve, por me ndonjë arsye gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike, të sugjeruara nga ndonjë specialist jo kompetent e servil i pushtetit. *(Bashkim Lleshi dhjetor 2014)*

Edhe në zgjedhjet e vitit 2013 kryefjala e premtimeve para elektoratit dibran, të dy krahëve të politikës, ishte premtimi se do të përfundojnë Rrugën e Arbrit. Krahu i majtë që fitoi zgjedhjet premtoi se në vjeshtë do të fillojnë punimet, por iku edhe vjeshta e fundi i vitit 2013 ikën edhe vitet 2015 e 2016 dhe në rrugën e premtuar nuk u hodh asnjë kazëm. Bile qeveria e sotme për t'i dhënë gjoja rëndësi të veçantë kësaj rruge shpiku edhe një miratim ligji në parlament duke hartuar një ligj të veçantë, kur nuk ishte nevojë ligjore për t'u marrë kjo nismë dhe ligji përfundoi në koshin e plehrave.

Në gusht të vitit 2013 një grup pune i shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" kryen vrojtime nga Plani i Bardhë, Ura e Vashës deri në Tiranë dhe konstatuan se: *"Gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangie nga aksi i Rrugës së Arbrit." (Bujar Karoshi, Gazeta "Rruga e Arbërit" gusht 2013)* Shmangia më e madhe është ajo ku po hapet Tuneli i Qaf Buallit, e cila është trajtuar që në vitin 2008 e në vazhdim. *(Bashkim Lleshi 2008, 2013, 2016)*

Meqënëse hapja e tunelit të Qaf Buallit dhe fillimi i punimeve në objektet e tjera u ndërprenë për një kohë të gjatë, drejtuesit e dy shoqatave të "Lidhjes së Intelektualëve Dibranë" dhe "Nismës Dibrane", në mars të vitit 2014, i dërgojnë një relacion Ministrit të Transportit e Infrastrukturës dhe 6 deputetëve të Dibrës, ku propozojnë: *"...që për objektet e rëndësishme të kësaj rruge si, tunelet e Qaf Buallit e Qaf Murrizës dhe Urën e Vashës, të rishikohen e përmirësohen projektet e zbatimit, duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara..." (Nuri Abdiu, Bujar Karoshi, 2014)* Për këtë relacion, as nuk u dha ndonjë përgjigje dhe as nuk u thirr ndonjë specialist për ndonjë konsultim.

Në gazetën Rruga e Arbërit nr.10 (126) tetor 2016, Ing. Faruk Kaba propozon ndërtimin e një By-passi në Qafën e Murrizës, si duket për t'i "qarë hallin qeverisë" që nuk paska fondet e duhura për të hapur tunelin me dy gryka. Për këtë jam i detyruar t'i kujtoj projektuesit intervistën që i ka dhënë Gazetës "Rruga e Arbërit" nr. 9(41) shtator 2009, për tunelin e Murrizës ku citon: *"... Sidoqoftë ka qenë e nevojshme të kapërcehet Qafa e Murrizës me një tunel 3,5 km. të gjatë... Tuneli është projektuar të kalojë në kuotën 800-820m. Tuneli fillon në shtëpitë e sipërme të fshatit Murrizë, nga krahu i Tiranës dhe del në grykën e lumit të Mashnorit, pranë shtëpive të fshatit Xibër, poshtë shkollës së këtij fshati, në kuotë rreth 820m. mbi nivelin e detit... Vështirësia e tij shtohet po të kemi parasysh kushtet gjeologjike ku kalon ky tunel, të cilat janë nga më të dobtat.*

Të dalësh me propozime By-passesh do të thotë të vazhdosh prishjen e standardeve të kësaj rruge. Për këtë arsye, duhet t' i themi ndal këtij propozimi dhe jo t'a mbështesim, siç bën Shoqata "Bashkësia Dibrane" në reagimin e saj në Gazetën "Rruga e Arbërit" të tetorit 2016, në emër të Kryesisë dhe "Këshillit të Urtëve" të kësaj shoqate. Kryesia e kësaj shoqate bën mirë të mbështesë çdo individ e komunitet dibran e jo dibran që kërkon që kjo rrugë të bëhet me standarde, të cilët kanë të gjitha të drejtat për të ngritur zërin për standardet e kësaj rruge, se këto standarde nuk janë pronë e asnjë inxhinieri e projektuesi, që deri më tani e kanë shkatërruar këtë rrugë me veprimet ose mosveprimet e tyre, apo pronë e ndonjë individi apo shoqate të caktuar.

Për të përcaktuar pozicionin më të përshtatshëm të tij janë bërë tentativa të shumta dhe grupi i inxhinierëve është i besimit se ka gjetur opozicionin më të përshtatshëm..... Për tunelin e Murrizës janë paraqitur edhe dy variante të tjerë me tunele me gjatësi 3,6 dhe 4,2 km...." (Bujar Karoshi 2009)

Pas dy vitesh, për të justifikuar vonesat në fillimin e punimeve të këtij tuneli filluan të dalin nëpër intervista pushtetarë të lartë e "specialistë" ku flisnin për problemet gjeologjike e hidrogjeologjike, të cilat kushtëzuan ngritjen e nivelit të tunelit në lartësinë 950, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3000-3500ml, në rreth 2400ml. Pavarësisht nga problemet gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike që janë përdorur për të justifikuar këto vonesa, pretendimet e paraqitura deri tani për pengesat që mund të lindin nga ujërat e shumta që mund të dalin gjatë hapjes, apo për formacione të shkatërruara e të pakalueshme në hyrje e në dalje të tunelit nuk qëndrojnë. Këto pretendime unë i kam sqaruar në artikullin e botuar në dhjetor të vitit 2014 në gazetën "Rruga e Arbërit" : "Urojmë që fatin e Tunelit të Qafë Buallit të mos e pësojë Tuneli i Qafë Murrizës"*(Bashkim Lleshi dhjetor 2014)*

Të heqësh dorë nga hapja e tunelit të Murrizës (qoftë edhe e përkohshme), në kurriz të prishjes së standardeve të rrugës, për "ti qarë hallet shtetit të varfër" është një veprim që nuk mund t'a bëjë asnjë studiues apo projektues rrugësh. Të dalësh me propozime By-passesh do të thotë të vazhdosh prishjen e standardeve të kësaj rruge. Për këtë arsye,

(Vijon në faqen 4)

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit se për arsye teknike, numri i nëntorit dhe numri i dhjetorit do të dalin së bashku. Me këtë rast, duke u kërkuar ndjesë lexuesve për vonesën, njoftojmë gjithë abonetët se numrin e janarit do ta marrin falas.

Një abonim për vitin 2017 do të kushtoje 500 lekë dhe mund t'a ripërsërisni abonimin tuaj kur të merrni numrin e Janarit.

* * *

Redaksia falenderon kompaninë **KNAUF TIRANA** shpk dhe z. **Urim Murati** për sponsorizimin prej 60 000 lekësh të dhënë për botimin e gazetës.

* * *

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastef kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një dokument të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6** ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

Vazhdimi i Rrugës së Arbrit duhet të fillojë nga Tuneli i Murrizës

(Vijon nga faqja 3)

duhet t' i themi ndal këtij propozimi dhe jo t'a mbështesim, siç bën Shoqata "Bashkësia Dibrane" në reagimin e saj në Gazetën "Rruga e Arbërit" të tetorit 2016, në emër të Kryesisë dhe "Këshillit të Urtëve" të kësaj shoqate. Kryesia e kësaj shoqate bën mirë të mbështesë çdo individ e komunitet dibran e jo dibran që kërkon që kjo rrugë të bëhet me standarde, të cilët kanë të gjitha të drejtat për të ngritur zërin për standardet e kësaj rruge, se këto standarde nuk janë pronë e asnjë inxhinieri e projektuesi, që deri më tani e kanë shkatërruar këtë rrugë me veprimet ose mosveprimet e tyre, apo pronë e ndonjë individi apo shoqate të caktuar. Standardet e rrugës janë pronë e çdo qytetari të komunitetit dibran e jo dibran, pra të çdo qytetari shqiptar.

Standardet dhe hapja e kësaj rruge janë pronë edhe e Gëzim Alpionit dhe e atyre mijëra qytetarëve që e kanë përkrahur nismën e tij, ku me të drejtë në reagimin e tij në gazetën Rruga e Arbërit të muajit tetor 2016 thekson se: *"Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare... Ato inxhinierë dhe shoqata që acarohen me përpjekjet tona qytetare bëjnë mirë të acarohen me qeverinë që nuk po mban premtimet për ndërtimin e Rrugës me standarde bashkëkohore ...". (Gëzim Alpion, Rruga e Arbërit nr. 10(126) tetor 2016)*

Sa për dijeni të atyre që aludojnë se unë mund të jem në ndonjë grup lobimi, ju siguroj se nuk kam marrë pjesë në asnjë grup tjetër lobimi, jashtë përpjekjeve si individ dhe në kuadrin e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" e të Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në kohën e kryerjes së Studimit të Fizibilitetit të kësaj rruge, kur unë isha dhe anëtar i kryesisë së kësaj shoqate. Edhe me Gëzim Alpionin nuk njihem e nuk kam biseduar asnjë herë, sepse edhe atëherë kur ai erdhi në Tiranë dhe arriti të mbledhë të paktën për herë të parë deputetet e majtë e të djathtë për këtë rrugë, pavarësisht se mora pjesë në këtë takim, unë nuk pata rastin të bisedoj me të. Unë nuk jam as firmëtar i nismës së tij, se për këtë rrugë, ashtu si shumë dibranë të tjerë e kam ngritur zërin shumë vite më parë e vazhdoj ta ngre përsëri me forcë, por Gëzim Alpionin me mijëra firmëtarët e që e kanë mbështetur, i mbështes, se të ngresh zërin për ndërtimin shpejt e me standarde të kësaj rrugë jetike sidomos për dibranët këtej e matanë kufirit është një e drejtë e tyre dhe e çdo qytetari tjetër shqiptar.

Unë mbështes edhe propozimin e kompanisë "Gjoka Konstruksion" (pavarësisht se puna për hapjen e tunelit të Qaf Buallit e kryer nga kjo kompani le për të dëshiruar), apo edhe të ndonjë kompanie tjetër shqiptare që ka dëshirë të marrë përsipër kryerjen e pjesës së mbetur të rrugës. Por kjo nuk duhet të bazohet në projektet e deritanishme apo me propozime për ndërtim By-passe-sh, por me projekte të reja të tunelit të Murrizës me dy kalime (gryka), të tunelit të Gurit të Bardhë (me dy kalime) dhe të Urës së Vashës, jo në vendin ku e ka caktuar projekti aktual, por mbi Urën e Vashës, aty ku lugina e lumit është më e ngushtë dhe ku ura del më e shkurtër (sipas variantit të parë të studimit të Fizibilitetit).

Për t'u ribërë këto projekte duhet kohë, rrjedhimisht rruga nuk mund të fillojë para fundit të vitit 2017. Çdo përpjekje tjetër e kujtdo kompanie vendase apo të huaj, apo nisiativë qeveritare për të filluar me By-passe, pa paraqitur në komunitet transparencën e këtyre projekteve, do të ishte shkatërrim i Rrugës së Arbrit.

Unë mbështes edhe propozimin e kompanisë "Gjoka Konstruksion" (pavarësisht se puna për hapjen e tunelit të Qaf Buallit e kryer nga kjo kompani le për të dëshiruar), apo edhe të ndonjë kompanie tjetër shqiptare që ka dëshirë të marrë përsipër kryerjen e pjesës së mbetur të rrugës. Por kjo nuk duhet të bazohet në projektet e deritanishme apo me propozime për ndërtim By-passe-sh, por me projekte të reja të tunelit të Murrizës me dy kalime (gryka), të tunelit të Gurit të Bardhë (me dy kalime) dhe të Urës së Vashës, jo në vendin ku e ka caktuar projekti aktual, por mbi Urën e Vashës, aty ku lugina e lumit është më e ngushtë dhe ku ura del më e shkurtër (sipas variantit të parë të studimit të Fizibilitetit).

Për t'u ribërë këto projekte duhet kohë, rrjedhimisht rruga nuk mund të fillojë para fundit të vitit 2017. Çdo përpjekje tjetër e kujtdo kompanie vendase apo të huaj, apo nisiativë qeveritare për të filluar me By-passe, pa paraqitur në komunitet transparencën e këtyre projekteve, do të ishte shkatërrim i Rrugës së Arbrit.

Në rast se rruga nuk fillon me tunelin e Murrizës e të Gurit të Bardhë dhe Urën e Vashës (mbi urën e vjetër të Vashës) më mirë të mos fillojnë punimet për vazhdimin e përfundimin e kësaj rruge. Shteti të heqë dorë nga kjo rrugë dhe t'u lihet vetë dibranëve t'a zgjidhin vetë financimin e ndërtimin e saj.

B.LLESHI

Tiranë, nëntor 2016

KOMENT

Dibranët kanë veç një ëndërr: Rrugën e Arbrit!

Nga **SAMET ZAGRADI**

Dibra është një zonë e varfër në lindje të Shqipërisë, me një popullsi afro 87,000 banorë, me një sipërfaqe prej 761 km katror dhe që ka si qendër qytetin e Peshkopisë. Ka një reliev kryesisht malor. Ajo kufizohet në lindje me republikën e Maqedonisë dhe Kosovës, në veri me Kukësin, në perëndim me Mirditën dhe në jug me Bulqizën.

Kjo zonë është një nga zonat më të varfra të Shqipërisë, me një ekonomi poshtë minimales se jetesës. Ekonomia e kësaj zone mbahet kryesisht nga emigracioni dhe nga bujqësia e blegtoria duke pasur një reliev të përshtatshëm. Lidhja me kryeqendrën e Shqipërisë është mjaftë e vështirë,duke ndjekur një intenerar mjaftë të lodhshëm dhe të rrezikshëm. Këto banorë duhet të përshkruajnë rreth 180 km përmes shtigjeve të rrezikshme si ajo e "Qafës se buallit" rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Intenerari për të vajtur në Tiranë është sa torturues aq dhe gjatë. Banorët e kësaj zone duhet të kalojne,qytetin e Bulqizes,Klosit,Burrelit, më pas Milotit,Fushe Krujes.

Ndërtimi i kësaj rruge do ishte me të vërtetë një shpëtim për të gjithë këtë trevë duke sjelle zhvillimin jo vetëm të kësaj zone por edhe një përmirësim të marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë. Ky aks shkurton ndjeshëm distancën mes Tiranës dhe Peshkopisë, ul lartësinë mbi 1000 metra mbi nivelin e detit si dhe do të jetë një variant me kushte më të mira gjeologo-inxhinierike e hidrologjike.

Dibra është në vetvete një hangar i prodhimeve bujqësore e blegtorale. Në mungesë të rrugës,të gjithë këto prodhime destinacion kanë mbetjen stok e më pas hedhjen e tyre duke çuar dëm një vit punë të fshatarit dhe një deficit ekonomik të kësaj zone. Ndërtimi i "Rrugës se Arbrit" do t'u jepte frymëmarrje tregut bujqësor dhe blegtoral, si dhe do të kthente banorët që me të drejtë janë zhvendosur me banim në zonat më të zhvilluara kryesisht, Durrësi dhe Tirana. Dibranët shquhen për njerëz të punës dhe mjafton të bëhet rruga, Dibrën do ta zhvillojnë ato.

Peshkopia është një qytet jo i madh por me pasuri natyrore dhe turistike për të pasur zili. Ëndrra e dibranëve, "rruga e Arbrit" do t'i jepte një bum të madh turizmit dhe ekspozimit të vlerave morale dhe kulturore që gëzon kjo treve. Mali i Korabit, mali me i lartë në Shqipëri, me bukuri përrallore, parku kombëtar i Lurës si dhe liqenet e saj, kanionet e mrekullueshme të lumit Drin, traditat dhe ushqimet unike të tradicionale, do ishin një vitrinë mjaftë e mirë për promovimin e kësaj treve, që do sillte një zhvillim të madh ekonomiko-kulturorë. Llixhat e Peshkopisë janë të vetmet më të mëdha në Ballkan me ujin e tyre termal dhe kurativ janë burim i madh të ardhurash. Në rast se kjo rruge ndërtohet ekonomia shumëfishohet.

Rruga e Arbrit, vetëm 75 kilometra do të lidhë Tiranën më Peshkopinë dhe Dibrën e Madhe - Maqedoninë. Kjo rrugë fillimin e saj e ka në qendër të Tiranes, përgjatë Rrugës së Dibrës për të arritur në Brar dhe kaluar shkallën e Tujanit, luginën fantastike të Brarit, në luginën e ngushtë të malit të Dajtit, në kanionet magjike të ngushtë e të thellë. Rruga përshkon luginën malore të Shpatit, Murrizës, nga ana e Tiranës duke dalur në anë të lumit të Matit mbi urën e Vashës dhe pasi kalon luginën e Planit të Bardhe dhe tunelit të Qafës së Buallit del ne luginën e mirënjohur të Vajkalit, Zallit të Bulqizës, Zerqanit deri në fushën e Gjoricës të pellgut të Dibrës dhe për të vazhduar deri në Dibër të Madhe.

Kjo rrugë do të kishte një ndikim shumë të madh dhe në thithjen e investitorëve të huaj, duke ngritur fabrika mineralesh, fabrika te përpunimit të pemëve frutorë dhe investime te rangjeve te ndryshme. Lidhja me Maqedoninë nëpërmjet kësaj rruge do të ishte një plus akoma më i madh, jo vetëm për Dibrën, por për të gjithë shtetin shqiptar. E thënë me pak fjalë, që ëndrra e të gjithë dibranëve është shpëtimi nga kjo gjendje dhe ky shpëtim e ka emrin vetëm "Rruga e Arbrit"

Rruga e Arbërit nr. 127 128

DIBRA opinion

Ç'po ndodh?

Nga **BESNIK ALKU**

Këto ditë kam ndjekur dy evente me njerëz të shquar dibran, siç ishte datëlindja e artistit dhe njeriut legjendë Kadri Gjapi, që në një mënyrë "bukovskiane" festonte nën shoqërinë e legjendës tjetër dibrane Fit Shehun, dhe morën shumë urime nga anë e mbanë botës kudo që ka dibranë. Eventi i dytë ishte promovimi në Tiranë i librit të dy bashkautorëve dibranë, Haki Përnezha dhe Ruzhdi Bitri, për toponiminë e Çidhnës, dhe ku shumë dibranë që ishin në Tiranë, uruan autorët për studimin dhe botimin. Tek ndiqja këto evente shikoja një vlerësim dhe interesim për këto legjenda dhe vlera të Dibrës nga dibranët që nuk banojnë në Dibër, por jetojnë dhe mendojnë për Dibrën anekënd Shqipërisë dhe botës. Vërej një indiferentizëm nga elita, intelektualët, institucionet por edhe nga dashamirësit që jetojnë në Dibër për vlerat dibrane në përgjithësi dhe legjendat në veçanti.

Tek po mendoja këto, me sy dyshues, kritik, i pezmatuar, mendova se përse ndodh një gjë e tillë? A ka diçka në këtë mes? A ka grupe apo qarqe të interesuara që Dibra të jetë e prapambetur? A kanë faj dhe gabim vetë dibranët për këtë situatë?

Prandaj po bëhem dyshues edhe kritik.

- Dyshues për një politikë të qëllimshme që Dibra të jetë e prapambetur (model i të keqes): Një zonë e pa zhvilluar ku zhvillimi ka ngecur në vend (ka mbetur ora), dhe ndeshemi me fenomene të varfërisë, ekonomi jo-stabël, regjime politike despotike, administrim pushteti nga klane dhe grupe kriminale.

- Dyshues që qëllimisht Dibra të jetë e izoluar. Dibra e vogël dhe Dibra e madhe kanë mbetur si xhepa, me aksesin më të keq rrugor në Shqipëri dhe Maqedoni. Rruga e Arbërit është një legjendë që ndërtohet në fushata elektorale dhe prishet në qeverisje. Janë marrë aq shumë borxhe dhe kredi nga shteti shqiptarë, por asnjë cent për rrugën e Arbërit, por vetëm për fasada dhe banjot e institucioneve, rrugët e fshatrave të Vlorës, dhe për dibranët mjaftojnë përrallat me investitorë kinez, arab apo dhe mirditorë.

- Dyshues që Dibrës i fabrikohen dhe i tipizohen skandale; e gjithë Shqipëria është plotë me skandale, por ato duken normale. Nëse ndodh një skandal në Dibër ai trumpetohet me të madhe duke përfshirë në skandal gjithë popullsinë dibrane, dhe tipizuar zonën si problematike.

Unë jam kritik ndaj pjesës elitare, intelektuale, qeverisëse, biznesit, artisteve dhe familjeve dibrane për këtë situatë që është Dibra:

- Elita politike dibrane është e fjetur dhe e pazonja, mjafton të shikosh përfaqësimin politik që i bëhet Dibrës në parlament (ku asnjë nuk e din kush është deputet, ose deputet të importuar). Dibra shikohet si zonë e lirë ku kanë gjetur shesh dhe bëjnë përshesh "matrapazët" politikë, bëjnë pazare duke blerë dhe shitur vota.

- Intelektualët, artistët, mësuesit dibranë janë në mjerim. Përdoren dhe flaken mes katër rrugëve sikur mos ishin asgjë. Mungojnë iniciativat, krijimet, forumet, simpoziumet, studimet dhe respekti mes vetit, vlerësimi për njëri tjetrin, duke mbetur peng i zilive dhe xhelozive të vogla, që më shumë përfundojnë në fjalë mejhanesh dhe rakie me vezë.

- Rinia dhe familjet dibrane po orientohen nga prapambetja dhe fanatizmi. Në shumë familje dibrane po instalohet fanatizmi islamik i krahëve ekstreme, që nuk kanë asgjë të përbashkët me fenë dhe kulturën islame. Shumë inate dhe mosmarrëveshje duke mos arritur të shikosh asnjëherë 3 njerëz bashkë, edhe nëse i shikon bashkë nuk u shkon më shumë se 3 muaj. Mungesa e shkollave cilësore, kurseve të formimit profesional, universitetit, rinia dibrane po orientohet nga hashashi dhe "qentë e racës" duke krijuar modele për një rini "milloshe" dhe ku të mirët dhe të shkolluarit shihen me sy nënvlerësues dhe përçmues.

U zgjata si shumë por ishte diçka që më ngacmonte nga brenda këto ditë eventesh nëntori. Fajin e ka Kadri Gjapi, Fit Shehu dhe legjendat dibrane.

Elita politike dibrane është e fjetur dhe e pazonja, mjafton të shikosh përfaqësimin politik që i bëhet Dibrës në parlament (ku asnjë nuk e din kush është deputet, ose deputet të importuar). Dibra shikohet si zonë e lirë ku kanë gjetur shesh dhe bëjnë përshesh "matrapazët" politikë, bëjnë pazare duke blerë dhe shitur vota.



Foto © Edmond Hasani

Çfarë i duhet!

Nga **SHUAIP MARKU**

Shumë oferta premtime, reklama shohim këto ditë, por çka në të vërtetë kërkojnë dibranët?

Dibranët nuk kërkojnë luks, jo asnjëherë!

Janë zgjedhje kur zgjidhen deputetët që do të sjellin ligje në Parlament, dhe do të formohet qeveri e re, qeveri e cila do të menaxhojë paratë e qytetarëve, pra janë zgjedhje politike e jo lokale.

Çka u nevojitet Dibranëve?

- Duan që ajo Qeveri që të formohet së pari ta sistemojë deponinë e mbeturinave në Dibër që dibranët të paktën ta marrin ajër të pastër.

- Dibranët duan që Qeveria e re të sjellë ujin në fushën e Dibrës, që dibranët të mund ta punojnë tokën bujqësore që sjell disa miliona euro të ardhura për bujqit.

- Dibranët kërkojnë nga Qeveria e ardhshme të ndërtojë rrugët sipas standardeve, të marrë masa për mbrojtjen e udhëtarëve nga rënia e gurëve dhe orteqeve në rrugën Dibër-Mavrovë.

- Dibranët duan që të hapet një terminal doganor në kufirin e Bllatës dhe të bëhet liberalizim i tregtisë së prodhimeve vendore në mes dy Dibrave.

- Të iniciojë qeveria projekt për ndërtimin e pjesës sonë të Rrugës së Arbërit.

- Nga Parlamenti kërkojnë që të sjellë vendim për Stopimin e të gjitha ideve dhe projekteve për devijimin e Radikës.

- Nga Qeveria kërkojnë që të kthejnë kompetencat e institucioneve vendore dhe jo të gjitha kompetencat për Dibrën t'i kenë qytetet përreth.

- Nga Qeveria e re kërkojnë që të ndajë mjete të mjaftueshme për mirëmbajtjen e shkollave dhe kushteve në shkolla, si nxehja, kabinete etj...

- Po nga Qeveria e re kërkojnë të rifunksionojë fakulteti edhe atë si fakultet i vërtetë me cilësi.

- Dibranët kërkojnë që të mos jenë viktimë e aksioneve të Drejtorisë së të ardhurave publike e të dënohen me dënime drakonike, që po e shkatërrojnë biznesin në Dibër. Parlamenti i ri të ulë vlerën e dënimeve në rol të përmirësimit dhe jo të ketë qëllim mbushjen e buxhetit prej dënimeve ndaj qytetarëve

- Pronarët e pyjeve kërkojnë që të mund të presin dru për nevojat e familjes në zabelet e veta pa paguar e bërë elaborate e shpenzime tjera.

- Dibranët kërkojnë që banorët e zonave përreth kufirit nga Peshkopia të mos dënohen nga policia sepse ata janë konsumatorët më të mirë të bizneseve të Dibrës

- Dibranët kërkojnë që të ndahen fonde për shëndetësinë dhe qendrën medicinale e cila nuk arrin t'i përmbushë interesat e pacientëve.

- Dibranët kërkojnë që ndihma sociale të jetë ndihmë jo lëmoshë, të paktën t'i mbulojë shpenzimet minimale për mbijetesë të familjeve sociale.

- Dibranët kërkojnë që për liqenin dhe gjuetinë në territorin e Dibrës të vendosën vetë Dibra dhe jo nga Shkupi.

- Qeveria të mbështesë kulturën në Dibër, mbrojtjen e monumenteve kulturore.

- Qeveria të punësojë dhe emërojë drejtues dhe administratorë sipas aftësive dhe jo sipas partive dhe miqësisë.

Këto, dhe shumë nevoja tjera që i janë marrë apo nuk i janë dhënë Dibrës, këto duam të dëgjojmë t'i sigurojnë partitë që do jenë në Qeveri!

Aspak nuk na interesojnë sharjet, problemet personale, historitë, e kaluara, soji, fuqia ...

Dibranët duan që Qeveria e re të sjellë ujin në fushën e Dibrës, që dibranët të mund ta punojnë tokën bujqësore që sjell disa miliona euro të ardhura për bujqit.

- Dibranët kërkojnë nga Qeveria e ardhshme të ndërtojë rrugët sipas standardeve, të marrë masa për mbrojtjen e udhëtarëve nga rënia e gurëve dhe orteqeve në rrugën Dibër-Mavrovë.



Foto © Gazmend Kërkuti

Dibranët kërkojnë që banorët e zonave përreth kufirit nga Peshkopia të mos dënohen nga policia sepse ata janë konsumatorët më të mirë të bizneseve të Dibrës.

Rruga e Arbërit nr. 127 128
koment

Përparim Spahiu: E gjithë ekonomia e Qarkut të Dibrës varej dje, por varet edhe sot, vetëm nga një projekt super i rëndësishëm, siç është Projekti i Rrugës së Arbrit, i cili ka mbetur edhe sot, vetëm një projekt dhe një aspiratë teorike.

Dibra mbetet të zhvillohet me paratë e privatëve, ndërsa fondet publike kanë tjetër destinacion



Nga **PËRPARIM SPAHIU***

"Profili im politik por dhe si ekonomist nuk ma lejon më që të kërkoj financime shtesë për zhvillime të sektorit të bujqësisë, frutikulturës, blegtorisë, apo turizmit, sepse do ishte thjesht një hipokrizi, të cilën unë personalisht e refuzoj.

Le të themi të vërtetën dhe të mos i fshihemi kësaj të vërtete!

E gjithë ekonomia e Qarkut të Dibrës varej dje, por varet edhe sot, vetëm nga një projekt super i rëndësishëm, siç është Projekti i Rrugës së Arbërit, i cili ka mbetur edhe sot, vetëm një projekt dhe një aspiratë teorike.

Këtë e nënvizuan edhe eksponentë të lartë të Bashkimit Europian, që para pak ditësh e vizituan atë zonë dhe premtuan se edhe ata do të lobonin për ndërtimin e saj.

Pyetjes sime se përse nuk parashikohet asnjë fond në buxhet për këtë rrugë, që është jetike dhe është një arter i rëndësishëm zhvillimi për një zonë shumë të varfër dhe të gjerë, ministri i financave ju përgjigj se, sipas tij , ajo do të ndërtohej me paratë e privatëve, PPP (Partneriteti Publik Privat) dhe na dha sigurinë maksimale që punimet fillojnë pranverën e ardhshme, kjo edhe sipas premtimit të ministrit të ri të transporteve.

Kam përshtypjen, e qofsha i gabuar, se kjo zonë mbetet të zhvillohet vetëm me paratë e privatëve, ndërsa fondet publike kanë tjetër destinacion. Kjo mbetet sidoqoftë një hamendje jo vetëm e imja , por edhe e votuesve të këtyre zonave, e ne si parlamentarë na mbetet të punojmë për ta bërë të paqenë këtë hamendje.

Gjatë kësaj periudhe kam shprehur shqetësimin tim sa u takon investimeve të të ashtu quajturit Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Kam vëzhguar me vëmendje aktivitetin 3 vjeçar të këtij Fondi.

Dhe nuk e kuptoj se përse një Fond Zhvillimi nuk ka investuar pikërisht në zonat më pak të zhvilluara???

Apo kemi të bëjmë me një Fond Zhvillimi që merret vetëm me zhvillimin e zonave më të zhvilluara?

Madje, dhe ato investime që janë bërë, nuk kanë shkuar në ndihmë të infrastukturës, aq e nevojshme për zhvillimin ekonomik!

Krijimit të kushteve minimale për investitorë potencialë të brendshëm dhe të huaj, u duhet kushtuar më shumë vëmendje e kujdes sepse kjo do të sillte më shumë punësim, e si rrjedhojë, më shumë konsum, më shumë kontribute sociale, më shumë sigurime shoqërore, më pak shpenzime të ndihmës sociale.

Buxheti i orientuar drejt turizmit dhe bujqësisë është i pamjaftueshëm krahasuar me 5% -in e GDP-së që patëm premtuar.

Unë dëshiroj të përfitoj nga seanca e sotme, për ti thënë publikut se këtë buxhet e gjykoj të logjikshëm, por kam jo pak pikëpyetje se përse ende Turizmi dhe Bujqësia dhe potencialet që ato mbartin, nuk reflektohen në lartësinë e duhur.

Në bindjen time, të dy këta sektorë, kanë kthyeshmërinë më të lartë të investimeve publike. Dhe janë dy sektorë strategjikë! Potenciali që kanë Turizmi dhe Bujqësia në rritjen e të ardhurave dhe në gjenerimin e vendeve të punës, duhet të nxiste më shumë vëmendje në këtë projekt buxhet.

Ka ftesa të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, së fundmi edhe në takim me diasporën, drejt investitorëve të huaj. Mirëpo paralel shtimit të ftesave, duhet menduar po aq, edhe për përmirësimin apo krijimin e kushteve lehtësuese dhe favorizuese për to.

Në këtë pikë, mesa duket, ky vit s'do njohë ulje taksash, por nisur nga sa ministri u shpjegoi kolegëve deputetë të Kominsionit të Ekonomisë, do të synohet mbledhja e tyre në një nivel më të lartë.

Ky duket një objektiv i arsyeshëm, paçka se tatimi 15% i fitimit mbetet një kërkesë e kahershme imja për t'u riparë, dhe për t'u rishikuar në drejtim të uljes, një çështje e rëndësishme për të tërhequr investitorët përmes krijimit të kushteve konkurruese në rajon.

Duke theksuar faktin, se përpjekjet për të rritur të ardhurat buxhetore nga tatimet dhe doganat nëpërmjet aksioneve, në një farë mase mund të quhen të dështuara sepse nuk arritën pritshmëritë e dëshiruara.

Sfida për uljen e borxhit publik dhe realizimi i objektivit për nje rritje ekonomike deri në 3.8% duhet të vlerësohen tek ky buxhet, si të mundshme, dhe të cilët unë personalisht i shoh si të realizueshme

Përshëndes me entuziazëm, rritjen e pagava, madje unë personalisht, do të inkurajoja për një rritje të mëtejshme të tyre, edhe pse mund të çojë në uljen e investimeve. Është e papranueshme të kemi pagat më të ulëta të mësuesve, mjekëve, pedagogëve, akademikëve, diplomatëve apo edhe politikanëve në rajon.

Nëse në vitin e parë morëm përsipër pagesën e borxheve të prapambetura, them që pagat e vogla në Shqipëri, janë një borxh i hershëm i të gjitha qeverive.

Sepse nuk besoj që Reformat do të mund të jenë funksionale, nëse vazhdohet dhe paguhet në këto nivele kaq të ulëta.

Sepse nuk besoj se qytetarët do të gjejnë shërbime cilësore në shkolla, spitale dhe deri tek drejtësia, me një sistem pagash të këtyre niveleve.

Unë do ta votoj "Pro" buxhetin, pasi kemi një marrëveshje politike për të vepruar kështu! Por edhe pse buxheti i këtij viti ka një qasje ndryshe dhe paraqitet i përmirësuar, krahasuar me vitiet e shkuara, dhe kemi më në fund një rritje pagash, tërheq vëmendjen për një përkushtim financiar më serioz në lidhje me sektorin e bujqësisë dhe të turizmit."

** Deputet i Dibrës. Fjalë e mbajtur gjatë seancës parlamentare gjatë miratimit të Buxhetit të Shtetit 2017. Marrë nga www. 360grade.al*

Pyetjes sime se përse nuk parashikohet asnjë fond në buxhet për këtë rrugë, që është jetike dhe është një arter i rëndësishëm zhvillimi për një zonë shumë të varfër dhe të gjerë, ministri i financave ju përgjigj se, sipas tij, ajo do të ndërtohej me paratë e privatëve, PPP (Partneriteti Publik Privat) dhe na dha sigurinë maksimale që punimet fillojnë pranverën e ardhshme, kjo edhe sipas premtimit të ministrit të ri të transporteve. Kam përshtypjen, e qofsha i gabuar, se kjo zonë mbetet të zhvillohet vetëm me paratë e privatëve, ndërsa fondet publike kanë tjetër destinacion. Kjo mbetet sidoqoftë një hamendje jo vetëm e imja , por edhe e votuesve të këtyre zonave, e ne si parlamentarë na mbetet të punojmë për ta bërë të paqenë këtë hamendje.

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603





Reka e Epërme në Festivalin e Odës Dibrane

Më datë 19.11.2019 në natën e tretë të Edicionit të 22-të të Festivalit Ndërkombëtar ODA DIBRANE 2016 të mbajtur në Peshkopi, grupi i SHK Reka e Epërme nga Gostivari për herë të parë mori pjesë në një festival me 40 të rinj të udhëhequr me Emin Xhaferin, Adnan Aliu dhe Qefli Ismaili.

Me ritëm darsme, melodi me kafal e gajde të përkrahur me harmonikë si dhe vallet e bukura të darsmës së Rekës së Epërme, juria profesionale e vlerësoi me dy çmime edhe atë për ritin e darsmës së Rekës dhe kostumet popullore dhe si e dyta në festival u shpërblye me Diplomë dhe pllakatë të festivalit.

Edhe pse për herë të parë morëm pjesë në skenë festivali, interpretimi ishte i përkryer.

Duartokitjet e ngrohta dhe vlerësimi i jurisë për këta të rinj u jep vullnet që të vazhdojnë edhe më tej të prezantojnë kulturën, traditën, muzikën dhe veshjen e bukur të Rekës së Epërme.



Falenderojmë jurinë për vlerësim objektiv, ndërsa Dibrën e Vogël, por me zemër të madhe për mikpritjen dhe duartrokitjet që na dhanë.

Po ashtu, falenderojmë sponsorët dhe grupin tonë për seriozitetin e treguar dhe frymën e tyre garuese, që na gëzuan me këto çmime mjaft të vlerësuara për ne dhe Gostivarin.

Vlen të ceket angazhimi il palodhëshëm i Emin Xhaferit, të përkrahur nga Adnan Aliu, Qefli Ismaili, Sadri Selmani, Luan Bilali dhe Ahmed Tairi, që me pjesëmarrjen e tyre në skenë treguan dashurinë për Rekën e Epërme.

Grupin në Festival e ndoqën edhe Kryesia e SHK Reka e Epërme me Xhelil Rufatin, Tafë Ameti, Bardhyl Miftari dhe disa dashamirë tjerë të kulturës dhe artit.

Kryesia e SHK REKA E EPËRME
Gostivar

mjedis

Mbrojtja e specieve endemike të rrezikuara të **florës** në rrethin **e Bulqizës**

Nga **Danjel BICA***

Shoqata e Ekspertëve të Rinj Mjedisor (SHERM) në bashkëpunim me FKPKK gjatë periudhës Dhjetor 2015 – Nëntor 2016 ka zbatuar projektin me temë: "Mbrojtja e specieve endemike të rrezikuara të florës në rrethin e Bulqizës", në kuadër të projektit Econord të zbatuar nga Fondacioni Shqipatar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF) dhe të financuar nga Delegacioni Evropian në Shqipëri.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi i të kuptuarit gjithëpërfshirës mbi mbrojtjen e natyrës përmes pjesëmarrjes së komunitetit, duke siguruar përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mirëqenie sociale. Zona e synyar e projektit ka qene Rrethi Bulqize ku janë përzgjedhur pesë zona specifike të synuara (Zerqan, Fushë Bulqizë, Ostren, Klenjë, Trebisht), fokusi tematik Biodiversiteti, Mjedisi, Lobimi dhe përfituesit janë: Komuniteti, burrat, gratë, të rinjtë, fëmijët, qeverisja vendore dhe qendrore.

SHERM në bashkëpunim me Federatën Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale (FKPKK), organizoi më datë 23.11.2016 një Konferencë Rajonale "Mbrojtja e specieve endemike të rrezikuara të florës në rrethin e Bulqizës", ku të pranishëm ishin palët e interesuara nga zonat e synuara të Projektit Eco-Nord (Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër). Morën pjesë përfaqësues të CNVP, të Federatave të Qarkut Lezhë, Dibër, përfaqësues të Inspektoriatit shtetëror të Pyjeve, përfaqësues të ARZM të qarkut Dibër, përfaqësues të Bashkisë Bulqizë, Shoqatat e Pyjeve dhe kullotave Bulqizë. Pjesëmarrësit u informuan për ecurinë e projektit Eco-Nord dhe gjetjet në terren nga ekspedita fushore, trajnimi i femerëve dhe edukimi mjedisor me nxënësit.

Gjatë diskutimeve u sollën në fokus shqetësimet për mangësitë në planifikim, avantazhet e bashkimit të fermerëve dhe bashkëpunimit për të cilin kërkohen forma të reja të organizimit shoqëror. Akoma nuk ka politika të qarta për Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA), ka mbishfrytëzim e mbikullotje, nuk ka mbështetjen e duhur me investime për rritjen e zinxhirëve të vlerës, mungojnë qendrat e grumbullimit, kushtet për tharjen dhe përpunimin, ambalazhimin, e certifikimin etj.

Nga të pranishmit u propozua një strategji rajonale për BMA që është me rëndësi për të ardhmen, për të përmirësuar gjendjen. Bashkëpunimi mes aktorëve kryesorë është i rolit thelbësor për të siguruar mbrojtje, cilësi dhe qëndrueshmëri në aktivitetin e grumbullimit të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike. Industria e grumbullimit të bimëve aromatike dhe mjekësore vuan nga cilësia e ulët dhe paqëndrueshmëria, kryesisht për shkak të organizimit të brendshëm të saj. Mungesa e kontratave paraprake në tërë zinxhirin e vlerës, importues – eksportues – grumbullues – vjelës, kryesisht për të mbajtur të ulur çmimin, ka sjellë marrdhenie tregtare sporadike, afatshkurtra, duke bërë të pamundur trajnimin e vjelësve për metodat e vjeljes, tharjes dhe ruajtjes, të cilat kryhen nga këta të fundit.



Fermeri e mbledh, e than dhe tregton bimën në kushte të këqija që bën të mundur uljen e cilësisë së bimës. Në Bashki nuk ka të ngritur nje sektor për bimët mjekësore ose kullotat që të trajtohen të ndara me pyjet.

Dy janë pronarët, Bashkia dhe Zonat e Mbrojtura, që pjesa e zbatimit të ligjeve është e nevojshme. Federata e Pyjeve Dibër vlerëson punën e SHERM dhe është e gatshme të bashkëpunojë dhe me ZM Dibër për Bimët Mjekësore dhe Aromatike.

CNVP falenderoi Shoqatën e Ekspertëve të Rinj Mjedisor (SHERM) për ndarjen e informacionit në faqet e saj me publikime për punën që ka bërë dhe për ndërhyrjet në terren që e adresojnë çështjen që në themel, duke punuar me komunitetin dhe rininë që do jenë e ardhmja, duke i edukuar për ndjenjën e përgjegjësisë që ata kanë për mjedisin. Ky manual do t'i shërbejë më tej komunitetit, fermerëve, shkollave, dhe të gjithë rajoneve.

SHERM po ngre zërin për një Strategji Rajonale të BMA, duke marrë në konsideratë edhe potencialet e vështirësitë e zonës. Mbetet shqetesues bashkëpunimi me strukturat shtetërore për analizën dhe studimin e BMA dhe vështirësitë që hasin fermerët, kryesisht për mbështetjen me subvencione.

Nga mbledhja e bimëve 20% duhet të lihet për rigjenerim. Në Bulqizë u nda eksperienca e Kosovës dhe ne duhet të marrim modele nga vendet fqinje.

** Shoqata e Ekspertëve të Rinj Mjedisor (SHERM)*

Lefter Daku një nga ekspertët botërorë të arsimit universitar

Prej **Radomirës** në Virxhinia

Nga **Afrim KAROSHI**

Historia e suksesit të Genti Dakut, një djali të ri me origjinë nga Dibra, mori udhë në Gazetën *Rruga e Arbërit* në verën e vitit 2015. Dhe pas këtij momenti, sukseset e Gentit – marrja e medaljes nga Presidenti amerikan, si një nga 160 maturantët më të mirë të të gjithë Amerikën, e drejta për të vazhduar studimet në Universitetin e Harvardit dhe krijimi i Shoqatës *Albanian Foundation* (albanianfoundation.org) për të ndihmuar fëmijët e zonave të thella të Dibrës të mësojnë anglisht – të gjitha këto janë pasqyruar tashmë në mediat shqiptare.

Kur dëgjova për herë të parë për Gentin, u bëra menjëherë kurioz për të ditur historinë e prindërve të Gentit. Lefteri, i ati, me të cilin jam takuar tashmë në vizitën e tij të fundit në Tiranë, është gjithashtu një histori e lavdërueshme suksesi: si mundet që një djalë i rritur në Shqipërinë komuniste e pa asnjë shpresë për të ardhmen, të jetë tashmë një nga ekspertët botërorë të arsimit universitar në të gjithë botën?

FËMIJËRIA E VËSHTIRË

Lefteri kujton fëmijërinë e vështirë, që filloi në lagjen Cernjevë, Radomirë të Kalasë së Dodës. "I përkas brezit të viteve 1970-të" – thotë Lefteri, "brezit të racionit 650 gram bukë për frymë; brezit të pangopur... që barazohej në statusin e varfërisë së përditshme: hahej kos, vetëm kur tundej mtini - e shumta një herë në javë!"

Lefteri kujton që ka veshur këpucë për herë të parë në klasën e shtatë. Ndërsa opingat e llastikut, të cilat nuk gjendeshin lehtë, përdoreshin gjerësisht. "Më kujtohet një herë, i mora me radhë dyqanet për të blerë opinga, duke filluar në Vleshë, Sllatinë, Dypjakë, derisa i gjeta në Sohodoll"

Përtej varfërisë, politizimi i skajshëm i situatës së kohës, shtoi pengesa të tjera në edukimin e Lefterit. Megjithëse i ati ishte rreshtuar në formacionet partizane, në vitin 1968 u përjashtua nga Partia dhe, megjithëse jo nën persekutim të dukshëm, kjo "njollë në biografi" ishte pengesë në vazhdimësinë e arsimimit të Lefterit, i cili, pas 8-vjeçares, nuk fitoi të drejtën e studimit në shkollën e mesme. U regjistrua në Gjimnazin e Peshkopisë, por për shkak të mungesës së konviktit, babai e kaloi në shkollën bujqësore "Nazmi Rushiti", i ndihmuar edhe nga Moisi Cami. Pas mbarimit të bujqësores me rezultate shumë të mira, e drejta e studimit në shkollën e lartë iu mohua për një vit, për t'iu rikthyer përsëri pas ndërhyrjes së miqve. "Ishin momente të vështira", - kujton Lefteri, "megjithëse s'kanë të krahasuar me rastet e atyre mijëra të rinjve që iu mohua e drejta e shkollimit gjatë komunizmit." Lefteri e konsideron këtë pengesë si dramën më të madhe të sistemit komunist të Shqipërisë.

Thirrjes publike të të gjitha qeverive për tërheqjen e ekspertëve nga jashtë, që të vijnë e të ndihmojnë Shqipërinë, duket se Lefteri (e ndoshta shumë të tjerë) nuk kanë sesi t'i përgjigjen, ngase, përtej deklaratave publike, nuk duket se realisht ka një sinqeritet për ta vjelë këtë kontribut.



PUNË, TALENT DHE MUNDËSI

Më bëri përshtypje se, si ka qenë në gjendje Lefteri t'ia dalë gjithë këtij presioni, jo vetëm duke marrë një diplomë, por duke shkëlqyer në gjithë zinxhirin arsimor. "Pa mbështetjen e babait nuk do të isha ky që jam sot" - thotë Lefteri, duke kujtuar se në këtë rrugëtim, ka pasur njerëz që kanë premtuar me fjalë, por s'kanë qenë aty kur ishte e nevojshme. Dhe përtej ndihmës së babait, "talenti, puna, dhe mundësitë" janë çelësi i suksesit, në këndvështrimin e tij. "Është një shprehje amerikane që thotë se '*puna e madhe ia kalon talentit kur talenti nuk punon sa duhet*'. Ideja që një i talentuar mund të arrijë suksese me përgatitje minimale është krejt e gabuar. Nuk ka sukses në kohë të shkurtër dhe pa lodhje. Sidoqoftë, ajo që i dallon njerëzit e suksesshëm nuk është vetëm talenti i jashtëzakonshëm, por edhe mundësitë e jashtëzakonshme që u janë krijuar për arritjen e suksesit."

Këto përsiatje të Lefterit rreth suksesit, materializohen dukshëm në rrugëtimin e tij me arsimin. CV-ja e tij është një listë e gjatë me mësimdhënie, duke filluar në Universitetin Bujqësor të Kamzës, ku punoi si pedagog menjëherë pas përfundimit të studimeve për Ekonomi Agrare. Pastaj vijon studime pasuniversitare e specializime në Skoci dhe Holandë. Për të vijuar me studimet Master dhe Doktoraturë në Universitetin Politeknik të Virxhinias, në SHBA, studime të cilat i përfundoi në vitin 2002.

NJË METODË EKONOMIKE ME LEVERDI

Biseduam gjatë me Lefterin në lidhje me kontributin e tij, si rrjedhojë e studimeve

"Kur je larg, malli për vendlindjen është përvëlues. Ti mund të ndahesh nga vendlindja, por ajo s'ndahet kurrë nga ti. Copëza nga vendi ku u linde, ku hodhe hapat e para, ku mësove gërmat e para i merr me vete kudo që shkon. Edhe kur vete deri në fund të botës, në Honolulu, siç thoshim dikur, ato copëza janë me ty, pjesa e identitetit tënd."

të doktoraturës.Teza e tij e doktoraturës, e botuar edhe në anglisht, sjell zhvillime të nevojshme në fushën e menaxhimit të integruar të pesticideve dhe hormoneve. Në kushtet kur, nën presionin e fitimit të pamasë, bizneset zgjedhin të përdorin hormone dhe pesticide pa kriter, lind rreziku i ndikimit të dëmshëm të pesticideve në organizmin njerëzor, por edhe në mjedisin jetësor. Lefteri ka sjellë një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë fushë, duke studiuar një përdorim të integruar të pesticideve, - si fillim në sektorin e prodhimit të ullinjve, - që ruan fermerët nga dështimi i prodhimit, sjell përfitime ekonomike për këtë treg, por edhe që siguron ruajtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve. E pyes Lefterin, nëse mund të përdoret metoda e tij në ekonominë shqiptare, që duket se po ndikohet pa kriter nga përdorimi i pesticideve gjithandej. "Patjetër, - thotë Lefteri, - metoda tashmë po përdoret në Indi edhe në vende të tjera."

MËNJANIMI I EKSPERTËVE

Lefteri më vërteton mendimin se, në kontekstin shqiptar, duket se ekspertët, megjithëse mund të sjellin kontribut shumë të rëndësishëm për ekonominë e vendit, në fakt, janë ata që janë mënjanuar më shumë se gjithë të tjerët. Thirrjes publike të të gjitha qeverive për tërheqjen e ekspertëve nga jashtë, që të vijnë e të ndihmojnë Shqipërinë, duket se Lefteri (e ndoshta shumë të tjerë) nuk kanë sesi t'i përgjigjen, ngase, përtej deklaratave publike, nuk duket se realisht ka një sinqeritet për ta vjelë këtë kontribut.

Lefteri më tregon biseda me politikanë të lartë shqiptarë, që, ndërsa Lefteri iu theksonte nevojën që ka Shqipëria për ekspertë, e kundërpeshonin këtë nevojë, me nevojën për politikanë. Deri tani, duket se ia kemi parë hajrin si vend, pikërisht këtij fokusi të gabuar për të ardhmen e Shqipërisë.



SHQIPËRIA, VENDI KU NDRYSHOHEN TEORITË QË TË REFLEKTOJNË INTERESA

Në vitet e fundit, Lefteri e ka ndryshuar fokusin e aktivitetit të tij. Tashmë, në rolin e tij, si Drejtor i Analizës dhe Kërkimit të Pranimit në Universitet, në zyrën e Rektorit të Universitetit të Virxhinias, ka një fokus të strategjisë e zhvillimit të arsimit të lartë. Për kujtesë, Universiteti Politeknik i Virxhinias renditet në 25 universitetet më të mira publike të SHBA-së. Lefteri madje jep leksione jo vetëm në fushën e ekonomisë e të statistikës, por gjithashtu udhëton në simpoziume dhe konferenca në lidhje me zhvillimin e arsimit të lartë. Natyrshëm, erdhi biseda te ligji i arsimit të lartë në Shqipëri, i shumëdebatuar vitin e fundit. "Nuk më ka kërkuar njeri të kontribuoj," – më thotë Lefteri. "Edhe e kam vështirë të punoj në Shqipëri në këtë kontekst. Këtu, në vend që sistemi të reflektojë një teori, njerëzit ndryshojnë teorinë, që t'ju përshtatet dëshirave të tyre." Me këtë frazën e fundit, Lefteri, analizon konceptin e "të mirës publike në edukim", që si duket, në këndvështrimin e ekspertëve shqiptarë që janë marrë me ligjin, është përpunuar pak, për të futur në thesin e përfituesit të fondeve publike edhe universitetet private. Lefteri ngul këmbë, që përfituesit e vetëm të fondeve publike duhet të jenë universitetet publike, të cilat gjithashtu duhet të garantojnë një shpërndarje të nevojshme të këtyre përfitimeve në të gjitha shtresat e popullsisë, ndërsa universitetet private duhen lënë të konkurojnë në treg, si çdo sipërmarrje tjetër private. Për Lefterin, si një ekspert i fushës, ka akoma shumë politikë në universitet, që nuk zgjidhet as me zgjedhje të pavarura – e meqë ra fjala, sistemet e zgjedhjeve të strukturave drejtuese të universiteteve, në formën që bëhen në Shqipëri, janë të padëgjuara në botën e zhvilluar – e as me autonomi të tepruar të këtyre institucioneve. "Përsëri, thotë Lefteri, zgjidhja janë ekspertët e fushës, të cilët do t'ju qëndrojnë standardeve të nevojshme të edukimit dhe jo të vazhdohet me njerëz të paaftë që marrin funksione për shkak të lidhjeve politike. Megjithatë, ndryshimi është problem gjithandej. Ndryshimet do të kërkojnë kohë në Shqipëri."

KËNDVËSHTRIM PËR VENDLINDJEN

E përfunduam bisedën e parë me Lefterin, duke mbyllur këtë kapitull e duke u përpjekur të kthehemi nga Dibra. Megjithëse Lefteri është larguar nga Shqipëria që prej vitit 1996, vazhdon të ruajë lidhje të forta me vendlindjen. "Kur je larg, malli për vendlindjen është përvëlues. Ti mund të ndahesh nga vendlindja, por ajo s'ndahet kurrë nga ti. Copëza nga vendi ku u linde, ku hodhe hapat e para, ku mësove gërmat e para i merr me vete kudo që shkon. Edhe kur vete deri në fund të botës, në Honolulu, siç thoshim dikur, ato copëza janë me ty, pjesa e identitetit tënd."

Lefteri kujton me nostalgji vitet e shkollës së mesme në Peshkopi. Dhe bulevardin. Me bliret. Me shtresën qytetare. Institucionet kulturore – kinemanë, shtëpinë e kulturës, bibliotekën, dy shkollat e mesme. "Peshkopia mbetet qyteti më i bukur i veriut", - thotë Lefteri.

Ne kemi nevojë për filozofinë realiste të Konicës, që kishte qejf ti thoshte gjërat siç janë, pa zbukurime të tepruara. Megjithëse themi se jemi të mençur, Dibra është e prapambetur.

- një **dibran i suksesshëm**

Lefteri e ka vizituar Dibrën disa herë tri vitet e fundit, bashkë me djalin, duke ndihmuar për organizimin e kampeve verore të anglishtes në Radomirë. Ndjek me vëmendje zhvillimet përmes gazetës *Rruga e Arbrit*, sipas Lefterit, "një burim i besueshëm për zhvillimet e Dibrës". "Veçse Peshkopia nuk është më ajo e dikurshmja. Elitat kanë ikur, sa në Tiranë, sa jashtë. Pak i ka ngelur qytetit nga ajo hijeshi e dikurshme. Në vend të saj, syri të sheh ndërtesa të shëmtuara dhe pa shije, shtesa pallatesh me qoshe të shtrembura dhe të pasuvatuara, restorante që nuk garantojnë standardet minimale të higjienës. Por mbi të gjitha, pisllëku dhe pluhuri i japin një pamje krejt të zymtë qytetit. E vetmja gjë pozitive ishte se qyteti ngjante shumë i gjallë nga shumëllojshmëria e dyqaneve dhe bizneseve, ç'ka nuk vihet re në qytetin fqinj të Kukësit."



Dibranë si Lefteri kanë arritur në majat e profesionalizmit, jo sepse kanë miq, as se kanë shfrytëzuar situata në favor të tyre, por sepse kanë punuar me mund për të arritur aty ku janë...
Dhe Dibra ka nevojë për kontribute të këtij lloji.

ZGJIDHJET EKONOMIKE PËR DIBRËN

E pyes Lefterin për pamjen e tij rreth situatës ekonomike në Dibër. Dhe ai kujton një detaj nga kthimi i tij në Dibër. "Në udhëtimin tim të parë pas 25 vitesh, ndërsa po udhëtonim në rrugën Kukës – Kala e Dodës – Peshkopi, djali më pyeti: 'Ku janë njerëzit, nuk po shoh njerëz fare!" E kisha të vështirë përgjigjen.Njerëzit kanë ikur.Toka nuk punohet. Pyjet dhe kullotat e masivit të Korabit nuk shfrytëzohen. Lura me liqenjtë e saj të bukur nuk është siç ka qenë se pyjet janë zhdukur. Minierat e Bulqizës janë një tmerr i vërtetë. Në vend të punësimit dhe mirëqënies për zonën sjell vetëm varfëri për shkak të korrupsionit dhe shfrytëzimit pa kriter. Nuk ka dyshim se politika është talluar me Dibrën në këto 25 vite. Është një rreth vicioz. Për të dalë duhen politika që nxisin zhvillimin."

Dhe për të mos e lënë bisedën në pamjen përshkruese të sfidave që të gjithë i shikojmë në Dibër, Lefteri ofron edhe një zgjidhje konkrete. Rruga e Arbrit! Ai thotë madje, që e shikon si zgjidhje këtë rrugë, pikërisht për nevojat e zhvillimit të zonës.

RRUGA E ARBRIT, SI ZGJIDHJE EKONOMIKE

"Rruga e Arbrit do të ishte shpëtimi i Dibrës. Këtë e them si ekonomist. Pa rrugë nuk ka zhvillim. Prioritetet mund të jenë bujqësia, blegtoria, industria minerare dhe turizmi. Mirëpo këta sektorë nuk mund të përfitojnë nga ajo që ekonomistët e quajnë epërsi krahasuese në treg, nëse nuk ndërtohet Rruga e Arbrit. Para dy vitesh takova në Radomirë një djalë të ri nga Bellova. Vinte çdo ditë nga Bellova për të shitur qumështin e bagëtive te baxhoja në Radomirë. E pyes, përse nuk e shet në Peshkopi? Sepse çmimi është më i mirë këtu, edhe ngaqë rruga Peshkopi-Kala e Dodës është e asfaltuar. Rruga e Arbrit do të ketë të njëjtat efekte, por në një shkallë shumë më të madhe se ky rast. Bulqiza mund të jetë rasti i vetëm në botë ku një qytet i ndërtuar mbi rezerva të mëdha minerare lëngon në peshën e varfërisë."

"Rruga e Arbrit do të ishte shpëtimi i Dibrës. Këtë e them si ekonomist. Pa rrugë nuk ka zhvillim. Prioritetet mund të jenë bujqësia, blegtoria, industria minerare dhe turizmi. Mirëpo këta sektorë nuk mund të përfitojnë nga ajo që ekonomistët e quajnë epërsi krahasuese në treg, nëse nuk ndërtohet Rruga e Arbërit.

Sfida tjetër që duhet zgjidhur, në mendimin e Lefterit, është mbulimi gjeografik i gjithë zonës së Dibrës në ndarjen e re territoriale. Do të jetë e vështirë në optikën e tij të mbulohen hallet e gjithë zonës nga qendra, nga qyteti i Peshkopisë, për shkak të dinamikës së çështjeve për t'u zgjidhur. "Shpesh, vihet re që çdo drejtues i ri, sapo ulet në karrike, puna e parë që bën është hartimi i strategjive. Strategji zhvillimi për çdo sektor, strategji afatshkurtra dhe afatgjata. Me draftin e strategjive ka përfundur gjithçka. Më thoshte një koleg i huaj, këtu duket sikur çdo zyrtar është i specializuar në hartimin e strategjive. Por asgjë nuk zbatohet. Drejtuesi tjetër e fillon nga e para. Dhe cikli i strategjive nuk ka të sosur."

RRETH KALASË SË DODËS

Lefteri është kthyer në zonën e tij të lindjes pas një periudhe të gjatë largimi. Dhe në kthim, ka gjetur disa aspekte të traditës që mbahen akoma me rigorozitet, si për shembull, ruajtja e pyjeve të zonës nga të gjithë banorët, si pjesë e pronës së përbashkët, në ndryshim nga masakra kolektive që iu është shkaktuar pyjeve gjithandej. Ky reagim, ka hedhur poshtë, sipas shpjegimit të Lefterit, një teori të përhapur ekonomike, të quajtur "tragjedia e së përbashkëtës", sipas së cilës, një pronë e përbashkët mund të shfrytëzohet keq, ngaqë nuk i përket askujt. Në këto raste rrugëzgjidhja është privatizimi ose shtetëzimi. Mirëpo, e vetmja femër që ka fituar *Nobelin në Ekonomi*, Elinor Ostrom, ka theksuar se këto skema fshatçe janë shumë herë më efektive sesa pronësia private ose ndërhyrja e shtetit. "Një e vërtetë që në Radomirë është zbatuar historikisht. Nuk u habita aspak kur një amerikane e Korpusit të Paqes vizitoi Kalanë para ca vitesh dhe shkroi në blogun e saj, se "ky është i vetmi vend në Shqipëri ku pyjet duken të virgjëra". Një traditë që duhet studiuar dhe përhapur në gjithë Shqipërinë", thekson Lefteri.

GJËRAT QË NUK NDRYSHOJNË NË DIBËR

Disa tradita ruhen. Por të tjera, për të cilat nuk ia vlen të krenohesh, vazhdojnë të jenë aty! Dhe Lefteri, pavarësisht mallit për vendlindjen, nuk nguron t'i listojë. "Dukej sikur asgjë s'kishte ndryshuar, veç asfaltimit të rrugës". Dhe lista vazhdon me bukuritë natyrore, për të cilat s'kujdeset njeri, mungesa e turizmit funksional, mentaliteti që nuk ndryshon, sjellja kolektive që pothuajse nuk ndryshon fare, nevoja për "hapje" ndaj komercializmit dhe praktikave të reja, rritje të cilësisë së shërbimeve. "Para ca kohësh pashë një material të përgatitur nga një TV lokal mbi problemet e turizmit në Kala të Dodës. Gazetari i kishte pasqyruar sfidat shumë saktë. Por reagimi ndaj dokumentarit nuk ishte dinjitoz. Dëgjoje njerëz të thonë, 'si guxon ai të na përdhosë traditat?'"

URTËSIA E MUNGUAR E DIBRANËVE

Shpesh dibranët e lavdërojnë veten për urtësinë që gjendet në viset tona. Edhe të tjerë, nga jashtë, vënë në dukje urtësinë dhe butësinë që gjejnë në Dibër. Por, për Lefterin, ka një anë negative në gjithë këtë vërshim të pakontrolluar vetëlavdërimi.

"Po, e kam dëgjuar atë thënien për mendjen, që lindi në Shkodër, kaloi n'Mirditë dhe pushoi n'Dibër. Dikush ka bërë dhe poezi. Është në natyrën njerëzore që çdo thënie që na përshtatet, të na duket bukur. A është e vërtetë thënia? Nuk e di. Shkodranët do shoshin: "a je i marrë, ne na paska lënë mendja?" Me mirditorët do të jetë akoma më e vështirë, se ata as nuk do ta pranonin se mendja ka kaluar andej! Por përtej shakasë, alegoria dibrane është e njohur. Dibranët njihen si njerëz të mençur e punëtorë të pashoq. Megjithatë, për shkak të izolimit, Dibra ka një problem imazhi. Shumë nuk e njohin. Një mik nga Saranda, kur e pyeta se si e përfytyron Dibrën, më tha, se edhe pse nuk a ka vizituar, Dibra i duket si një grumbull kreshpash e malesh të thepisur, me njerëz të prapambetur. Është rasti për ta theksuar edhe njëherë se Rruga e Arbrit do të ishte shpëtimi dhe e ardhmja e Dibrës edhe nga ky këndvështrim.

Megjithatë, ne dibranët kemi nevojë për filozofinë realiste të Konicës, që kishte qejf t'i thoshte gjërat siç janë, pa zbukurime të tepruara. Megjithëse themi se jemi të mençur, Dibra është e prapambetur. Për Dibrën duhet të flasin profesionistët dhe jo amatorët dhe autodidaktët. Historia duhet vlerësuar siç është, pa gënjeshtra, pa manipulime, larg ideologjizmave, që të rinjtë ta dinë të vërtetën. Nuk jam historian, por më çudit fakti që në çdo shpellë të Dibrës historianët amatorë gjejnë rrënjët tona ilire. Ndërkohë, profesor Kristo Frashëri, në librin "Historia e Dibrës", në gjysmën e faqeve të librit parashtron tezat e ndryshme, por thekson se nuk kemi burime për t'i mbështetur, ashtu siç i takon një historiani, studiuesi të mirëfilltë."

KONTRIBUT PËR T'U VLERËSUAR

Bisedat me Lefterin mund të zgjasin shumë – sepse, për shkak të formimit të tij akademik, qoftë në ekonominë agrare, qoftë në statistikë, e qoftë në kontributin e tij në arsimin e lartë përmes një prej Universiteteve më të njohura në SHBA – ai ka se çfarë të ofrojë. Dhe, ashtu siç preferon edhe ai vetë, pa sajesa të panevojshme, pa lulet e tepruara të vetëlavdërimit, nuk duhet të shkojmë as në cepin tjetër, që të lëmë pa vlerësuar njerëz që vërtet e meritojnë të vihen në dukje. Dibranë si Lefteri kanë arritur në majat e profesionalizmit, jo sepse kanë miq, as se kanë shfrytëzuar situata në favor të tyre, por sepse kanë punuar me mund për të arritur aty ku janë... Dhe Dibra ka nevojë për kontribute të këtij lloji.

ÇFARË BËHET ME GENTIN TANI?

Së pari dua t'ju falenderoj si gazetë dhe në veçanti kryeredaktorin Z. Bujar, për mbështetjen e vazhdueshme që kur filluam kurset e anglishtes në Radomirë në verën e 2015-ës.

Verën që kaloi Genti mbaroi gjimnazin me medalje te artë duke arritur notën mesatare më të lartë në historinë e shkollës ku studioi. Po ashtu, ai fitoi medaljen "Studiuesi Presidencial" akorduar nga Presidenti Obama si një ndër studentët më të mirë në Amerikë.Në gusht të këtij viti, Genti filloi studimet në Universitetin e Harvardit.Akoma nuk e ka përcaktuar degën e studimit, por anon nga financa, ekonomiku dhe statistika.


THE ROANOKE TIMES
roanoke.com
NEWS SPORTS BUSINESS WEATHER LIFE & ENTERTAINMENT OPINION OBITUARIES
Blacksburg grad's educational impact felt across the globe

Për të vijuar punën e nisur në Radomirë, vitin e kaluar Genti themeloi Fondacionin *Albania Future* (E ardhmja e Shqipërisë – albaniafuture.org. Kemi në plan të vazhdojmë me kurset verore dhe ta zgjerojmë aktivitetin në kuadrin e Fondacionit. Në verën e 2017-ës do të njoftojmë dy bursa të reja për nxënës me përparim të mirë në mësime dhe me kusht që të vazhdojnë shkollën e mesme.

Një histori suksesi nga emigracioni në vendlindje, me dashuri për tokën dhe vendin...

Urim Truka, njeriu që kurrë nuk i tha "Jo" punës





Nga **OSMAN XHILI**

Urim Truka nga Pjeça punoi më shumë se 15 vjet në emigracion, në Itali. Punë të ndryshme, vende të ndryshme. Punoi në sera, ndërtim, duhan, frutikulturë, apo blegtori. Lëvizi nga jugu në veri, nga Kaserta në Bolzano. Urimi ishte gjithmonë i vëmendshëm në zanatin që ushtronte. Ai shihte mënyrën se si realizohej një proces i caktuar, kushtet, kriteret, sa shpenzohej dhe sa fitohej në një profesion të veçantë. Por duket, se serat me luleshtrydhe e magjepsën dhe e kuptoi se kurrë nuk do të ndahej më nga ky lloj biznesi.

"Njëra prej tyre, - tregon Urimi, - kishte 200 metër katror. Bimët mbilleshin në distancë 25 cm larg njëra tjetrës dhe e gjithë sera kishte afërsisht 1300 bimë gjithsej. Prodhimi mblidhej në dhjetë duar, me një rendiment të përgjithshëm prej 6 kuintalë luleshtrydhe".

Nganjëherë, kur pushonte pak pas punës së lodhshme, vinte gishtin në tëmtha e mendonte: po sikur të kishte një serë të tijën? Po sikur të kishte më shumë, tre dynymë me sera, pesë dynymë, shtatë?... Por shpejt e kuptonte që kishte shkuar shumë larg me ëndërrimet e tij, se kjo gjë ishte gati e pamundur dhe ai nuk ishte vetëm një emigrantë që kishte ardhur në vendin fqinj, për të mbajtur familjen.... Pushimi i shkurtër kishte mbaruar dhe ai ngrihej për të rifilluar punën.

Qëndrimi për gjatë kohë në emigracion i solli jo pak para në xhepa. Mendoi njëherë të ngrejë një vilë të madhe e t'u krenohej bashkëfshatarëve të tij, por shpejt hoqi dorë nga kjo ide. Në vend të kësaj bleu tokë dhe jo pak, por 50 dynymë, pasi të tijën shumë pak kishte pasur. Ishte toka më e mirë e fshatit dhe quhej Paraspur, gati e gjitha një bllok. Dhe atëherë kur i kishte paguar lekët dhe kishte marrë në dorë letrat e pronësisë, nuk i besohej se ishte e tija, gjithë ajo pronë. Ishte viti 2003. Nuk priti më gjatë dhe filloi të mbjellë në tokën që kishte blerë. Jo, nuk kishte qenë ëndërr, ajo që kishte parë në Itali. Plot pesë dynymë me luleshtrydhe kishte mbjellë tani në Pjeçë, në fshatin e tij të lindjes. Arriti të marrë deri në 80 kuintalë prodhim prej tyre. Gati çdo ditë nxirrte 5 – 6 kuintalë, që e kishte të shitur në Tiranë me një vlerë 200 lekë kilogramin. Kjo punë vazhdoi për gati 10 vjet, deri në shkuljen e tyre, për ti rimbjellë sërish këtë vit.

Një vit pas luleshtrydheve, në vitin 2005, mbolli 12 dynymë mollë, në distanca katër me tre, varietete si Stark, Gran Smith, Gold, Hajdaret. Vitin e kaluar prodhoi rreth 270 kuintalë të një cilësie shumë të mirë dhe i shiti me 60 lekë kilogramin. Shpreson që këtë shifër ta çojë më lart, pasi pemët janë në rritje akoma dhe ushqimi i tyre është i jashtëzakonshëm. Nuk mund të linte qershinë jashtë vëmendjes, këtë frut të këndshëm, me vlera të shumta kurative. Dhe pse gomoza i ka dëmtuar një pjesë të rrënjëve, Urimi nuk është mësuar të humbasë beteja. Mbolli 200 rrënjë të egra, i shartoi me llojet që dëshironte dhe tani i ka në vitin e dytë.

Urimi ka mbjellë katër hektarë pemëtore deri tani. Ai mendoi se ftoi mund ti sillte të ardhura jo të pakta ekonomisë së tij dhe ka shtatë dynymë të mbjellë me këtë kulturë. Dhe pse një bllok e ka me pemë të reja, arriti të marrë mbi 60 kuintalë. Një kokërr prej tyre mund të ishte nga një, deri në 1,2 kilogram. Pothuajse, që të gjithë sasinë e tregtoi me një çmim mesatar prej 100 lekësh. Në këto përpjekje për të ecur përpara, krahas gomozës te qershia, ka dhe armiq të tjerë, që duan ta pengojnë e ta çojnë në kahun e kundërt. Zjarri bakterial po i sulmon ftoin, por Urimi sërish përpiqet ta sfidojë atë. Preparatet e bakrit, si pasta, gur kali, champions e të tjerë të kësaj natyre, duken që janë efektivë. Krahas këtyre, kohët e fundit aplikohen streptomicina e tetraciklina dhe Urimi nuk nguron ti ketë këto preparate në luftën kundër zjarrit bakterial.

Nuk kishte se si kultura e arrës, të ishte jashtë vëmendjes së tij. Kjo kulturë shfrytëzon dhe toka, ku të tjera kultura nuk mbijetojnë, bile duke e mbrojtur tokën nga gërryerjet dhe erozioni. Ai ka mbjellë deri tani mbi katër dynymë, por arra e shartuar po i tërheq më së shumti vëmendjen. Futja e shpejtë në prodhim, kokrrat e mëdha e të buta, për pasojë tregu më i garantuar, i japin prioritet këtij lloji, krahasuar me atë tradicional. Shumë shpejt mendon që nga llogaritë në letër, të zbresë në fushë, për të mbjellur këtë vit një hektar, një pemë kjo që aq shumë i shkon Dibrës, dhe aq shumë po kërkohet nëpër tregje.

Nuk di nëse ka një kulturë që Urimi të mos e ketë pasur e të mos e ketë në fermën e tij. Këtë vit ka mbjellë 6,5 dynymë patate me farë speciale hollandeze, për të marrë në total rreth 400 kuintalë. 1,5 dynymë i ka mbjellë me qepujkë, pesë dynymë me misër, po kaq me grurë, dy dynymë me qepë dhe dy dynymë me lakra. Të gjitha këto e bëjnë shumë interesante e të larmishme fermën e Urim Tukës, të këtij njeriu, që kurrë nuk i tha jo punës.

Në këto përpjekje të jashtëzakonshme për të thyer rekorde, kur shumë njerëz nuk mbjellin një dynym të vetëm e ai menaxhon mbi pesë hektarë, gjithë familja e tij, gruaja dhe dy djemtë, punojnë si një ekip kompakt. Në faza të ndryshme të prodhimit, vjelje, rrallim frutash, apo procese të tjera, Urimi punëson tre, pesë, apo tetë veta njëherësh.

Sa borxh u kemi këtyre njerëzve, këtyre njerëzve që jo vetëm nuk rrinë varur tek zyrat e punës, që jo vetëm nuk qahen nga plogështia e shtetit, por hapin fronte pune dhe për të tjerë, duke i bërë shoqërisë një shërbim të madh. Përveç familjes, ai ka dhe një aleat të fuqishëm, zetorin e tij të stërmadh, me superspont, Londin atlas, me 80 kuaj fuqi. Me të punon tokat e tij, me të punon dhe tek të tjerët, me të sjell rërë e zhavorr sipas kërkesave të klientëve, me të sjell plehun e shpendëve nga pularia e Dibrës, me të cilin plehëron pemët dhe perimet. Normalisht që dhe frutat, ballat e barit dhe çdo punë tjetër e bën me të. Mjafton të themi se treqind ton pleh shpendësh, janë sjellë me të njëjtin mjet. Kështu pra zetori trupmadh , fjalëpak e punëshumë, i shërben Urimit dhe familjes së tij, në këmbim të naftës dhe fare pak shërbimeve të tjera.

Diku në mes të rrugës së Trepçës dhe asaj të Pjeçës, gjate vjeshtës , sheh një dyqan të improvizuar frutash e perimesh. Shitësi, është djali i Urimit, që tregton prodhimet e fermës së tij. Në vend të tij, do të donim të ishte një pikë grumbullimi, që të mblidhte prodhimet e tij, por dhe të fermerëve të tjerë, për ti dërguar më pas në tregun vendas, por dhe jashtë, në vende të rajonit. Derisa të realizohet kjo dëshirë e të gjithëve, familja e tij do të vazhdojë të shesë frutat, aty anës rrugës, me shpresën që një ditë gjërat do të ndryshojnë për mirë.

Udhëtarët të kënaqur me cilësinë e këtyre produkteve, kërkojnë të blejnë sërish, duke i dërguar ato në Bulqizë, Tiranë, Durrës, apo diku tjetër. Nuk na mbetet tjetër, veçse ti bëjmë Urimit një urim, të ketë shëndet e jetë të gjatë, për ta pasur modelin e njeriut të mirë e punëtor, që mban familjen dhe ndihmon komunitetin.

Në vend të tij, do të donim të ishte një pikë grumbullimi, që të mblidhte prodhimet e tij, por dhe të fermerëve të tjerë, për ti dërguar më pas në tregun vendas, por dhe jashtë, në vende të rajonit. Derisa të realizohet kjo dëshirë e të gjithëve, familja e tij do të vazhdojë të shesë frutat, aty anës rrugës, me shpresën që një ditë gjërat do të ndryshojnë për mirë.



reportazh

Mbresa nga Sohodolli
i Kastriotit të Dibrës

Sohodoll të qofshim falë, me breza drite e **zemërbardhë**



Nga **MEVLUD BUCI**

PROLOG...

Ka gati 50-të vite që mbaj peng të shkruaj sadopak për Sohodollin. Një fshat plot histori qëndrese, mençurie e bujarie, me plot bij e bija të shquar nëpër vite. Te çdo kullë e fis në Sohodoll gjen veç urti, mirësi e zemërbardhësi. Në njërën nga ditët e fundit zbritëm nga malet në Sohodoll. Vërtet vend i praruar, vend me njerëz të mirë, të urtë, të ndritur, me shpirt e zemër për bardhësinë e jetës, për traditat, për kulturën, për kohën e re, për demokracinë e vërtetë, për dritën e diturisë.

S'ka pasuri e pozitë më të madhe sesa kur njerëzit rrezatojnë dritë shpirti, dritë zemre, dritë pune e çiltërsi njerëzore. Kjo dritë është dhunti, është uratë Perëndie, është gen i familjeve e fiseve të cilët hijeshojnë vendin, Sohodollin e fisnikërisë. Sapo kaluam Kubenin e morëm djathtas në pjertësinë e fushës, në të djathtë të përroit të Gjelagjoshtit u ndodhëm në Sohodoll. Tek vështronim peizazhet, shtëpitë e reja, kullat, tokat, pemët e veshura me petkun e argjenddtë të vjeshtës, ndër mend më vinin plot kujtime, gjurmë pune, krijues, të urtë popullorë në oda, urtësi e alegori në dasma e hidhërime, të urtë popullorë, intelektualë të shquar, miq e shokë të ndritur të Sohodollit. Për to dhe traditat e Sohodollit nuk do të mjaftonin disa reportazhe a libra, jo më një shkrim i thjeshtë (reportazh) si ky i yni, ku ua kushtoj brezave të urtësisë e zemërbardhë të këtij fshati, me gjurmë të rralla kulture e fisnikërie nëpër vite.

KU JANË ATO PLEQ BUJARË?...

Tek po afroheshim Sohodollit, sapo kaluam Gjelagjoshtin, m'u kujtua vargu i poetit të lashtësisë Pjetër Budi: *Ku janë ata pleq bujarë?*

Vërtet pleq të urtësisë e të bujarisë me vijnë ndër mend, me të cilët kam takuar e biseduar vite e vite më parë. Ata janë gdhendur në kujtesën time, si të paharruarit: Isuf Tufa, Isuf Çela, Miftar Cibaku, Idriz Cibaku, Lutfi Titini, Islam Cibaku, Sheh Regjepi, intelektualë gjurmëlënës e të talentuar si Bexhet Osman Cibaku, Shuaip Methasani, Xhemal Haraçiu, Fadil Merdini, Zylfi Tafa, Shyqyri Horeshka, Tahir Çela, Bashkim Makishti, Shaban Shehu, Shqipe Methasani, Zade Methasani, Shkurtë Xhediku, Qatip Cibaku, Xhelil Cibaku, Fejzi Cibaku, Bardhul e Esat Cibaku, Abdullah e Taf Merdini e plot të tjerë.

Kujtova ish mësuesin tim të nderuar këtu e gati 55 vite më parë, të talentuarin Shyqyri Horeshka (i vetmi që jeton sot nga të gjithë ish mësuesit e mi). Kujtoj ish tre kryeinspektorët e DA Dibër nëpër vite, bij të Sohodollit: Refik Çela, Fariz Cibaku e Pajtim Velia, gjurmëlënës në frontin e dijes e të drejtimit arsimor. Kujtoj bijën, mësuesen e talentuar Nderime Methasani, bijë e Sohodollit, ish mësuese në Pezë-Helmës të Tiranës, e cila u nda nga jeta në moshën migjeniane, duke lënë pas dritën e diturisë, kujtime të paharruara. Kur kujtoj vargun e Budit: "Ku janë ato pleq bujarë?", shtojmë se sot kemi plot intelektualë, bija e bij krenarë. Krenari brezash, krenari jete e diturie gjen te njerëzit e mirë të Sohodollit.

DY PIKA LOTI
PËR PROF. DR NURI ABDIUN

Në aférsi të Sohodollit sikur m'u shfaq i thjeshtë, i dashur, i qeshur e madhështor i shtrenjti, shkencëtari, miku im i paharruar Nuri Abdiu. Sohodolli ku u lind e kaloi fëmijërinë e parë, Dibra e Shkodra, Tirana, Prishtina, Tetova e gjetkë ku ka lënë gjurmë kurrë se harrojnë. Edhe vëllezërit Fehmiu, Sabriu (ndjesë pastë) e Ismet Abdiu, secili

Në aférsi të Sohodollit sikur m'u shfaq i thjeshtë, i dashur, i qeshur e madhështor i shtrenjti, shkencëtari, miku im i paharruar Nuri Abdiu. Sohodolli ku u lind e kaloi fëmijërinë e parë, Dibra e Shkodra, Tirana, Prishtina, Tetova e gjetkë ku ka lën gjurmë kurrë se harrojnë.

më i mirë se tjetri, edhe farefisi, nipat e mbesat, fshati, brezat e intelektualëve në komb e në dijasporë krenohen me Nuri Abdiun. Midis shumë e shumë kujtimeve para shumë viteve m'u kujtua fakti se si ky vigan liberator, shkencëtar i psikologjisë, me plot meritë Hasan Tahsini i shekullit të 21-të, ngriti zërin në sallën universitare ku kishte akademikë nga Tirana e Shkodra, duke thënë me çiltërsi e dashamirësi: 10-ën ia jep jeta Mevlud Bucit! (Pra, i mbeti peng përse më vlerësuan me rezultatin 9-të, shumë mirë.) Kush e di sa e sa kujtime ruaj këtu e gati 50-të vite për këtë intelektual e akademik të shquar.

Jo për nostalgji, por për dhimbje e krenari, thellë në zemrën time në vendlindjen e tij dy pika lot malli për të pavdekshmin e provave të diturisë, të ndriturin Nuri Abdiu.

BIRI I SOHODOLLIT

Në Sohodoll, cilido që shkon, gjen vlera të rralla, emra që i rrezatojnë trevës së Kastriotit, Dibrës, Kombit e Diasporës. Në shkollën e këtij fshati u arsimua poeti, shkrimtari, studiuesi dhe me plot të drejtë filozofi Agron Tufa. Për ne të vjetrit dhe brezin e ri të krijuesve, Agron Tufa përbën modelin, talentin e kohës së re. Në një stendë të shkollës së fshatit së bashku me fabulistin e shquar Ferit Lamaj (të cilët kanë respektuar brezat e nxënësve e të mësuesve) zënë vend nderi në katin e dytë. Cilitdo njeri apo intelektual vlerën ia jep vendlindja e tij. Në vendlindje matet pesha e fjalës, drita e veprave, gjurmët e jetës. Agron Tufa ka vepra bashkëkohore për sot dhe për brezat që do të vijnë. Librat e tij janë një thesar i vyer për letërsinë shqipe. Me të drejtë intelektuali i shquar Vasfi Bexhet Cibaku, zv.drejtor i shkollës së Sohodollit, e krahason Agron Tufën me Kadarenë. Ne dhe cilido që takuam krenohej në shpirt me Agron Tufën, me librin e tij më të ri "Kafshë dhe fantazma" i cili mori çmimin libri më i mirë i vitit në panairin e librit në Tiranë.

Urime Agron Tufa! Penda juaj mban bukurinë, thjeshtësinë dhe urtinë e vendlindjes, Sohodollit.

Me ty krenohen brezat, kurdoherë penda dritë!

SHKOLLA E SOHODOLLIT,
VATËR DRITE DHE VEPRIMTARISH

Në Sohodoll rrezaton dritën e kohës, dritën e reformimit stafi petagogjik me 23 mësimdhënës të palodhur. Është shumë e vështirë për cilindo që të veçojë emra mësuesish, sepse çdo edukatore, mesues i ciklit fillor dhe i ciklit të lartë ka përvojen e rij, dhe dallohet në punën organizative me klasën dhe jashtë saj. Drejtori Sulejman Abdiu dhe zv.drejtori Vasfi Cibaku u prin punëve mësimore-edukative dhe veprimtarive. Këta drejtues të përkushtuar dhe stafi petagogjik veprojnë në bllok, duke e bërë shkollën qendër konunitare. Rëndësi të veçantë i kushtojnë mësimdhënies reformuese, veprimtarive me librin, kurseve me rrethe shkencore, njohjes së traditave, përvojave brenda dhe jashtë shkollës.

Në shkollë janë bërë model mjaft kënde e rrethe shkencore si dhe punohet me nxënësit me prirje. Të lënë përshtypje këndet:"Takim me shkrimtarët", "Letrari i ri", "Për një shkollë me vlera", "Shkolla e hapur për komunitetin", "Këtu fillon e ardhmja", "Këndet për fizikën, gjuhën shqipe, matematikën, veprimtaritë, traditat e plot të tjera.

Kjo shkollë shquhet për cilësinë e mësimit e të veprimtarive. Shkollë që rrezaton vlera komunitare, dritë dije dhe lidhje të ngushta me prindërit.

•••

Në Sohodoll, cilido që vete, mëson atë që e kanë thënë brezat dibranë: "Kap e merr". Kjo do të thotë se në Sohodoll ka të Zotë, të ditur për çdo derë e fis dhe kudo që ta vendosësh, i ri apo i vjetër qoftë, ai e bën.

Me krenari zemre e theksojmë se biri i Sohodollit, gazetari i shquar kombëtar Defrim Methasani kohët e fundit u vlerësua me çmim të 3-të në Gjermani, midis mjaft gazetarëve të Europës. E pason udhën e gazetarisë, e bija e Defrimit, bija e Sohodollit gazetarja e shquar Luna Methasani.

Ku rrjedh, pikon - thotë populli. Me Sohodollasit biseduam edhe për doktorin e talentuar Selim Horeshka, që sherben tashmë në Tiranë, për ushtarakët që nuk jetojnë më, por kanë lënë gjurmë si: Agim Methasani e Pellumb Cibaku.

Dritë diturie, dritë pune e bujarie gjen te cilido në këtë fshat. Na mbeti peng se nuk takuam të urtin popullor Shemsi Zuna, se nuk shkuam në kullën e dëshmorit Rexhep Zuna, por këto si edhe intelektualët e arsimit të këtij fshati së bashku me veprimtaritë e tyre do të jenë objekt i një shkrimi tjetër. Përsëri kur largohemi nga Sohodolli mendja na shkon për ata që i kanë dhënë dritë këtij fshati, si poeti i ndritur Agim Vinca (me gen nga Sohodolli), poeti shkrimtari e filozofi Agron Tufa, Hasan Tahsini i shekullit të 21-të Nuri Abdiu. Autorët e librave për Sohodollin si Shuaip Methasani e Qeram Cibaku, drejtuesit e palodhur arsimorë Sulejman Abdiu e Vasfi Cibaku e plot të tjerë. Në mendje na buron ajo që kemi thënë në fillim të këtij reportazhi:

Sohodoll të qofshim falë,
Me breza drite e zemërbardhë!



Drini do ta vazhdojë udhën e vet e derisa ky udhëtim i këtij lumi vazhdon, drama e përditshme, bashkë me embëlsinë e paktë gjithashtu vijojnë, në qytetin e gurgullimit të ujit të Drinit.

Shpresa të thyera…

Nga **SAMET ZAGRADI**

Arlida lindi në një nga fshatrat e thellë të Dibrës. E lindur në një familje të madhe,ku kushtet ekonomike ishin mjaftë të vështira për të mos thënë të papërballueshme për një jetesë normale. Ajo ishte fëmija i parë i kësaj familje duke u pasuar më pas nga 7 motra e një vëlla. Një familje që çdo vit gëzonte ardhjen e një fëmije ,por hidhëroheshin më pas sepse ky fëmijë nuk ishte djalë. Arlida që në moshë fare te vogël u bë krahu i djathtë i nënës së saj sepse e ndihmonte në çdo punë. Atë e admironin të gjithë. Fytyra e saj prej engjëlli, me sy ngjyrë të kaltër e me flokë te gjata bionde në të zeze jepnin asaj një hijeshi të jashtëzakonshme. Me mësime ishte e shkëlqyer pavarësisht kohës së munguar për tu kushtuar atyre. Të gjithë e donin dhe ajo ishte mjaftë e lumtur,duke shijuar moshën më të bukur të saj. Ishte vetëm 14 vjeç kur në derë troket dikush. Ajo e mërkurë Prilli u be fundi i çdo gjëje që ajo po gëzonte deri tani.

E përhumbur nën hijen e një mali gjigand që i vrau çdo shpresë. E tronditur dhe mosbesuese për atë çka asaj i ndodhi. E goditur fort nga grushti mentalitetit famëkeq që e shtriu të pabesisht ne toke. E dërmuar rëndë dhe e pafuqishme të ngrihej sërish. Tentativa për ringritje dështon në momentin kur në mendjen e saj shfaqet çdo gjë që asaj i është mohuar. Ajo tashmë humbi gjithçka. Shpresa për një të ardhme më të mirë largohet dhimbshëm derisa humbet tërësisht në horizontin e pafund. Bankat e shkollës,për të tashmë ishin vetëm një pluhur kujtimesh të bukura,që sa hap e mbyll sytë u zhduken. Shoqëria për të nuk ekzistonte më. Endrrat ndërpriten në mes,pikërisht në momentin kur ajo ëndërronte kaq shumë. Librat qëndrojnë dukshëm në raft,gjë e cila e bën më të vështirë ndarjen nga shkolla. Çdo gjë vdiq, madje edhe fëmijëria e lënë në mes.

Kukullat dhe arushi saj i preferuar qëndrojnë hijerëndë,dhe turinj varur në një cep të dhomës. Ato nuk do të jene më shoqërueset e saj në momente të bukura dhe jo vetëm. Ajo tashmë i braktisi,jo për fajin e saj. Në të qindën e sekondit harroi çdo gjë që kishte kaluar me ta. Dhoma e saj më nuk do te jetë e saj, madje as vetë jeta nuk do ti përkasë më vetëm asaj. E shtrirë,akoma vazhdon të jetë e shtrirë ku të vetmit që nuk e braktisën tashme ishin lotët. Sytë nuk shikonin më asgjë. As imagjinata nuk punonte. Nuk dinte asgjë,madje as veten e saj nuk po e njihte më. Pa dëshirë,pa vullnetin e saj prindërit fanatikë, dhe të bllokuar nga një mentalitet abstrakt dhe fare të papranueshëm për kohën e fejuan,me dikë që se donte,qe se njihte. Ajo ishte akoma fëmijë,dhe një fejesë tashme ishte fundi ë çdo gjëje. Ishte fillimi i marrëzisë dhe shkatërrimit të jetës së saj. Ishte fatalja.

Dikur,dikush,diku paska folur mirë për të. Thashethemi se prindërit e vajzës janë shembullorë,dhe vajza po ashtu, kontribuan në krijimin e fantazisë famëkeqe. Famëkeqe ishte dhe mënyra se si u vendos fejesa me dikë që vajza nuk e kishte idenë kush ishte, me dikë që ishte dyfishi moshës saj dhe që vajza nuk e donte. Ajo nuk donte asgjë, përveç shkollimit te saj. Donte vetëm të ishte dikushi në jetë. Nuk donte të fejohej,sepse për të kjo ishte dhe fundi i çdo ëndrre. E shkëlqyer në mësime,e shkëlqyer në jetë, e mrekullueshme kudo ku ajo ishte,por tashmë këtyre mrekullive u erdhi fundi.

Të drejtat e saj u fundosën përgjithmonë kur në një moshë fare fëmijërore fanatikët të babëzitur nga padituria i vendosin vulën fatit te saj. E sapo dala nga bankat e shkollës 9 vjeçare, e fejojnë më detyrim, pa dëshirën dhe logjiken e saj. Fundosin ëndrrat,dëshirat dhe çdo gjë tjetër që një fëmijë mund të ketë. Fundosin vete bijën e tyre. Fundosin fatin e saj. Fundosin dhe shpresën e tyre për të parë fëmijën e tyre të lumtur,sepse lumtura për të tashme vdiq bashkë me shpresat dhe lumturinë e saj.

Zgjedhja e tyre, nuk është gjë tjetër veçse një zgjidhje momentale e problemit të paragjykimit. Paragjykim ky që bëhet akoma më I madh,me pasoja e parikuperueshme që mund të ketë një martesë e hershme. Pasojat vijnë në kronologjinë e tyre,deri në shkatërrimin e jetës së të gjithë familjes. Pasoja te parikuperueshme,te cilat vijnë nga mentaliteti,frika e fjalëve te botës. Tashmë të gjithë janë penduar,edhe prindërit që dikur ishin produkt i trashëgimisë aspak te dëshiruar te mentalitetit tashmë janë bërë liberal dhe mendime perëndimore. Tashmë motrat dhe vëllezërit tjerë trajtohen ndryshe. Tashmë pendimi behet pjesë e të gjithëve. Pendim. Po a ja vlen të pendohesh tashmë?

Qyteti ku gurgullon Drini

Nga **DIONIS XHAFA**

Shkrimtari i njohur Ivo Andriç, ndoshta më kolosi që ka pasur letërsia serbe ka një libër të titulluar "Ura mbi Drin". Andriç i vendos ngjarjet në Bosnjë dhe tregon sesi në atë vend bashkohen kulturat, aty jetojnë bashkë myslimanë e të krishterë dhe sesi "përplaset" keqas Lindja me Perëndimin.

Shkrimtari serb përshkruan tipikisht një realitet ballkanik. Ai realitet që përshkruan Andriç në veprën e tij dhe që është faktik sipas tij në shtetin e Bosnjës, në fakt është faktik edhe në Dibër. Qytetet e Bosnjës dhe ai i Dibrës duhet të ngjasojnë shumë, vërtetë. Të dyja vendet kanë popullsi dërrmuese myslimane, në një zonë evropiane, por të shkëputur disi nga Evropa, pas pushtimit turk.

Të dyja vendet kanë tradita të fuqishme, nga ata tradita që janë të thella dhe më rrënjë të lashta, ashtu sikundër edhe një humor të zi deri diku, pasi gëzimin në këto dy vende rrallë e gjen. Përse ndodh kjo? Kjo gjë ndodh sidomos me rininë.

Pasi ata kalojnë fëmijërinë duke udhëtuar rrugëve në këto vise të Ballkanit, kur vjen rinia, njerëzit këtu duhet që të punojnë fort që në moshë të mitur ose të ikin larg e më larg, diku në Perëndim, për të punuar fuqishëm. Kështu përshkruhet drama e të rinjve në Bosnjë nga ana e autorit serb në fjalë dhe kjo dramë është edhe në Dibër. Në qytetin ku gurgullon Drini, djemtë "arratisen" sapo të vijë një moshë që mund të konsiderohet madhore. Ata ikin jashtë, për të punuar që në moshë të re, pasi kështu funksionon Shqipëria.

Në këtë vend, që në moshë fare të mitur njeriu bie në hall se çfarë do të bëjë. Kjo sepse prindërit rezultojnë të kenë mbaruar, brezi i tyre të jetë shuar së punuari dhe fëmijët mbesin vetëm, e shumta me një shtëpi, e cila lihet nga ana e prindërve.

Por, edhe atë shtëpi nuk është se ke çfarë e do. Aspak! Shtëpia është hotel thonë dhe se ajo para nuk të jep. E, kështu të rinjtë detyrohen të ikin jashtë.

Kur ata ikin jashtë, këtu ka dy rrugë kryesore: ata ose punojnë ndershmërisht, merren me një punë që vërtetë ia vlen ose hyjnë në rrugë qorre, në një rrugë e cila nuk është aspak e duhur. Ja kështu funksionon thuaje mbi 60 për qind e ekonomisë në Dibër, me djemtë që arratisen jashtë vendit në mënyrën më të parë, pasi e dinë se jeta aty nuk zhvillohet mirë.

Kështu duket se të dyja vendet janë njëlloj, si Bosnja që përshkruan autori që kam cituar, edhe Dibra. Të dyja vendet mbajnë të rinj ballkanas, të etur për liri paksa, për një jetë më të mirë dhe më të begatë. Kjo është edhe historia më e rëndomtë e Dibrës, e djemve që ikin që në rininë e hershme dhe e braktisjes masive që i është bërë. Kjo sepse është dilemë e madhe që të rrish apo të ikësh.

Nëse do të qëndrosh, ti e di shumë mirë se qëndrimi yt do të thotë vuajtje dhe robëri tërë kohës, pa e pasur mundësinë të krijosh ndonjë pasuri të hajrit. Kurse, nga ana tjetër ikja vërtetë është e rëndë, ama mund të kesh më shumë alternativa për një jetë e cila të bëhet më e mirë. Ikja do guxim, shumë të madh madje.

Ikja është e rëndë dhe atë rrallë kush mund ta bëjë, por se shumë nga ata që e kanë bërë edhe ikjen përfundimtare, të shumtë kanë qenë që përmes guximit kanë përfunduar mirë.

Kështu qyteti qëndron aty, me djemtë që kanë ikur jashtë duke punuar në të shumtë dhe për të ëndërruar për jetë më të mirë. Këta djem përbëjnë edhe ekonominë më të mirë të Dibrës.

Nëse nuk do të ishin ata, shumë familje nuk do të kishin mirëqënien e duhur në vendlindjen e tyre. Kështu është bërë brez pas brezi. Në moshën 20-vjeçare në Dibër njeriu piqet, djali burrërohet.

E, çfarë ndryshimi me Perëndimin. Por, këtu kështu është për shkak se ta imponon koha, pasi në shumicë prindërit e tu kanë falimentuar dhe të duhet të dalësh përtej portës, për jetë më të mirë dhe për një familje gjithashtu që jeton më mirë.

Fundja, do të krijosh edhe familjen tënde. Ky është qyteti halleshumë, poshtë të cilit gurgullon ujët e Drinit valëshumë.

Ky është qyteti hijerëndë i problemeve dhe i halleve, që thuajse kurrë nuk përfundojnë. Drini do ta vazhdojë udhën e vet e derisa ky udhëtim i këtij lumi vazhdon, drama e përditshme, bashkë me embëlsinë e paktë gjithashtu vijojnë, në qytetin e gurgullimit të ujit të Drinit.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

profil

Kjo fabrikë 20 vjecare është një investim serioz dhe është një ndër fabrikat më moderne të rajonit dhe me teknologji bashkohore në Maqedoni, për prodhimin e jufkave.

Jufkat, tradita dhe biznesi i dibranëve

Nga **Beqir SINA**

Në kuadër të një udhëtimi të gjatë dhe mjaft të bukur, nëpër Shqipëri, Kosovë, e viset shqiptare, ndalesa e radhës ishte në Dibrën time. Ku me shumë kënaqësi, vizitova komunën e Dibrës, dhe pashë nga afër edhe ndryshimet e mëdha të qytetit, të cilat rezultojnë sot në atë që thuhet me mbajtjen e premtimeve nga ana e kryetarit të saj Ruzhdi Lata - dhe punën e vet dibranëve, sidomos, asaj në rritjen e mirëqenjes së tyre, dhe zhvillimin e biznesit.

"Jufkat e Dibrës" që tani pregaditet në shum treva të Shqiptarisë, dihet se zanafilla e tyre është e dibraneve, prej qytetit e Dibrës. Tani jufkat e dibrës mund të pregaditen në mënyra të ndryshme dhe me makina të ndryshme, mirëpo në Dibër me heret jufkat e famshme dhe të shijshme të Dibrës, janë pregaditur me dorë, dhe me një mjeshtri të përsosur, nga amviset dibrane.

Simbas, kryetarit të komunës së Dibrës, zotit Ruzhdi Lata, thuhet se: Atë ditë që gratë dibrane do të bën jufkat duhej pa tjetër, që bijat e shtëpisë që kan dalë nuse pra janë martuar, me gjithë nipat e mbesat hallat e shtëpisë, se ishte nata që do bëhej gatimi me jufkat e para të sesonit. Mirëpo, simbas traditës dibrane, ishte pak e vështirë se kush e niste i pari ose si shprehen dibranët - kush do të derdhi lugën e parë të jufkës. me një domethënje, që ato ishin bërë shumë të mira dhe do të derdheshin gjatë gjithë vitit".

Por, tani kemi edhe diçka tjetër shton i pari i dibrës, zoti Lata, se teknologjia tani ka bërë të veten dhe kemi fabrikat, që prodhojnë jufkat , një ndër to është edhe fabrika nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", më e madhja dhe më moderrnja në rajon për prodhimin e jufkave, e cila vitin e ardhshëm feston 20 vjetorin dhe që ka katër vjet e cila ka hyrë edhe në tregun amerikan. Kështuqë, duke, kujtuar jufakat e Dibrës, me ndihmën e talentit dibran Lundrim Paçuku - mu dha rasti të vizitojë, edhe fabrikën e famshme të jufkave dibrane "Besmir Komerc", e cila është në hyrje të qytetit të Dibrës së Madhe -

Kjo fabrikë, 20 vjecare është një investim serioz, dhe është një ndër fabrikat më moderne të rajonit dhe me teknologji bashkohore në Maqedoni, për prodhimin e jufkave.

Fabrika "Besmir Komerc", në rajonin e Dibrës, vitin e ardhshëm ka 20 vjetorin e saj dhe po përgatitet, tha pronari i saj Munir Papraniku, të festojë këtë jubile me arritje në fushën e biznesit.







Fabrikën e famshme të jufkave dibrane "Besmir Komerc", në hyrje të qytetit të Dibrës së Madhe - fabrikë, 20 vjecare, një investim serioz , dhe është një ndër fabrikat më moderne të të rajonit dhe me teknologji bashkohore në Maqedoni, për prodhimin e jufkave.

Munir Papraniku: Jam i zgjënjyer me autoritet qeveritare në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, që lejojnë tregun e pandershëm dhe nuk favorizojnë këto biznese. Kjo fabrikë, 20 vjecare është një investim serioz dhe është një ndër fabrikat më moderne të të rajonit dhe me teknologji bashkohore në Maqedoni, për prodhimin e jufkave.

Ai kujton sot se si e nisi këtë biznes rrugën e suksesit, duke thenë se " Kjo, fabrikë ishte një objekt i vogël me 70 metra katrorë, dhe e vjëtër nga teknologjia.

"Por, më 1997, shtonë Papraniku, ne nisëm të ndryshojmë fabrikën ngaqë edhe produktet e saj, po kërkoheshin shumë në atë kohë. Ndërkohë, që tekonologjia e saj dhe rritja e fuqisë prodhuese ka qënë kriza në Kosovë, sipas tij, atëhere ishte rritja e kapaciteteve dhe moderrnizimi, pra, zgjerimi i ndërtesës që është sot, e cila është bërë për 65 ditë, dhe në nivel të prodhimit të rregullt, duke arritur deri në 200 e 60 mijë kilogram, ndihma vetëm për Kosovën, në kohën e krizës së saj".

Tani, ai thotë se ne shpresojmë se ky investim, i cili është ndër të parët në Dibër të Madhe, prej se kur Maqedonia, shpalli pavarësinë e saj, do të jetë edhe një histori suksesi, natyrishtë, edhe një nxitje, ndoshta edhe për shumë investitorë të tjerë, dibranë, sidomos, ata në SHBA, dhe Europë, që do të ndikonin për një zhvillim të qëndrueshëm në ekonominë dhe mirëqenien e popullatës në Dibër të Madhe.

Pronari i kompanisë, Munir Papraniku, rrefehet se është shumë i kënaqur me tregun e jufkave, por dëshira e tij është që ajo të ketë edhe më shumë treg në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe trevat shqiptare, mbasi ky hynë në ushqimet tradicionale shqiptare të kësaj treve.

Zoti Papraniku, gjithashtu shprehet i zgjënjyer me autoritet qeveritare, në Kosovë , Shqipëri , dhe Maqedoni, që lejojnë tregun e pandershëm dhe nuk favorizojnë këto biznese.

Lundrim Paçuku, gjatë shoqërimit tim në vizitën në Dibër të Madhe, duke me treguar fabrikën e jufkave një ndër më të njohurat dhe më të vizituarat në këtë komunë, tha se: "Prej shumë kohësh edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fabrika nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", për prodhimin e jufkave, ngase kualiteti nuk njeh kufi !.. vazhdon dërgimin e kantenave me jufkat e Dibrës, drejt në Amerikë..."

Madje, sipas tij, është për të ardhur keq, se: "Në Kosovë, si për shembull më parë hyjnë produktet ushqimore nga Serbia, sesa ato vendase", ndërsa shtojë ai marketet në Shqipëri, e Maqedoni, më shumë marrin prodhimin në të "zezë', se sa këtë të licensuar nga ministria ".

Andaj thote ai çfarë kemi arritur deri tani dhe të depertojmë me këtë biznes në tregjet, e ndryshme, duhet se e kemi bërë vetëm me forcat tona.

Në një kontrat me kompaninë e shpërndarjes së produkteve ushqimore në SHBA, Euro - Products, me bazë në Paterson - Nju Xhersi, fabrika nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", më e madhja dhe më moderrnja në rajon për prodhimin e jufkave, mbasi ka 4 vjet që hyrë tashmë edhe në tregun amerikan të produkteve ushqimore, nisi kontenieret e tjerë, për në tregun e SHBA.

Lundrim Paçuku, gjatë shoqërimit tim në vizitën në Dibër të Madhe, duke me treguar fabrikën e jufkave një ndër më të njohurat dhe më të vizituarat në këtë komunë, tha se: "Prej shumë kohësh edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fabrika nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", për prodhimin e jufkave, ngase kualiteti nuk njeh kufi !.. vazhdon dërgimin e kantenave me jufkat e Dibrës, drejt në Amerikë..."

Fabrika, nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", më e madhja dhe më moderrnja në rajon për prodhimin e jufkave, me një përvojë disa vjeçare, ka pasur një aktivitet të madh në aspektin humanitar dhe të ndihmave.

Ajo në luftën e Kosovës, pothuajse dy muaj punojë falas - duke funizuar kampet e të shpërngulurve me prodhimet e miellit - jufkat e makaronat, luftën në Maqedoni, dha ndihma, ashtu si dhe në krizat në Kumanovë, dhe fatkeqësit natyrore në Shkup, e Shqipëri.

Më 8 gusht - përmbytjet që ndodhën atje - duke u solidarizuar me vëllezërit tanë nga Hasanbegu, Komuna Dibër e Madhe, në bashkëpunim me pronarin e fabrikës " BESMIR KOMERC" z. Munir Papraniku, si dhe biznesmenin nga SHBA z.Muharem Shehu, derguan 3000kg (makarona, jufka si dhe prodhime të tjera te bardha).

Duke folur me pronarin e kësaj fabrike, zotin Papraniku, ai thotë se :" Fabrika, e jufkave nga Dibra e Madhe "Besmir Komerc", aktivitetin e saj të ndihmave dhe humanitar do vazhdoj pandërprerë me qëllimin për tju ndalë në ndihmë banorëve të çdo treve shqiptare, kudo qoftë ajo duke treguar se bujaria Dibrane, nuk do të mungoj".

Intervistë me Mexhit Prençin, kritik letrar

Tri arsye pse i kam mohuar ato që kam

Nga **BUJAR KAROSHI**

Mexhit Prençi është i njohur si kritik letrar, studiues, eseist e publicist. Kritika e tij është zë i veçantë në rafshin e dramës dhe të spektaklit.

Mexhit Prençi ka lindur në Bardhaj-Reç të Dibrës, më 15 mars 1937. Që nga viti 1961 e këtej jeton e punon në Tiranë. Moshatarët e tij dibranë e njohin dhe e vlerësojnë, të rinjtë janë të pakët ata që e njohin, ca të tjerë e kritikojnë se ka bërë pak për Dibrën në rrafshin e letrave, ndaj, një intervistë me të për gazetën ishte e planifikuar prej kohësh.

Mexhit Prençi e ka filluar punën si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën shtatëvjeçare "Gjokë Doçi" - Lurë 1955-1956, drejtor i shkollës shtatëvjeçare Zalldardhë në vitet 1957-1958. (Është drejtori i parë që ka hapur shtatëvjeçaren me 15 nxënës, ku jepte pothuajse shumicën e lëndëve). Më 1959-1960 punon në shkollën shtatëvjeçare Kastriot. Ndjek studimet në Shkollën e Lartë për Aktorë "Aleksandër Moisiu" në Tiranë, 1961-1965.

Në vitin e tretë dhe të katërt të studimeve ka qenë edhe korrespondent i gazetës "Bashkimi". Më 1965-1967 punon inspektor për teatrin në Ministrinë e Kulturës me ministër Fadil Paçramin.

Më 1967 gjer më 1974 ka punuar në Shtëpinë e Botimeve Skenike, shef i sektorit të skenës (dramë, estradë, skenë e fëmijëve), ku drejtonte edhe revistën "Teatër".

Më 1974 dënohet për disa drama e komedi me gabime ideologjike (gjashtë vjet në fshat) si: drama "Ishin të gjithë bijtë e mi" e Artur Milerit, "Stuhi në prill" e Skënder Luarasit, "Mosha e bardhë" e Dritëro Agollit, "Jashtë bie shi" e Minush Jeros, "Shoqja K dhe të tjerët" e Mexhit Prençit. Në vitin 1982 rikthehet përsëri në Shtëpinë Qendrore të Botimeve Skenike si drejtues i revistës "Teatër" dhe pedagog i jashtëm në Departamentin e Historive të Artit, në Akademinë e Arteve.

Fillimviti 1990 mbyllet revista dhe Institucioni. Nga 1991-1998 punon si pedagog i brendshëm në Akademinë e Arteve.

Po e nis intervistën me pyetjen si e keni nisur krijimtarinë dhe si e shpjegoni që shumica e poetëve e nisin krijimtarinë me poezi, siç e keni filluar edhe ju?

Çdonjëri në një farë mënyre e ka brenda vetes poezinë, që në fëmijëri: dikush e shpreh herët, dikush me vonesë, ca të tjerë (të rrallë) e fillojnë me prozë apo artet pamore. Është prirje individuale brenda botës të secilit, ashtu siç është edhe kënga. Kjo është e kuptueshme, ndoshta shkencërisht dhe e pashpjegueshme. Preferoj të zbres në terrenin konkret.

Kam filluar të shkruaj që në shkollën fillore në Badhaj-Reç, po nuk ia tregoja askujt vjershat, druhesha për vlerat e tyre. Në shkollën e mesme "Ndrec Ndue Gjoka", e cila përgatiste mësues për zonat e largëta për gjithë vendin, lëndën e gjuhës dhe të letërsisë na e jepnin shkrimtarët Petro Marko dhe Gjergj Zheji. Hartimet e mia i vlerësonin dhe shpesh i lexoja para klasës. Kishin një frymë poetike. Ata e pikasën këtë dhe më nxitën të shkruaja poezi e t'i botoja. U entuziazmova dhe shkruaja vazhdimisht, por nuk guxoja t'i dërgoja në ndonjë gazetë.

BOTIMET E MEXHIT PRENÇIT:

Botime në revistën "Teatër": 8 drama, 6 pjesë teatrore për fëmijë, 30 pjesë radiofonike për "Teatri në mikrofon",1967-1972. Drama "Krismat dhe daullet" 1985, botuar nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
Disa nga veprat më me vlera botuar në revistën "Teatër": drama "Çështje e hapur" (Fituese e çmimit të tretë në konkurs kombëtar. "Shoqja K dhe të tjerët" (ndaluar nga censura).
Tituj dramash për fëmijë: "Jonida", "Shoqja jonë" (Fituese e çmimit të dytë në konkurs kombëtar, bërë edhe film). Tituj pjesësh radiofonike: "Treqind duvakët e kuq" 1970, "Mahmut Daci, nuk ban ma nana" 1971, "Tek e Vramja e Dheut" 1972.
Në rrafshin e publicistikës mbi 700 artikuj, fejtone, ese.

LIBRA TË BOTUAR PAS VITIT 1990:

Monografia "Marie Logoreci" SHB "Logoreci", 2001
"Shqipërisë i duhen burra shteti, jo aventurierë dhe gangsterë" 2002
Kolana "Kritika e përzgjedhur":
KRITIKA 1 – dramë, regjisurë, aktrim. SHB "Omska", 2008.
KRITIKA 2 – Drama dhe spektakli i ndaluar (monografi) SHB "Ombra GVG", 2010.
KRITIKA 3 – Ese dhe profile poetike. SHB. ADA, 2014.
KRITIKA 4 – Studime. SHB. SAGA, 2016.



Dikush mund ta pëlqejë kritikën time, dikush jo. Kështu jam i kënaqur. Sipas meje, një libër që pëlqehet nga të gjithë nuk ka vlera të larta, sepse njerëzit janë të ndryshëm në perceptim, përjetim, në gjykim, shije, bindje dhe vlerësim. Unë njerëzit nuk i shoh si kope. Vlerësoj ata që gjykojnë me kokën e tyre dhe janë vetvetja. Po fatkeqësisht këta nuk janë shumicë.

Kur e mposhtët ndrojtjen dhe guxove të botosh?

Në vitin e dytë të studimeve në "Shkollën e Lartë për Aktorë "Aleksandër Moisiu". Së pari, botova në gazetën "Zëri i Rinisë", kryeredaktor ishte Miço Verli dhe redaktor Agim Cerga. Pastaj në gazetën "Drita" redaktor ishte Ismail Kadare; në revistën "Nëntori" ishte Gjergj Zheji dhe në revistën "Ylli", ishte Vehbi Skënderi. Në vitin e tretë të studimeve të larta botoja edhe shkrime kritike dhe publicistike.

Dy poezi tuajat janë botuar në librin e klasës së shtatë në fillim të viteve '70. Mendoj se ishte vlerësim për poezinë tënde. Pse nuk keni botuar ndonjë libër?

Me nxitjen e Prof. Gjergj Zhejit, pas botimit në librin shkollor të dy poezive të mia të përzgjedhura nga ai, përgatita për botim 120 poezi.

Redaksia e politizuar e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" vlerësoi 80 prej tyre, por më kishte hequr 20 poezitë më të mira, të papolitizuara. Vajta edhe te Drejtori Ali Abdihoxha, po kushti ishte t'i hiqja. Nuk pranova. Ishin poezitë më me vlera. U mërzita dhe nuk shkrova më poezi. Në atë kohë shpesh botoja shkrime kritike.

Që në fillim pata sukses. Këtu isha më i sigurt. Mendova se mund të bëja diçka që edhe të konkurroja me kritikët e tjerë. Ndërsa në poezi kishte autoritete që nuk i arrija dot.

Ju keni mbaruar Institutin e Lartë të Arteve për aktor, pse nuk e ushtrove këtë profesion?

Nuk jam shquar në rrafshin e aktrimit, kishte shumë më të talentuar se unë. Mirëpo shquhesha në gjykimin e etydeve, të teatrit të lëvizjeve, të analizave të veprave që vinim në skenë etj. Pedagogët Kadri Roshi, Lazër Filipi dhe kryeregjisori i Teatrit Popullor Pandi Stillu më mbanin afër dhe me nxitën të orientohesha në këtë rrafsh. Më lejoni t'ju rrëfej një episod. Kursi ynë vuri në skenë (si shfaqje diplome) tragjedinë "Romeo dhe Zhulieta" të Shekspirit. (Unë interpretova figurën e Fratit Laurens). Pasi e shfaqëm në Teatrin Popullor (Sot Teatri Kombëtar), e shfaqëm edhe në "Teatrin Migjeni" të Shkodrës. Dramaturgët dhe komediografët shkodranë i jepnin veprat e tyre që t'i lexonte kryeregjisori dhe mjeshtri i skenës Kadri Roshi, ata i drejtonin tek unë dhe u thoshin: "Çfarë t'u thotë studenti ynë, merrini sikur janë mendimet tona". Këtë e kishte pikasur edhe dekani Andrea Malo, i cili në civinë time kishte shkruar: "Është i talentuar ne fushën e kritikës dhe të gazetarisë".

Kur mbarove studimet, të emëruan në Ministri të Kulturës, kush të propozoi?

Nuk e di. Unë sapo mbarova studimet kisha filluar punën në gazetën "Bashkimi". Vitin e katërt të studimeve isha lidhur me këtë gazetë e cila, më punësoi sapo dhashë provimin e fundit. Nuk bëra as pushime. Pas dy muajsh si gazetar i kulturës në këtë gazetë, një ditë të shtune më thërret kryeredaktori Fiqri Vogli dhe më thotë se të kanë emëruar inspektor teatri në Ministrinë e kulturës, po ti mos u paraqit sa të bisedoj me zv. ministrin Pipi Mitrojorgji. "Unë nuk kam dëshirë të punoj në Ministri", i them. "Mos u nxito", më thotë. Të hënën më thërret në zyrë, shko e bisedo vetë me zv.ministrin, po të pret. Pasi e bluajta mendimin me veten, vendosa të shkoj. Më priti zv.ministri me buzëqeshje. "Është nder për ty të punosh në Ministri... e të tjera slogane..." I thash se kam filluar punë në gazetë. Je kuadri ynë, më thotë, apo do të shkosh në Peshkopi. I shpjegoj se kisha detyrime ndaj gazetës, pret prej meje disa artikuj për Metalurgjikun e Elbasanit; 3-4 ditë kam mbledhur materiale në terren... Më ndërpret: "Të hënën eja këtu, ulu në tavolinën tënde dhe një javë puno për gazetën. Unë desha të flas, por ai u ngrit më këmbë dhe artikulon fjalën: "Urime... Të hënën në zyrë!"

Pastaj si rrodhën ngjarjet?

Punova pothuajse një vit në Ministri. Pastaj ndodhën ngjarjet e luftës kundër burokratizimit. Të tetë inspektorët e rinj që na përzgjodhën nga fakultete të ndryshme sipas specialiteteve, të punonim në Ministrinë e Kulturës, na futën në listat e largimit për në bazë. Burokratët e vërtetë mbetën aty, ne të rinjtë, gjoja dolëm vullnetarë që të shkonim

Një vepër e ideologjizuar dhe politizuar jeton aq kohë sa ideologjia që e lindi, me rënien e saj bie edhe vepra.

shkruar sipas metodës së realizimit socialist

të forconim bazën nëpër rrethe. Kështu e bëri ministri Fadil Paçrami luftën kundër burokratizimit. Nuk po flas për peripecitë e dërgimit në Peshkopi që të punoja si regjisor; si më propozuan të shkoja në Bulqizë si drejtor i Klubit të Bashkimeve Profesionale; si debatova me sekretarin e Partisë Sali Stafën, si refuzova dhe kur u largova nga zyra e tij, e më dilte tym nga koka...

I telefonova zv. ministrit Ali Abdihoxha, i cili për dy ditë më emëron regjisor në Shtëpinë e Kulturës Lezhë. Fadili nuk ishte më ministër. Në Lezhë bashkë me drejtorin e Shtëpisë së Kulturës Aleksandër Banushi (shkrimtar i qarkulluar në bazë) dhe kompozitorin Agim Velça, krijuam "Ansamblin Çiftelia".

Sa kohë qëndrove në Lezhë?

Një vit.

Pastaj?

Pastaj më emëruan në Shtëpinë e Botimeve Skenike në Tiranë, e cila sipas modelit sovjetik quhej Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, ndonëse nuk botonte asgjë nga folklori.

Çfarë botonte ky institucion?

Struktura e këtij institucioni ishe e tillë: Sektori i Skenës, (përfshinte revistën "Teatër", buletinin "Estrada" dhe "Bota e fëmijëve". Sektori i Muzikës dhe Koreografisë, i pari botonte buletinin "Kënga" e dyta buletinin me librete koreografike. Sektori i kulturës masive botonte buletinin "Kultura masive". Në vartësi të institucionit ishte edhe "Qendra metodike e kualifikimit të lëvizjes amatore".

Çdo sektor botonte repertor dhe materiale te ndryshme sipas specifikës të secilit.

Ndalemi te revista "Teatër", që drejtonit ju, çfarë botonte kjo revistë?

Botonte pjesë teatrore me shumë akte dhe pjesë me një akt për trupat amatore, drama e komedi për profesionistët, por edhe për amatorët; artikuj profesionalë për teatrin dhe gjithë përbërësit e tij; studime specifike për mjeshtërinë e aktorit, të folurit artistik, platforma regjisoriale, ku shquhej regjisori i talentuar Serafin Fanku, Mihal Luarasi e Kujtim Spahivogli. Botonte edhe dy rubrika: "Mendimi teatror shqiptar", "Mendimi teatror botëror" dhe informacione për veprimtaritë e teatrit shqiptar dhe atij botëror. Një rubrikë e veçantë ishte: "Informacione për veprimtaritë e teatrit shqiptar dhe atij botëror.

Si mundët t'i botonit kur ishte e ndaluar të shpërndaje informacione prej teatrit të botës kapitaliste dhe revizioniste?!

Ishte koha para Festivalit të XI, ku fryma liberale filloi të përhapet në letërsi dhe arte, por edhe në jetën shoqërore. Revista "Teatër" nuk kishte si të mos përfshihej, kur drejtuesi i saj ishte me bindje liberale.

Gjatë kohës së realizmit socialist edhe ju keni shkruar sipas kësaj metode!...

Po, kam shkruar sipas socrealizmit. Edhe si botues i kam zbatuar parimet e realizmit socialist në tërësi. (Ah, ai NENI 55!)... Megjithatë duke qenë me bindje liberale si qytetar dhe njeri i letrave, kjo frymë është ndjerë në veprimtarinë time si botues, po edhe në shkrimet e mia. Shefat e lartë të piramidës nuk i pëlqenin kritikat që bëja unë edhe pse ishin me dorashka.

Me nxitjen e Prof. Gjergj Zhejit, pas botimit në librin shkollor të dy poezive të mia të përzgjedhura nga ai, përgatita për botim 120 poezi. Redaksia e politizuar e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" vlerësoi 80 prej tyre, por më kishte hequr 20 poezitë më të mira, të papolitizuara. Vajta edhe te Drejtori Ali Abdihoxha, po kushti ishte t'i hiqja. Nuk pranova. Ishin poezitë më me vlera. U mërzita dhe nuk shkrova më poezi.

Mund të tregoni ndonjë rast?

Po rrëfej një episod, nga rastet e shumta: Dërgova një shkrim kritik "Si gjykohet një vepër dramatike" në gazetën "Drita" në kohën kur Enver Hoxha shpalli luftën kundër burokracisë. Në shkrimin tim kritikoja autorët pse e shihnin këtë fenomen te nëpunësit e niveleve të ulëta, si: llogaritar, financier apo edhe tek ndonjë shef a drejtor në nivelet mesatare, kur peshën e përgjegjësisë e mbajnë shefat e mëdhenj të burokratizuar të piramidës shtetërore. Nuk ma botoi gazeta. Ripunoje, më thanë, dhe sille. Pasi u mendova ca, dakord u thashë.... Largohem dhe filloi "ripunimin". Nga fjalimi i Enverit në Mat, shkëpus tri thënie të tij, një e vendos në faqen e parë të shkrimit, tjetrën në faqen e tretë dhe të fundit në të pestën. Pas dy ditësh vajta në redaksi, e "ripunova" u thashë. E lexuan: Shumë bukur... mjafton vetëm citati i faqes së parë.

Dhe e botuan. Të nesërmen në mbrëmje shkova në teatër. Në llozhë ishte Anastas Kondo, shef i lartë në KQ të PPSH për letërsinë dhe artin. Unë isha në llozhën ngjitur. Më ftoi të shkoja në llozhën e tij. "Ta lexova artikullin në "Drita"... "Hë, rrufjan... Bukur e kishe argumentuar...." Anastasin e kisha mik kur studionim dhe shkruanim në sallën shkencore të Bibliotekës Kombëtare ai, miku e kolegu im Naum Prifti dhe unë.



Veprimtaria juaj në fushën e letrave shtrihet në dy kohë: në periudhën 1963-1990 dhe 1990- 2016. Cili është qëndrimi yt si krijues dhe kritik?

Në kohën e mbretërimit të socrealizmit kam shkruar sipas kësaj metode, por edhe me frymë liberale, ndërsa pas 1990-tës kam shkruar ndryshe dhe vetëm në rrafshin e kritikës, publicistikës dhe ese-së.

Ndryshe?!!....

Po. Ndryshe. Pas një monologu me veten dhe dialogu me veten e dytë brenda meje, gradualisht jam liruar nga pushtimet e ndërgjegjes krijuese dhe kritike, e vetëm pas një dekade kam botuar librat, duke përzgjedhur ato shkrime që i konsideroj si më të mirat.

Pse para 1990-tës nuk keni përzgjedhur asnjë shkrim apo vepër që keni marrë edhe çmime, t'i botonit në "Kolanën e përzgjedhur"?

Çfarë kam shkruar në periudhën e socializmit pa liri i kam mohuar për tri arsye: E para se shumica kanë qenë të politizuara. E dyta, edhe te shkrimet e papolitizuara ndjehet trysnia e kufizimit të lirisë krijuese, çka nuk kam mundur të arrij nivelin artistik që dëshiroja sipas vështrimit dhe rivlerësimit të tyre nga koha e tanishme. E treta: Ndikim pozitiv tek unë ka qenë edhe një deklaratë publike e dramaturgut Kolë Jakova, i cili në fillimet e lirisë dhe demokracisë së brishtë, bëri atë që nuk e ka bërë askush nga shkrimtarët dhe artistët e realizmit socialist. Deklarata kishte këtë përmbajtje: "Veprat e mia të ideologjizuara dhe politizuara, shkruar sipas realizmit socialist, i mohoj". Ai mohoi edhe dramën "Toka jonë" pikërisht për mesazhin se toka i takon atij që e punon" që sfidonte parimin universal se prona është e shenjtë dhe i takon pronarit të saj, çka është një mesazh absurd që ndez konflikte dramatiko-tragjike edhe në kohën tonë.

Sipas teje, asnjë vlerë nuk kanë veprat e realizmit socialist?

Faleminderit për pyetjen. Sipas meje, një vepër e ideologjizuar dhe politizuar jeton aq kohë sa ideologjia që e lindi, me rënien e saj bie edhe vepra. Kjo nuk do të thotë se nuk ka vlera artistike, historike dhe arkivore si p.sh edhe "Toka jonë", e cila ka karaktere të spikatur që bartin drama të fuqishme, konflikte të forta dramatike, gjuhë skenike dhe dialog dramatik shkruar bukur etj.

Akoma edhe sot pas dy dekadash e gjysmë në demokraci, letërsia e realizmit socialist shpjegohet, analizohet dhe gjykohet po me ato kritere si në kohën e diktaturës, nga kritikë e studiues, por sidomos nga mësuesit e të gjitha niveleve gjer te universitetet. Kjo është e papranueshme, sipas meje.

Një regjisor i klasit të parë dhe i divorcuar me socrealimin mund ta vërë ndryshe në skenë këtë dramë, duke stigmatizuar e ironizuar ideologjizimin e saj dhe personazhet e politizuara.

Unë mendoj se është e drejta e gjithsecilit të veprojë sipas bindjeve të veta me veprën e tij.

Sigurisht, është e drejtë e gjithsecilit Kam dëgjuar disa shkrimtarë që kanë deklaruar se nuk u heqin asnjë presje veprave të tyre shkruar në atë kohë dhe të tjerë që pranojnë politizimin dhe e motivojnë se ashtu ishte koha. Ndërsa ato që e mohojnë veprën e politizuar skajshëm janë të rrallë. Kritika ime kryesisht i drejtohet kritikës profesionale...

A mund ta shpjegosh më tej?

Po. Ka dy qëndrime të kritikës profesionale. Njëri qëndrim vazhdon avazin e vjetër, ngaqë kritiku nuk ka mundur të bëjë katarsin e të divorcohet me realizmin socialist, ndërsa qëndrimi tjetër është i kritikëve që gjykojnë sipas një optike të re alternative me kriterin artistik, estetik dhe mesazhor, ku pesha specifike e vlerës së mesazhit është më e madhe se dy të parat, të cilat janë në funksion të tij. Akoma edhe sot pas dy dekadash e gjysmë në demokraci, letërsia e realizmit socialist shpjegohet, analizohet dhe gjykohet po me ato kritere si në kohën e diktaturës, nga kritikë e studiues, por sidomos nga mësuesit e të gjitha niveleve gjer te universitetet. Kjo është e papranueshme, sipas meje.

Rikthemi te Kolana "Kritika të përzgjedhura". Cili ka qenë kriteri i përzgjedhjes?

Kriteri i përzgjedhjes ka qenë ai i cilësisë artistike dhe mesazhit. Disa shkrime që i kam konsideruar më të vlertë i kam botua edhe në dy libra në variante te reja. Dëshiroj që lexuesi të më gjykojë sipas librave "Kolana e Përzgjedhur". Dikush mund ta pëlqejë kritikën time, dikush jo. Kështu jam i kënaqur. Sipas meje, një libër që pëlqehet nga të gjithë nuk ka vlera të larta, sepse njerëzit janë të ndryshëm në perceptim, përjetim, në gjykim, shije, bindje dhe vlerësim. Unë njerëzit nuk i shoh si kope. Vlerësoj ata që gjykojnë me kokën e tyre dhe janë vetvetja. Po fatkeqësisht këta nuk janë shumicë.

E fillova intervistën me pyetje si e ke nisur krijimtarinë dhe po e mbyll me pyetjen: Cili do të jetë libri i pestë?

Librin KRITIKA – 5, kam menduar ta titulloj, REFLEKSIONE, të cilat do të jenë nga fusha të ndryshme, shkruar me stilin e ESE-së.

Ju falënderoj për intervistën!

Edhe unë ju falënderoj juve, që nëpërmjet kësaj interviste më dhatë hapësirën e nevojshme të komunikoj me lexuesi e gazetës "Rruga e Arbërit", por edhe me çdo lexues tjetër.

Rruga e Arbërit nr. 127 128

reportazh

Piktori Serxho Petrela,
i parë me sytë e një miku



Prej balte me qenë, prej Dibre të jesh

"Ej, edhe unë jam nip Dibre, se mbiemrin e vajzërisë nëna ime e ka Tola dhe është nga Golloborda, nga krahina nga ku ka qenë piktori Bajram Mata. "Unë nuk kam arritur ta njoh, por kam dëgjuar se ka qenë piktor e njeri i mirë dhe se ka vdekur në mënyrë tragjike dhe të trishtë."

Nga **SELAMI NAZIFI**

NJOHJA

Sapo kishim ardhur nga Peshkopia në Tiranë ato vite kur Shqipëria u hap ndaj perëndimit dhe ndoshta, si vetvetiu, u vendosëm në lagjen e dibranëve për të ndërtuar jetën në kryeqytet. Tjetër botë, sigurisht. Njerëz të ndryshëm, dialekte të ndryshme në Tiranën e atyre viteve. Dhe në rrugën që përshkoja çdo ditë, "Hoxha Tahsim", si lija pas Shkollën e Kuqe, diku në rrugicën pas saj, më binte në sy një dyqan ku shiteshin piktura. Për ne të ardhurit, që ndërtonim ngado nëpër kryeqytet, më shumë na tërhiqnin dyqanet e materialeve të ndërtimit, sesa gjithçka tjetër, por ja që mua më tërhiqte pa masë ai dyqan arti. Pasi isha futur në të 2-3 herë më parë, rastisa një mbasdite të takoj vetë autorin e pikturave. Pasi i tregova se jam i ardhur, (në atë kohë identiteti ynë binte në sy menjëherë) i thashë me një lloj sinqeriteti, që, siç dukej më lexohej në sy: "Më pëlqejnë punët e tua, por... jam i interesuar për piktura që përmbajnë motive jete në fshatra".

Gjithkush në vendin e tij do më kundronte nga koka te këmbët për të gjetur brenda meje fshatarin dhe katundarin, që pëlqente ca ngjyra të ndezura fshati, por ai m'u kthye pa shprehur asnjë habi të tillë.

"Më fal, por për momentin nuk më ndodhen, por po të duash të rekomandoj te një kolegu im këtu pranë". Dhe ashtu u bë. Gjatë rrugës që më shoqëroi, bëmë biseda të ndryshme. Ndërkohë unë po e vështroja me vëmendje këtë djalë, rreth të tridhjetave, shumë simpatik, me flokë e sy të zinj, i gjatë në trup, me një fytyrë paqësore. Më bëri përshtypje sjellja e tij. Nuk pashë asnjë shenjë xhelozie apo pakënaqësie që nuk bleva pikturat e tij. Më la te dera ku më rekomandoi dhe u kthye sërish qetë-qetë në punën e tij. Pa smirë dhe ego, edhe pse unë bleva disa punë te kolegu i tij piktor, ndoshta fare i panjohur për të. Më pat mbetur gjatë ndërmend portreti i atij djali piktor, që ende nuk i kisha mësuar as emrin. Ndodhin në këtë botë që disa gjëra lidhen me frymën dhe nuk është nevoja të shtrosh fjalën në bisedë. Flasin sytë. Flet zemra. Si vetiu këmbët filluan të më çonin më shpesh në lokalin e tij, ku shihja me kënaqësi punët e tij të bukura të varura në mure. Pastaj biseda kalonte te piktura, te Tirana e madhe, te ngjarjet e ditës, te demokracia e brishtë, për të cilën flisnim me shumë pasion. Ky ishte piktori Serxho Petrela, me të cilin do të më lidhte një miqësi e vyer për vite me radhë dhe do të zinte vend në zemrën time sot dhe gjithë kohën.

SERXHI, MË SHUMË SE NJË DIBRAN!

Erdhi shpejt momenti ku më duhej të blija 2 piktura për vajzën që do të hynte në shtëpi të re. Tashmë, pa asnjë dyshim, do t'i merrja në dyqanin e Serxhit, por, kur kishin folur për plot gjëra të bukura të kohës, të demokracisë





dhe të miqësisë që po forcohej dita-ditës, tani kjo puna e pazarit, ku ka brenda paksa edhe motivin e pazarllëkut, më stepte dhe më bënte ta vuaj këtë pjesë. Megjithëkëtë, kur, siç thashë, këmbët më çonin si vetiu thuajse çdo ditë tek Serxhi, i propozova të më shiste dy piktura nga të tijat. Mbeta i kënaqur si

Po e vështroja me vëmendje këtë djalë, rreth të tridhjetave, shumë simpatik, me flokë e sy të zinj, i gjatë në trup, me një fytyrë paqësore. Më bëri përshtypje sjellja e tij. Nuk pashë asnjë shenjë xhelozie apo pakënaqësie që nuk bleva pikturat e tij. Më la te dera ku më rekomandoi dhe u kthye sërish qetë-qetë në punën e tij. Pa smirë dhe ego...

nga tablotë e punuara me mjeshtri dhe nga çmimi. Me atë sjelljen e tij prej kavalieri, më kishte hequr tërë merakun "e të bërit pazar". Pas kësaj vizitat në dyqanin e pikturave i bëja më shpesh, sidomos pasdite, kur autori Serxho, pas orës 18:00, qëndronte në lokal. Më ftoi ta ndiqja punën e tij edhe në studio; një apartament në katin e katërt të një pallati; ku mbante erë bojëra, llak dhe, telajo të lyera, dylient etj. Rrija me orë të tëra në atë mjedis kaq të shkujdesur dhe plot jetë, saqë po lija pas plot punë të pakryera, por dhe miq e shokë. Se nga ne thuhet: "Miq të rinj zër, por të vjetrit mos i harro!" Por njohja me mikun tim të ri, piktorin Serxho Petrela erdhi duke u shtuar kur mësoi se unë isha dashamirës i artit figurativ dhe aq më tepër pse isha dibran. Një ditë më drejtohet: "Ej, edhe unë jam nip Dibre, se mbiemrin e vajzërisë nëna ime e ka Tola dhe është nga Golloborda, nga krahina nga ku ka qenë piktori Bajram Mata".

U ndjeva mirë, se të ndjerin Bajram e kisha mik në vitet e Peshkopisë. Por Serxho vijoi:

"Unë nuk kam arritur ta njoh, por kam dëgjuar se ka qenë piktor e njeri i mirë dhe se ka vdekur në mënyrë tragjike dhe të trishtë. Pastaj mos harro, se unë jam lindur e rritur në Tiranë, në lagjen e dibranëve e afër shtëpisë së muzikantit të njohur Agim Krajkës. Dhe shumë shokë fëmijërie i kam dibranë.

Mbaj mend plakat dibrane (gjyshet e shokëve) që mbanin shami të bardha në kokë, me përparëse e nallana e me fshesën që s'e hiqnin nga dora e veç lanin oborrin me lule e pemë deri te gurët e sokakut. Dhe kur vinte koha e drekës u thërrisnin fëmijëve në dialektin e Dibrës: "Ceni xheç këtu, jec në shtëpaj se ta bëna gropën. Ku shkojshë mër me këpucët me baltë brenda në shtëpaj, Jec mër këtu të të veshi njiher... Ju kam shpërt nana mos ma ngani vocin" etj., e vazhdon më tej bisedën: Unë ndjehem i kënaqur që kam rrënjë në Dibër dhe e di si më ka thënë një shok i imi nga Dibra e Madhe, L. P. se: "Prej balte me qenë, veç prej Dibre të jesh". E vazhdon e vazhdon me episode me një interesim të veçantë për Dibrën.

Unë i them: "More Serxho, unë jam babai yt në moshë dhe nuk i kam dëgjuar këto thënie!"

"Eh, po mos harro se unë jam rritur në Dibër të Madhe të Tiranës.

ARTISTI I NDJESHËM
NDAJ BOTËS SË NJERIUT

E kështu ditët, muajt e vitet që pasuan duke qëndruar me njëri-tjetrin nuk e patëm të vështirë të ishim miq. Natyra e tij shumë njerëzore, e hapur, e lexueshme shumë shpejt depërtuam deri në imtësi të karakterit dhe të personalitetit të njëri-tjetrit. Ky djalë me prejardhje nga një ndër familjet më të vjetra tiranase nga fisi Petrela, me prindër intelektualë dhe vetë zotërues i dy gjuhëve të huaja, anglisht dhe italisht, me profesion artisti (piktor), më bënte që unë të ndjehesha mirë shpirtërisht dhe në shoqërinë që e rrethonte Serxhin me kolegë piktorë, intelektualë, biznesmenë, sportistë; me Altinin, Blendin, Gjergjin, Andonin, Zaimin, Edgarin, Leonardin, Pëllumbin, Çimin etj., deri dhe miq të huaj.



cyan magenta yellow black

Në pamundësi për të krijuar një peizazh pikture me ngjyra të ndezura për Ju, falë edhe redaksisë së gazetës "Rruga e Arbërit" që pranoi të botojë këto radhë, po të dhuroj këtë reportazh me fjalë.





Miku apo shoku nuk njihet vetëm nëpërmjet bisedave, por më shumë nga episodet e jetës së përjetuar qoftë edhe rastësisht. Mbaj mend kur hyri në dyqanin e pikturave një zonjë e moshuar, pasi pa pikturat qëndroi më gjatë te njëra. Nuk dihej ç'motive e shtynin të mbetej gjatë përpara njërës prej tablove me motive nga deti... kishte mbetur pa gojë. E hutuar brenda saj. Serxho i afrohet dhe i thotë:

"Të pëlqeu?"

"Po, - ia kthen zonja, - por më duket e shtrenjtë për mua".

"Merre sa të duash, caktoje vetë çmimin".

Plaka ishte kthyer dhe e kishte vështruar në sy. Si kishte numëruar ato pak lekë që kishte me vete, pagoi tablonë, ndërkohë Serxhi merr një pikturë me dimensione më të vogla, ia drejton duke i thënë që këtë pikturë e ke dhuratë nga unë. Zonjën e preku shumë në shpirt, i jep uratat e falënderimit të saj të dala nga thellësitë e shpirtit.

I shihja edhe Serxhin, edhe gruan dhe nuk dija se kush ishte më i lumtur atë çast, por vë bast se Serxhit i lexohej në sy mirësia e shpirtit. E ky rast nuk është i vetëm, por rast i shkëputur nga zinxhiri i shumë rasteve të tjera.

FILANTROPI DHE BAMIRËSI BRENDA PIKTORIT

Pas disa kohësh i drejtohem Serxhit: "Dua të hap një dyqan ku të shiten piktura, pasi kam të fejuarën e nipit që ka mbaruar liceun dhe është pa punë. Kam gjetur lokalin, por më duhet ta pajis me piktura. Do më ndihmosh të më japësh disa nga pikturat e tua? Vuri çmimin dhe përkundrejt interesit që do të caktosh, jam gati të filloj nga puna".

Unë po i flisja me seriozitet si për punë "biznesi". Pasi më pa me qesëndi, m'u drejtua:

"Sa piktura të duhen?"

"Sa të duash ti, se do të marr disa edhe nga Zaimi, Hamdiu etj".

Nuk priti më, por u drejtua te pikturat e varura në mur, zbriti 10 copë prej tyre e më thotë: "Çmimin vërja vetë – mua më jep sa të duash..."

Mbeta pa gojë. Kësaj i thoshin të ishe fare pa gjë dhe të bëheshe me një biznes, siç thuhet në gjuhën e sotme. Dhe bujaria e Serxhit, sa hap e mbyll sytë e bënte time mbesë të hynte në radhën e një aktivitetit privat aq shumë i lakmuar sot prej mijëra e mijëra njerëzve, por që iu mungon ajo dorë e parë shtytëse në udhën e suksesit. Të ishte, siç përmenda vetëm rasti i parë dhe aq më keq akoma, vetëm me mua, do ishte një gjë fare e pa rëndësishme për t'u shkruar. Por bujaria e tij nuk fillon e as nuk mbaron këtu, me punën e tij profesionale të pikturës, tablosë dhe portretit.

Dimensioni i tij human, i bujarisë, fisnikërisë dhe altruistit nuk është se rok vetëm një fushë të njohur të tij - artin dhe një rreth miqsh e shokësh, por ajo është shumë më e gjerë dhe ndër vite është kthyer në një pjesë përbërëse të jetë së tij. Janë dhjetëra raste që bujarinë, dorëzgjatjen e ndihmës, i kanë provuar jo vetëm miq e shokë, njerëz të njohur, por dhe njerëz të thjeshtë, nevojtarë dhe shtresa të margjinalizuara. Por ndryshe nga tam-tamet dhe buja që mund të bëjnë mediat dhe shtypi ndaj një rasti të tillë humanizmi, Serxho Petrela ka parapëlqyer t'i ketë këto "pronë të tij", larg dukjes dhe kanë mbetur mes miqve e shokëve të afërt. Me vite të tëra ka ndihmuar me të holla e materiale të ndryshme shtëpinë e fëmijëve jetimë në lagjen tonë, komshinj e njerëz fatkeqë, të braktisur e familje në nevojë, e raste të tilla janë me dhjetëra. Ka mbi 10 vjet që Serxho ekspozon pikturat e tij në muajin dhjetor në hotel Sheraton, ku një pjesë e të ardhurave të fituara shkojnë për shoqatën e fëmijëve në nevojë, pa as më të voglën reklamë ndaj këtij gjesti. Heshtur dhe në mëvetësinë e tij bujare. Ky është ndihmëtari Serxho Petrela.

JO VETËM STUDIO...

Tregova pak më sipër, shkarazi, për studion e Serxhit, e cila nuk është vetëm vend pune për krijimin e pikturave, por ajo më shumë i ngjan një vendi mikpritje, peligrinazhi. Dy dhoma të një apartamenti, një korridor i mbushur me korniza e kuti boje, një aneks ku janë të vendosura soba e gatimit dhe disa enë kuzhine në raftet përkatëse dhe kaq. Ambienti i studios nuk është dhe aq i bollshëm, po të kemi parasysh se aty sa e sa herë shtrohet tavolina e ngrënies për miq e mysafirë apo edhe për njerëz të vobektë të gjetur në mes të udhës të uritur e të drobitur! Por zemra dhe shpirti i tij është kaq i madh sa i nxë dhe tepron vend sa të duash për njerëzit e mirë të Serxhit. Dhe Serxhi është një kuzhinier brilant i çastit. Kjo e fundit është një pasion i jashtëzakonshëm i Serxhit, që e ushtron vetëm këtu, në studio, për arsyen e thjeshtë se nuk i bie radha ta ushtrojë në shtëpi e gjetkë?! Gatuan në mënyrë të shkëlqyer. Kam lexuar se dhe Pikaso ka patur hobi gatimin. Por nga Studio e Serxhit, po hyre, nuk mund të dalësh pa u qerasur, që është më e pakta dhe më e zakonshmja. Në këtë studio është ngrënë bukë jo me dhjetëra, por me qindra e qindra herë, në një ambient ku nuk mungon muzika e Top Goldit, bashkëbisedimet me mysafirët për sportin, muzikën, artin, politikë e tema nga më të ndryshmet. Dhe mos u çudit kur aty, siç përmenda më sipër, të gjesh ndonjë mysafir pak ndryshe dhe që atij do t'i mbushet pjata më shumë dhe ai "mysafir" mund të jetë një fëmijë adoleshent apo një i rritur i pastrehë. Dhe ti nuk vonon ta kuptosh se ky njeri nuk ka ardhur të dëfrehet pas pikturave dhe artit të Serxhit, por nga nevoja utilitare për të jetuar, braktisur nga shoqëria, por jo nga Serxhi. Ai i trajton si të barabartë dhe më mirë se të tjerët. Sa do të doja t'i ngjasoja mikut tim në këtë pikë! Bujar, zemërgjerë dhe brilant!

Të nesërmen e protestës që ishte bërë për lumin e Radikës tek Piramida, pasi takohemi e përshëndetemi më thotë: "Po ti, pse nuk ishte në protestë dje? Çfarë dibrani je, kur s'merr pjesë ti si dibran? Do vinin të tjerët, para dibranëve dhe njerëzve të lidhur me fatin e lumit Radika?!"

PIKTOR I DETIT DHE I MALIT, I JUGUT DHE VERIUT

I plotësuar në gjithë qenien e tij me një ndjesi prej artisti, karakteri i tij është shumë më i gjerë dhe dimensional, përtej kornizave të një piktori, tashmë me karakteristika individuale thellësisht të dallueshme, gati duke krijuar një shkollë të tijën. Ky shpirt i ndjerë prej artisti nuk mund të anashkalojë situatat e krijuara në shoqërinë shqiptare e në mbarë vendin si ato ekonomike, shoqërore, politike etj. Nuk mjaftohet të shprehë mendimet e tij vetëm në bashkëbisedime e në tavolina lokalesh mes miqve të tij, shokëve e kolegë. Përgjegjësia që ndjen ai për problemet e ndryshme shoqërore të akumuluara shkojnë deri në protesta të hapura me revoltë shpirtërore, që e shfaq me forcën e vullnetit të tij si qytetar i këtij vendi, e ushqyer me ndjenjat prej artisti për të mos u pajtuar me gënjeshtrën e të keqen, por vetëm me të drejtën. Piktorin dhe artistin e gjen të pranishëm në shumë protesta me probleme shoqërore si për helmet, plehrat etj. Të nesërmen e protestës që ishte bërë për lumin e Radikës tek Piramida, pasi takohemi e përshëndetemi më thotë: "Po ti, pse nuk ishte në protestë dje? Çfarë dibrani je, kur s'merr pjesë ti si dibran? Do vinin të tjerët, para dibranëve dhe njerëzve të lidhur me fatin e lumit Radika?"

Më fliste i nevrikosur. Ishte i revoltuar se pjesëmarrja kishte qenë e pakët. Të pres në studio më thotë.

Kur shkoj në studio e gjej duke pikturuar jo ulur, por në këmbë, përballë një tabloje me përmasa disi të mëdha. Unë i drejtohem duke i thënë:

- Qenke gjithë nerva, prandaj po pikturon në këmbë.

Më përgjigjet:

- Nervi i krijimit i jep përmasat një vepre arti.

– Pse nuk thua që duhet të të nevrikosim më shpesh.

Nuk m'u përgjigj. Thua se nuk ishte Serxhi. Inatçor, shpatullgjerë, sulmues, me sy të picërruar pas pikturës. Ishte në atë çastin kur vetëm një artist gjen prehje, pas një pune spontane, por që merr prej teje si artist vetë shpirtin dhe thelbin, dashurinë; dashurinë për jetën, dashurinë për njerëzit, për lumenjtë, për malet, për gjithçka.

Profesioni i Serxhit është arti figurativ – piktura. Nuk jam i këtij profili e as ndonjë kritik arti i kësaj fushe e të mund të flas me kompetencë profesionale, por gjatë gjithë njohjes me të, por pikturat e tij ndodhen në 4 pika shitje pikturash në Tiranë, si dhe në Sarandë. Fakti që pikturat e tij shiten, tregon se piktori pëlqehet. E s'ka se si një njeri i mirë, me shpirt të mirë, të mos nxjerrë vepra të mira e të bukura, siç ka shpirtin. Rrugicat tiranase të paraqitura në tablo me aq dashuri, kolorit e dritë janë shprehje e ndjenjës së brendshme të autorit. Me këto tablo ai nuk i pasqyron ato ashtu siç janë, por ashtu siç i ndjen autori, i cili është rritur në këto rrugica dhe ka mall e ndjesi të akumuluar që prej kohëve kur ishte fëmijë e luante në to. Natyrat e qeta të tij janë unikale. Nuk i gjen dy njëlloj dhe mbi të gjitha ajo që pëlqehet është fakti se në 100 apo 200 tablo të paraqitura në ekspozita nga autori, të bie në sy stili i veçantë i tij dhe kjo nuk është pak për një piktor, kjo do të thotë se piktori, edhe pse i ri në moshë, ka krijuar identitetin e tij – siç thotë shkrimtari i madh rus Tolstoi: "Një piktor i madh duhet të formalizojë veten e tij".

Serxhi, i dashuruar pas natyrës, i ndihmuar dhe nga fakti se 6 muaj në vit ai shfrytëzon banesën e tij që ka në Potam të Himarës, është pranë maleve të jugut, pranë detit e ajrit të pastër e me jod, pranë bukurive të fshatrave të Jugut. Natyrë që e ushqen shpirtin e artistit dhe e rinovon muzën e tij. Kjo bën që punët e tij, tablotë, të jenë të pashtershme dhe të mbajnë freski e të bëhen gjithnjë e më të bukura. Përvoja e punës së tij 30 vjeçare mban mbi supe me mijëra e mijëra punë.

Te ngrohtësia familjare me bashkëshorten Entelën dhe 2 fëmijët, Xhein e Ebi, Serxhi gjen qetësinë e tij shpirtërore, e plotësuar kjo me hobin që ka për zhytjet në det dhe gjuetinë me pushkë deti. Edhe në banesën e tij në Potam të Himarës nuk i mungojnë shokët e miqtë e tij si dhe himariotë e të huaj. E kemi parë dhe provuar, shtëpia e tij bujare është gjithnjë e hapur për miqtë.

DY FJALË...

Serxhi! Hodha disa radhë në letër për t'i botuar në një nga gazetat e njohura të Dibrës, si një dibran që jam dhe pa pretenduar se do të kem thënë ndonjë "mrekulli" për Ju, Serxh Petrela. Në të vërtetë, piktura, arti, letërsia gjykohen mbi vlerat e tyre dhe jo mbi vlerat dhe dimensionet e artistit që i krijon. Kjo metodë autobiografike ka rënë dhe nuk ndikon në studimin e vetë veprës. Por unë nuk kisha se si mos them dy fjalë për Ju, miku im piktori Serxh Petrela. Në pamundësi për të krijuar një peizazh pikture me ngjyra të ndezura për Ju, falë edhe redaksisë së gazetës "Rruga e Arbërit" që pranoi të botojë këto radhë, po të dhuroj këtë reportazh me fjalë. Ky shkrim nuk u ngjason peizazheve të tua, këtë e di mirë, por sidoqoftë ai le të merret në konsideratë edhe prej lexuesve të gazetës, se përmban në të vërtetë, vlerësim, sinqeritet e respekt për nipin dibran, piktorin e ngjyrave të ngrohta, artistin e detit dhe malit, Serxh Petrelën. E meqë jemi në prag të Krishtlindjeve, Vitit të Ri dhe datëlindjes së Piktorit, le ta mbyllim me urimet më të përzemërta, shëndet e lumturi në familje. Një shprehje popullore, thotë: A ma mirë një mik apo një çiflig? Unë dhe lexuesi i gjejmë të dyja te Serxho Petrela!

Miku yt, **Selami Nazifi!**





Në vitin shkollor 1916-1917 u hap shkolla shqipe në Allajbegi dhe mësues i parë i saj qe Habib Bajram Golja nga Dibra e Madhe me shkollë normale turke.

100-vjetori i shkollës shqipe në

Nga **Ramazan S. ILNICA**

Menjëherë pas formimit të qeverisë së Fan Nolit, në fshatin tonë u hap shkolla shqipe. U hap në mejtepin e xhamisë, siç quhej dhoma te korridori në të djathtë që ishte shtesë para se të hyje në derën e xhamisë me hark. Mësuesi i parë ka qenë Kadri Hoxha nga Dibra e Madhe. Ai kishte marrë arsim fetar në Stamboll, por dhe ishte veprimtar i shoqërisë patriotike të Stambollit, ku u mor dhe me alfabetin dhe ndihmoi për shkollën shqipe.

Thuhet se ka nisur shkolla shqipe në vitin shkollor 1916- 1917, por me ikjen e austro- hungarezëve dhe me pushtimin serb, në këtë periudhë të tmerrshme për gjithë trevën, shkolla nuk vijoi dhe u mbyll.

Në historikun e Arsimit dihet se Austro Hungaria ka bërë një politikë pozitive arsimore duke filluar me Komisinë Letrare të Shkodrës, por në zonën tonë nuk la gjurmë për t'u mbajtur mend. Po pse u hap shkolla shqipe në fshatin Allajbegi dhe jo diku tjetër? Nga të dhënat , dokumente dhe nga tradita gojore ky fshat ka pasur një traditë më të hershme të arsimit shqip si dhe fshati dhe kleri mysliman kanë qenë dashamirës të mësimit shqip në mejtepin e xhamisë. Do të marrim në konsideratë artikullin e dr. Ali Vishko me titull "Rrethanat arsimore në Dibër e rrethinë në gjysmën e dytë të shek. XIX. Në faqen 79- 80 të librit " Dibra dhe etnografia e saj" vëllimi II me autor Dr. Ali Vishko ku ai shkruan:

Në vitin shkollor 1898/99, sipas burimeve osmane të Ministisë së Arsimit të Stambollit, në Dibër e fshatrat ka pasur shkolla fillore si vijon:

Në Dibër, në qytet: 7 shkolla (vijojnë emërtimet sipas lagjeve dhe vitet e regjistrimit).

Në fshatrat e Dibrës:

Ballancë, regjistruar zyrtarisht në vitin 1886;Allajbegi, regjistruar zyrtarisht në vitin 1891;

Ostren, regjistruar zyrtarisht në vitin 1897; Koxhaxhik, regjistruar zyrtarisht në vitin 1880/81

Sollokiç, regjistruar zyrtarisht në vitin 1886; Elevcë, regjistruar zyrtarisht në vitin 1890;

Zishtë, regjistruar zyrtarisht në vitin 1897

(*SNMU- Selname- i Nazaret-i Ma-arif Umumiye, Istambul 1319(1901)faqe 904, 905)

Për shkollën turke në Allajbegi kemi dijeni nga tregimet gojore të pleqve se ka vijuar për shumë vjet dhe është mbyllur më 1908. Mësohej në turqisht dhe arabisht nga mësues që kishin mbaruar në shkollën Ruzhdie Osmane në Dibër. Nxënësit kanë qenë nga të gjithë fshatrat rreth e rrotull. "Ndikimi i punës së patriotëve dibranë, si: Dervish Hima (Ibrahim Naxhiu, emri i plotë), i Hamdi bej Ohrit, Seit Najdenit në vitet 1895- 1899, bëri që dhe në këto shkolla të mësohej dhe shkrim- këndimi shqip me alfabetin e Stambollit" (sipas Dr. Ali Vyshko, artikulli i mësipërm, cituar nga f. 81).

Prej hoxhë Shaqir Pikut kam dëgjuar se dhe hoxhë Piku i Vjetër dinte të shkruante shqip dhe se ua mësonte dhe ai në mejtep nxënësve të tij, prandaj dhe Hoxhë Shaqiri shkruantee lexonte edhe shqip; po kështu tregonte se edhe shumë shokë të tij në Allajbegi, Majtarë, Podgorcë, Vojnikë etj, që kishin mësuar në mejtep të xhamisë, të cilët dinin të lexonin e shkruanin shqip. Këtë e mbështesim dhe në studimet e myftiut të Dibrës së Madhe, z. Rruzhdi Lata dhe atdhetarit e mësuesit të nderuar të Dibrës Haki Sharofi e të tjera të dhëna të traditës gojore.

SHKOLLA E PARË DHE KUJTIME PËR SHKOLLËN TONË 1924- 1939

Para vitit 1924 ka dokumente të pakta të hapjes së shkollës shqipe si institucion



Jaho Demneri



Jonuz Shehu



Hasan Palushi

arsimor që do t'i përmendim më pastaj me të shkoqitura. Në vitin shkollor 1916-1917 u hap shkolla shqipe në Allajbegi dhe mësues i parë i saj qe Habib Bajram Golja nga Dibra e Madhe me shkollë normale turke. Viti shkollor 1917-1918 ka vijuar shkolla për 4-5 muaj dhe pastaj është mbyllur.

Menjëherë pas formimit të qeverisë së Fan Nolit, në fshatin tonë u hap shkolla shqipe. U hap në mejtepin e xhamisë, siç quhej dhoma te korridori në të djathtë që ishte shtesë para se të hyje në derën e xhamisë me hark.

Mësuesi i parë ka qenë Kadri Hoxha nga Dibra e Madhe . Ai kishte marrë arsim fetar në Stamboll, por dhe ishte veprimtar i shoqërisë patriotike të Stambollit, ku u mor dhe me alfabetin dhe ndihmoi për shkollën shqipe. Në veprimtarinë e tij si hoxhë në Kojnarë e Reshan ai kishte dhënë dhe gjuhë shqipe krahas gjuhës turke e arabe dhe mësimeve fetare. Kur u bë Revolucioni i Qershorit 1924 , ai e përkrahu atë dhe nuk u gënjye nga propaganda e egër që u zhvillua kundër " priftit me mjekër ", që hoxhallarët e tjerë bënin në dobi të Zogut, i cili e kishte bazën në Jugosllavi dhe kryesisht në Dibër të Madhe. Ai në mbledhjen e myftinisë ishte i vetmi që kundërshtoi porosinë e Myftiut për të dëbuar " priftin mjekërzi ", Fan Nolin, që gjoja është kundër fesë myslimane. Për këtë u detyrua të largohet këtej kufirit banojë në Allajbegi. Pleqësia e fshatit i bënë kërkesë qeverisë që të hapnin shkollën shqipe duke kërkuar që mësues të ishte z. Kadri Hoxha. Shkolla u hap në fund të gushtit 1925 dhe vazhdoi deri në vitin e ri 1926. Për këtë mësues nuk ka dokumenta arshivorë, por dëshmi gojore.

Pas largimit të tij u caktua Nebi Agolli dhe nga tradita gojore thuhet se janë zhvilluar provimet dhe janë shpërndarë dëftesat . . Shënim: Shkolla e Kërçishtit rezulton të jetë hapur para vitit 1925, sepse mësuesi Habib Bajram Golja që ka punuar deri më 1925 në Allajbegi (Burim), më 1925 ka punuar si mësues në Kërçisht.

Viti shkollor 1925-1926: Shkolla e Allajbegisë me mësues Nebi Agolli, kishte 41 nxënës.

1926-1927: Shkolla e Allajbegisë me mësues Nebi Agolli kishte 3 klasë me 42 nxënës.

1927-1928 Dibra 23 shkolla.: Shkolla mashkullore Allajbegi mësues Nebi Agolli.

1928-1929:Shkolla e Allajbegisë me mësues Adem Sharofi kishte 30 nx. Kaluan 12 nxënës.

Viti 1929 -1930 e gjeti Dibrën me 30 shkolla.: Shkolla e Allajbegisë me mësues Ismail Jahja e mësues besimi Sadik Imeri (duhet të jetë Sadik Piku i Imer Pikut, shënim R. I.).

Shënim i faqes 152: Numri i përgjithshëm i nxënësve e studentëve 842 me 29 mësues,1 mësuese.

Kjo shifër është e papërfillshme duke ditur se Dibra me Matin sipas regjisrimit të vitit 25 maj 1930 kishte 87 092 banorë. Del se këtë vit shkollor në çdo 103 banorë vetëm 1 ulej në bankat e shkollës dhe më e keqja ishte se vetëm 36 vajza vazhdonin shkollën në 43000 femra. ("Hylli i dritës", viti VI, 1janar 1930 f. 122-125).

1931-1932: Shkolla mashkullore Allajbegi me mësues Ismail Jahja, i cili vdiq dhe u zëvendësua nga Jonuz Shehu kishte 3 klasa me 41 nxënës të regjistruar, 32 nx. vijues dhe kaluan 22 nxënës.

Viti shkollor 1932-1933: Shkolla e Allajbegisë me mësues Jonuz Shehu, kishte 3 klasë me 66 nxënës, 55 vijues dhe 35 kalues.

Viti shkollor 1933-1934: Shkolla e Allajbegisë me mësues Jonuz Shehu, kishte 69 nxënës (10 femra), kaluan 53 nxënës.

Viti shkollor 1934-1935 filloi me 15 shtator 1934: Shkolla e përzier Allajbegi me mësues Jonuz Shehu, kishtë 101 nxënës 21 femra, 90 të rregullt, 18 femra; 66 kalues (11 femra). Në këtë shkollë vinin edhe nga Majtara, Vojnika, Çernena, dy Bllatat, Kurtbeg dhe Kovashicë.

Për shkak të numrit të madh të nxënësve, për mungesë mësuesi, me propozimin e drejtorit të internatit "Dibra", Ferid Imami, ministria e Arsimit aprovoi vendimin që në këtë shkollë të punohej me sistem gjysmë dite dhe mësuesi të shpërblehej me 20 franga ari plus çdo muaj sipas dekret ligjës organike. (shënimi f. 36. AQSHSH, Min. Arsimit, dosja 48, viti 1934. Fq 167.

VITI SHKOLLOR 1935-1936

Viti shkollor 1935-1936 në Maqellarë kishte këto shkolla: Herbel, Kërçisht, Allajbegi, Kovashicë, Maqellarë. Disa mësues të komunës Maqellarë: Halil Golja-Kërçisht, Myslim Shehu- Herbel, Jonuz Shehu- Allajbegi, Hysen Hoxha-Maqellarë.

Rroga:200 franga ari në muaj- 7 mësues, 170 fr. - 1 mësues, 160 fr. - 15 mësues, 150 fr. - 5 mësues, 140 fr. - 15 mësues, me 120 fr. - 10 mësues dhe 100 fr. - 1 mësues.

Në vitin shkollor 1936-1937: Shkolla e përzier Allajbegi me mësues Jonuz Shehu dhe Nazmi Bekteshi, kishte 131 nxënës të regjistruar, 125 të rregullt, 97 kalues. Në këtë shkollë vijuan mësimet 40 vajza, kaluan 35 prej tyre.

Viti shkollor 1937-1938: Shkolla e përzier Allajbegi me 2 mësues, 4 klasë, kishte 133 nxënës të regjistruar, 36 femra. 117 të rregullt, 29 femra, kaluan 98 nx., 20 femra. Në Allajbegi mësues - Skënder Haxhihyseni e Nazmi Bekteshi.

Viti shkollor 1938-1939 e gjeti vendin në përgjithësi dhe Dibrën në veçanti në amulli të plotë. Mbi 95 % e popullsisë nuk dinin shkrim e këndim. Nuk ishin të paktë fshatra që nuk gjeje dhe një njeri të lexonte një letër. Në këtë vit u regjistuan 2056 nxënës dhe nuk u zbatua ligji për detyrimin shkollor. U hapën në Dibër 42 shkolla fillore e plotore në të cilat shërbyen 63 mësues, nga këtu 5 femra.

Shkolla e Drangues (Allajbegi) me mësues Gavril Santo e Skënder Haxhihyseni.

Po japim një fragment nga libri i Xhemal Domit "Dibra në hulli të historisë..." :

...Më 16 tetor 1939 federali, inspektori federal, të shoqëruar nga inspektori i arsimit dhe mjeku major d'Alessandro shkuan në Maqellarë për të asistuar në hapjen e shkollave të asaj komune. Aty ishin mbledhë përveç autoriteteve të komunës edhe kryepleqtë e fshatrave si dhe mësuesit e një grup prej 200 nxënësish të shkollave Kërçisht, Allajbegi etj.

Gazeta "Fashizmi" shkruante se aty u mbajtën fjalime nga federali dhe inspektori federal Të dy "ekzaltuan rëndësinë që ka shkolla në përparimin e një populli si dhe shpresën se regjimi fashist ushqenin në çetën e arsimtarëve, prej të cilëve Shqipëria e re pret dritë e punë të palodhshme jo vetëm brenda mureve të shkollës, por kërkon prej tyre të shtrihet në sferat e pandriçueme të turmës së popullit..." "Fashizmi", 24 tetor 1939 (cit. nga f. 267)

Me rastin e 16 tetorit të përvjetorit të "kurorës"prefekti me të tjerë persona fashistë shpërndanë nëpër shkolla "Dhuratat e Duçes"... ata pastaj kaluan në Maqellarë ku proceduan në të njëjtën mënyrë. Nxënësit i pritën ftohtë këto dhurata. Mandej pati shumë që as nuk pranuan fare ato dhurata. Kjo pritje e ftohtë bëri që autoritetet fashiste të pritnin dhënien e drekës nëpër shkolla ... (f. 271). Dështim që dhe përpjekja fashiste për futjen e gjuhës italiane në shkolla (në klasat e katërta e të pesta futej mësimi i italishtes).

Numri i orëve për çdo lëndë si më poshtë:

1.Gjuha shqipe: Këndim -3 orë, ortografi e diktim- 1 orë, gramatikë e sintaksë 2 orë. 2.Italisht 5 orë 3. Aritmetikë e gjeometri – 4 orë 4. Histori e gjeografi 4 orë, 5.Mësim natyre e sendesh -3 orë; 6. Vizatim e punë dore 2 orë; 7. Bukurshkrim – 1 orë; 8. Këngë 1 orë: 9. Edukatë fizike – 2 gjysma dite.

(vijon në faqen 19)

Në këtë 100-vjetor të shkollës së Burimit populli i zonës së Maqellarës krenohet me këtë vatër dije të shquar dhe kujton me respekt të gjithë mësuesit dhe mësueset që kontribuan në arritjen e rezultateve të larta në punën e tyre mësimore-edukative.

fshatin **Burim** (Allajbegi) në Maqellarë



Shkolla fillore Burim sot, 2016 para Baçes së Shkollës

(vijon nga faqja 18)

FASHIZMI I VURI KAZMËN ARSIMIT EDHE NË DIBËR

Shtrirja e arsimit në Dibër gjatë okupacionit fashist...

Pas 7 prillit 1939 shkollat në fakt u mbyllën. Fashistët hapjes së vitit shkollor 1939-1940 i kushtuan tepër kujdes... gjithë kjo lëvizje bëhej për 40 shkolla që do hapeshin në atë vit shkollor dhe në komunën e Maqellarës bëhej fjalë për shkollat në Maqellarë, Kërçisht, Majtarë, Allajbegi, Kovashicë, Herbel. Shërbyen në këto shkolla : Remzi Sefedini, Tajar Zylfi –Maqellarë, Isuf e Lefteri Çeka, Jonuz Shehu në Kërçisht, Xhafer Qatibi- Majtarë, Mehmet ? (Dardha) e Jorgji Shuteriqi - Allajbegi, Abaz Xhafa – Kovashicë, Mit'hat Cami – Herbel.

Shkollat që u hapën përtej kufirit të 1913-s, e ashtuquajtura «Shqipëri e Madhe», hynë në juridiksionin e prefekturës së Dibrës, qendra jo në Peshkopi, por në Dibër të Madhe në vitin shkollor 1942-1943. Në të gjithë prefekturën e Dibrës u hapën 62 shkolla me 99 mësues dhe 4950 nxënës. Shumë mësues u dërguan në Dibër, Gostivar, Tetovë ej.

Këta mësues u quajtën «misionarë », se hapën shkolla në gjuhën amtare. Misioni i tyre mbaroi në fillim të vitit shkollor 1941-1942.

Gjendja e shkollave në vitin 1940 ishte keqësuar më tej, korrespondenca mes administratës tregon gjendjen e keqe të lokaleve, ku fëmijët e vobegët nuk kishin as kushtet minimale për të mësuar.

«Plotësimi i punës së përditshme të shkollës...- thuhej në një raport,- kryhet me martirizime nga ana e të vegjëlve. Mëngjes për mëngjes, përmes shiut e borës, tue kapërcye përroje e kodra, baltra e shkëmbenj e tue ba nji rrugë të gjatë, nji, dy, dy orë e gjysmë, shihen këto të vegjël që vijnë në shkollë të lodhun, të djersitun a të lagun qull me libra nën sqetull. Mundimi e lodhja nuk do të ndiheshin shumë në qoftë se nxanësi i vogël gjente në shkollë prehjen e nevojshme.

Por, fatkeqësisht, shumë ndërtesa shkollore janë në gjendje të mjerueshme... » (Shkresë e ministrisë së Brendshme drejtuar ministrisë së Arsimit, Dosja 173, viti 1941, Raport rezervat dt. 30.6.1044) f.297 Shumë nxënës , nga kushtet e këqija braktisnin shkollën, disa futeshin në punë në shoqëritë e punës, si hyzmeqarë etj».

Në Maqellarë e rrethina: Allajbegi - Haki Pahumi, Mitat Cami. - Herbel, Remzi Sefedini -Kërçisht...

... Rinia shkollore dibrane, nxënësit e shkollave nën mësimet e mësuesve patriotë u hodhën pa rezerva në Luftën Nacionalçlirimtare.

Në zonën e Maqellarës punonte mësuesi Ibrahim Myftiu, mësues në Kërçisht, që kishte aktivizuar një grup simpatizantësh ku bënin pjesë Shehat Dani, Haziz Asllani etj. Me rininë në zonën e Maqellarës kanë punuar për futjen e ideve të luftës për liri: Eshref Palikuqi, Xhafer Kodra, Hajri Hoxha, Hibe Palikuqi etj.

Kontribut dhanë dhe mësuesit Esat Menzelxhiu, Qemal Agolli si dhe të rinjtë e rinisë shkollore: Gjok Doçi, Riza e Rexhep Doda, Besnik Zaraliu, Rrahman Hanku etj.

ARSIMI PAS ÇLIRIMIT NË ALLAJBEGI LUFTA KUNDËR ANALFABETIZMIT

Si në të gjithë vendin, edhe në fshatin tonë zhvillimi i arsimit mbeti në shifra minimale. E keqja tjetër ishte se nuk zbatohej një ligj detyrimi shkollor dhe pak vetë mbaruan filloren dhe vetëm 3 apo 4 vajza gjithsej të beglerëve që i dërguan pastaj në shkollë në Dibër të Madhe. Kishte fanatizëm të theksuar për shkollimin e vajzave. Ndërsa shumë të tjerë nuk i çonin dhe djemtë, ngaqë i çonin me gjënë e gjallë që të vegjël. Kështu ka ndodhur që në fshat të mbeteshin rreth gjysma analfabetë. Kjo u vërtetua më 1946 kur u regjistruan në kursin kundër analfabetizmit 56 vetë, nga të cilët 32 ishin burra. Megjithatë duhet vlerësuar puna e mirë e mësuesve që punuan në Allajbegi, ndonëse transferoheshin shpesh, ngaqë ishin shumica jabanxhinj.

Lufta kundër analfabetizmit filloi menjëherë pas mbarimit të luftës dhe u ligjërua në korrik 1945. Në kurs u regjistruan pa përjashtim të gjithë personat, burra e gra nën 40 vjeç si dhe më të rinj që nuk kishin vijuar kur duhej (në mosha 14 vjeç e lart).

Shkolla fillore në Burim filloi punën që në fillim të vitit 1945 fillimisht në shtëpinë e Azem Markes, ndërsa u ndërtua një shkollë më 1946 veçan me kontribut vullnetar dhe me material ndërtimi nga shteti me 4 dhoma mësimore. Shkolla u ndërtua në lëndinën nën kodrën e Sanxhakut në Allajbegi mes tri fshatrave.

Në shkollën e Burimit kanë punuar shumë mësues gjatë viteve të mëpasme dhe me shumë prej tyre kam qenë koleg, por për një kohë të gjatë dhe me një kontribut të madh e të meritуar. Puna e mirë e këtyre mësuesve është vlerësuar në vite nga drejtoritë e shkollave të Majtarës e Maqellarës, sepse klasat e pestat që vinin nga shkolla e Burimit kanë qenë gjithnjë më të mirë se të shkollave të tjera...

MËSUESIT NË SHKOLLËN E BURIMIT

Në arsim natyrisht rolin kryesor e kanë mësuesit që punojnë në një shkollë. Nga një analizë e shkurtër më ka rezultuar se në shkollën tonë kanë punuar ndër mësuesit më të mirë që në vitet e para pas Çlirimit.

Mësues të asaj kohe kanë qenë në Allajbegi: Shemsi Zhulali, Ramadan Lika, Hasan Palushi, Drita Zhulali, Tasim Fresku, Qamile Leilica –Mat, Suzana Hoshi - Durrës, e shoqja e Bardhyl Hakanit, Irfane Zeka – Gjirokastër, Bulent Tela - Elbasan, Abdulla e Aleksandra Muça ngaTirana, Skënder Sala, e më vonë Osman (Tup) Leka, etj

Në shkollën e Burimit kanë punuar shumë mësues gjatë viteve të mëpasme dhe me shumë prej tyre kam qenë koleg, por për një kohë të gjatë dhe me një kontribut të madh e të meritуar. Puna e mirë e këtyre mësuesve është vlerësuar në vite nga drejtoritë e shkollave të Majtarës e Maqellarës, sepse klasat e pestat që vinin nga shkolla e Burimit kanë qenë gjithnjë më të mirë se të shkollave të tjera, bile dhe të vetë shkollës fillore të Maqellarës, siç kanë pohuar dhe vetë drejtorët e shkollës së Maqellarës. Në Majtarë klasat paralele A, të formuar me nxënës të shkollës së Burimit, kanë qenë tradicionalisht më të mirat.

Në mënyrë të veçantë duhet të përmendim punën e përkushtimin e mësuesve të shkollës sonë, mësues të devotshëm që kanë lënë emër për përgatitjen e një brezi të tërë intelektualësh. Veçojmë me meritë mësues të "brezit të dytë", si: Shyqyri Zorba, Xhavit Skuka, Naim Skuka, Aqif Xholi, Xhevat Lami, Rasim Xholi, Ferit Kërkuti, Halit Kurtaga, Osman Leka, Idriz Xhemali, Drita Strazimiri, Zabit Shehu, Setkie Strazimiri, Dilaver Bajraktari etj. Duhen veçuar për punën e tyre të shumanëshme këta mësues e mësuese të brezit të parë që punuan edhe në kushtet e vështira të kohës, por ia arritën të përgatisin nxënës të aftë që u bënë kuadro të fushave të ndryshme të jetës.

Do të fokusohesha patjetër më shumë te një "brez i tretë" mësuesish që kanë lënë gjurmë dhe suksese, me një traditë të veçantë dhe shumë pozitive. Një periudhë të gjatë kanë punuar këta mësues e mësuese: Tefta Shehu, Lirie Kërkuti, Jonuz Duka, Ruzhdi Osmani, Hysni Prifti, Dilaver Veliu, Nexhmie Ilnica, Niazi Skuka, Petrit Miftari, Shaban Asllani, Shqipe Muça, Lefterie Sala, Nafie Hysenaj, Hamie Toçi, Dashurie Osmani, Violeta Xhemali etj. Për punën e mësuesve nuk flasin vetëm kolegët e tyre dhe njerëzit në tre fshatrat tona, por në radhë të parë ata jetojnë në kujtimet e bukura dhe vlerësime më të larta të nxënësve të tyre. Edhe pas shumë viteve, kur tani shumë prej ish-nxënësve janë bërë dhe gjyshër e gjyshe, të flasin me krenari dhe nostalgji duke i kujtuar me respekt mësuesit e tyre.

Ky respekt për mësuesit e mësueset është pasuria më e madhe e jona si mësues e mësuese, qoftë për shumë që kanë dalë në pension a që kanë ndërruar jetë sit ë atyre që vijojnë punën në profesionin fisnik të mësuesisë.

Mua më ka rënë rasti t'i njoh mirë edhe si koleg me mësuesit e Burimit, edhe si drejtor e zëvendës dhe nuk mund të mos bëj disa vlerësime për mësuesit në Burim si specialistë shumë të aftë, si metodistë të shquar, si punonjës të përkushtuar për nxënësit që i donin si fëmijët e vet. Mësues të tillë që kishin një disiplinë pune me ndërgjegje të lartë, që nuk njihnin orar, por në çdo kohë ishin duke i mësuar e ndihmuar nxënësit e tyre. Dhe të mos harrojmë: mësuesit kanë qenë të mbingarkuar me ato detyrat shoqërore si propagandistë, si lexues shtypi, përgjegjës emulacioni, nëpër aksione edhe të dielat...

Më vjen mirë të përmend se mësuesit e fshatit tonë, kudo që kanë punuar, kanë bërë figurë të mirë duke qenë më të mirët e më të mirat në kolektivat ku kanë qenë ose janë. Kështu po përmend mësues të tillë model, si: Baudin Strazimiri, Skënder Sala, Demir Osmani, Hajri Xhili, Ferizate Sala (Bajraktari), Naxhie Sala (Çuku), Ramazan Piku, Kujtime Xhili (Vraniçi), Belkize Sala (Elezi), Remzi Sala, Jonuz Duka, Shaban Asllani, Bukurie Asllani (Kaziu), Razie Asllani, Zamira Gjeleshi, Edmir Asllani etj. nga Burimi. Po ashtu në këtë shkollë kanë mësuar nga Vojnika mësues të talentuar, si: Haki Pahumi, Shefki Shehu, Zabit Shehu, Skënder Pahumi, Muzejen Pahumi etj. Një pjesë e madhe e tyre kanë qenë drejtues të zotët dhe kanë bërë emër të mire, si: Haki Pahumi, Shefki Shehu, Baudin Strazimiri, Hajri Xhili, Demir Osmani, Jonuz Duka, Shaban Asllani etj.

Nga viti 1945 deri më 1992 shkolla e Allajbegisë ka qenë në mes të tri fshatrave, te kodra e Sanxhakut. Deri më 1958 aty vijonin mësimet 4 fshatra: Burim. Vojnikë, Çernenë dhe Podgorcë. Në vitin shkollor 1958-1959 u ndërtua shkolla e Podgorcës. Deri në vitin shkollor 1974-1975 shkolla ka vijuar në shkollën e vjetër me 4 dhoma mësimi. Kishte dhe 2 klasë paralele që vijonin pasdite. Në këtë vit shkollor 1975-1976 u ndërtuan dhe 6 klasa mësimi pranë shkollës së vjetër, duke u bërë shkolla me 8 fuqi mësimore me rreth 250 nxënës. Shkolla e Burimit si shkollë fillore ka qenë më e madhja në rrethin e Dibrës. Në këto vite deri në vitin shkollor 1992-1993 ka qenë shkollë vartëse në drejtorinë e shkollës 8-vjeçare Majtarë. Më pas shkolla e Vojnikës vazhdoi ca vite n ëish-kopshtin e Vojnikës dhe më pas te shkolla e Allajbegisë është ndërtuar një shkollë e re për nxënësit e Vojnikës dhe të Çernenës.

Në këtë 100-vjetor të shkollës së Burimit populli i zonës së Maqellarës krenohet me këtë vatër dije të shquar dhe kujton me respekt të gjithë mësuesit dhe mësueset që kontribuan në arritjen e rezultateve të larta në punën e tyre mësimore-edukative.

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë



Ilnicë



Ata më vijnë nga larg, nga thellësia e viteve të mia të bukura kur ngjitesha maleve, zbrisja luginave, hyja mes tyre e i fiksoja në celuloid. Shumë prej tyre ua kam harruar emrat por jo bukurinë e shpirtit të tyre, vendet ku i kam fiksuar në fotografi për ti marrë me vete larg, larg në kohë, larg gjeografikisht, por pranë shpirtërisht.

Më japin jetë, mi shtojnë ditët e jetës... Falemінderit !

ABDURAHIM ASHIKU



Minatorët



Prat, Selishtë



Barinjtë e Korabit



Kala e Dodës



Sebisht



Dhjetë pako kafe...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Atë ditë e mbaj mend mirë. Sapo kishin kaluar plakat e marsit dhe dëbora e freskët e një nate më parë pikte shtëllunga-shtëllunga e binte si varbeca të vrarë nga degët lakuriq të blirëve, mburrja dhe krenaria e qytetit tonë të vogël. Një shtëllungë më ra kokës e stërkalat e ngopura me ujë më hynë në qafë e u shkrinë lugthit të kurrizit duke ma ngjeth mishtë. U drodha e përdrodha derisa pikat u shkrinë e u thanë nga temperatura e trupit në rrjedhën deri te thembrat e këmbëve. Ngjita shpejt shkallët e ulëta të ndërtesës ku kisha zyrën, një ndërtesë me themele betoni hedhur që në kohën e pushtimit italian e me mure e ngrehina ndërtuar me punë vullnetare në vitin dyzet e gjashtë. Dyshemeja e korridorit, me dërrasa kapur me gozhdë pas trarësh prej pishe tash e dyzet vjet të shkuara, rënkoi nga këpucët me dhëmbëza, si kopertonat e makinave, që mbaja në ditë me dëborë e lagështi.

Nxora çelësat të hap derën e bërë shoshë nga bravat e mbërthyera nga paraardhës dhe shkulur nga pasardhës pa më përjashtuar edhe mua. Kur matesha të rrotulloj çelësin, një rënkim i lehtë dërrasash më bëri të kthej vrik kokën. Dikush pas meje dihaste, siç dihasin ata që kanë vrapuar apo që përjetojnë një ankth të madh. Ishte djali im i madh që muajin e ardhshëm mbushte pesëmbëdhjetë vjeç.

- Baba Kiu...- më tha mbushur me lot që i rridhnin faqeve të zbehta.

- Çfarë?- E pyes duke mbledhë në grykë lëmshin që më hodhi me drithërimën e zërit të tij.

- Baba Kiu...- dhe u shkri në vaj- Baba Kiu iku...

- Si iku? Ku iku?

- Kështu më tha mami. Morën në telefon nga Kruja dhe ajo filloi të qajë e thërrasë.

- Eja, - i them unë. – Shkojmë shpejt tek shtëpia.

Nuk e di se sa shpejt e kalova bulevardin dhe i ngjita shkallët deri në apartamentin tim në katin e pestë.

- Iku babai, iku- më thotë ajo e shpërfytyruar nga dhimbja dhe lotët që kishin shpërthyer digën e liqenit njerëzor.

E kapa për supesh dhe e shtrëngova në gjoks si të desha t'ia marr dhimbjen. Ishte me të vërtet një çast ku dhimbja të hynte në palcë. Ajo e kishte baba, kurse unë vjehërr. Për mua ai ishte një shok, një mik, një njeri që më respektonte, një njeri që të hapte portat e shpirtit në dy kanate e të mbante atje si të të kishte gjak nga gjaku i tij.

Vinte çdo vjeshtë në shtëpinë tonë dhe nuk i ikej. Vinte e u gëzohej dy nipërve e mbesës, dy vëllezërve e shumë miqve, aq shumë sa shtëpia jonë paksa e ngushtë zgjerohej si të ishte prej llastiku e kafenetë e pakta të qytetit bashkonin tavolinat.

Vjeshtën e shkuar e fiksova zërin e tij në një magnetofon që mezi e sigurova me autorizim falë punës që bëja, magnetofon që më kushtoi sa dy rroga mujore. Shiritin e ruaj midis gjërave të vyera të jetës, shirit ku kam atë, të shoqen dhe babanë e nënën time.

Atë vjeshtë ai iku i mërzitur si asnjëherë, një mërzi që i kishte hyrë e bërë rrënjë në shpirt. Shokët e luftës, me të cilët takohej ditë për ditë, i kishin folur për gjendjen ekonomike në fshat, për mungesat deri në ekstrem për bulmet, fruta e perime, për dimrin që po vinte pa zahirenë e zakonshme e rezervat aq të njohura të familjeve në fshat, që nuk kishin mbush as gjysmën e magjes dimërore, karakteristike e Dibrës.

Atë vit nuk mori asgjë me vete, siç merrte vit për vit. Unë i pata premtuar se do ti gjeja gështenja, por nuk ia gjeta dot.

Kjo më dhëmbi atëherë, por më tepër po më dhemb sot, ditën kur ai iku për të mos ardhur më kurrë...

E mblodha veten. I thashë gruas të përgatitej për udhë, një udhëtim i gjatë dhe i lodhshëm fizikisht e shpirtërisht.

Bisedën e parë telefonike e bëra me një mik të tij e timin, drejtor i parkut automobilistik. I thashë për dhimbjen dhe e ngushëllova për mikun e tij. Më kuptoi menjëherë dhe fjala e parë që më tha, pasi më përcolli ngushëllimet, ishte:

- Në sheshin e pazarit do të kesh një autobus në dispozicion. Po qe se jeni më shumë do të keni dy, edhe tre...

E falënderova dhe nisa menjëherë lajmërimet. Njoftova vëllanë dhe miqtë e tij me porosinë që të njoftonin kë të mundnit, njoftova prindërit, vëllezërit, motrat e mia duke u treguar adresën ku na priste autobusi...

Një mort në Dibër pa kafe është mort i mortit. E kafja në atë vit të mbrapshtë ishte legjendë. Një pako kafe njëqindgramëshe mbështjellë me letër ambalazhi, ishte racioni i muajit. Në raste morti racioni, me një firmë të zëvendësdrejtoreshës së tregtisë së qytetit, dyfishohej, madje mund të shkonte edhe në pesë apo dhjetë pako.

Shkova dhe trokita në derën e saj. E gjeta midis letrash, me siguri pa bukë e mall brenda, pasqyrë e gjendjes në magazina.

Pas përshëndetjes i tregova për ngjarjen dhe pa e zgjatur i kërkova një kile kafe.

- Nuk ka! - ma preu me të parën.

- Si nuk ka? - e pyes. Ka ikur nga jeta një njeri që i dha këtij trualli ku jetojmë unë e ti rininë e vet, gjak nga plagët e babait të tij që e pushkatuan serbët dhe gjak nga plagët e tij të luftës, një njeri që na ka vënë në këto pozita ty dhe mua.

- Nuk ka! - ma preu përsëri duke vazhduar: - Kafja jepet vetëm për familjet e qytetit...

- Pse unë qenkam familje e fshatit? Pse gruaja ime nuk do t'i shërbejë një kafe babait tënd, shok lufte me babanë e saj?

- Unë... e zbuti paksa fytyrën - po të jap një pako kafe nga ana ime....

- Mbaje për vete. - i thashë duke bërë prapa e duke ia përplasur derën prej kompensate në fytyrë...

Nuk qe nevoja që unë të çoja kilen e kafes. Ai i kishte thënë së bijës se kur të iki unë do t'i njihni miqtë e shokët e mi...

Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Atij iu bë një varrim i denjë për një njeri që i kishte takuar në jetë të merrej me drejtësi, e të jepte drejtësi...

* **

Një vit më vonë nga një fshat i malit të Dardhës me një shervete lidhur përmes zbret një burrë. Nga përkulja dhe shkopi i thantë mbi të cilin rëndonte si të donte të shponte rrugën e gurtë, dukej se i kishte kaluar të shtatëdhjetat e jetës. Priti në sheshin e Zall Dardhës autobusin me turi, modifikim i kohës i një kamioni sovjetik kopjuar e shpërndarë nga kinezët, që sillte si zakonisht punëtorët e hidrocentralit të Komanit në pushimin e muajit atyre fshatrave gjerdanit të "Nëntë maleve" që lindën, rritën e trashëguan "luanët e tuneleve". Bëri vend në një ndenjëse në radhët e para, vend që ia liroi me nderim njëri prej punëtorëve. U ndal në hyrje të qytetit të Peshkopisë në njërin nga këndet e trekëndëshit që mbaronte me një lapidar me një lug çezme, përuruar me ujin e vjetër të qytetit dhe përcjellë nga media si "Uji i Korabit". I ra mes përmes bulevardit duke përshëndetur ndonjë të njohur që bënte rregullin e pashkruar të ec e jakës së mbrëmjes nën kurorën e blirëve të Agushit që për pak takonin degët duke i dhënë rrugës së gjerë pamjen e një tuneli.

Në fund të tunelit të degëve në gjumin dimëror të blirëve mori teposhtës së pazarit për tu ndalur tek agjencie autobusëve ku për fat takoi një mikun e tij, i cili jo vetëm ia zgjidhi kërkesën por i dha edhe një vend të mirë nga ato vendet që jepeshin me autorizim.

Nuk e zgjati rrugën më tej se shtëpia e një miku të tij që, siç thoshte, po ta merrte vesh që kishte zënë hotel, nuk mund ti dilte më përpara.

Të nesërmen do bënte vend në autobusin e linjës që atë vit, me ndërmjetësinë e një dibrani me pushtet, nuk ndalej më as në Laç e as në Milot për të marrë trenin, por shkonte drejtpërdrejt në Tiranë, tash në një rrugë më të shkurtër, nëpërmjet Kamzës. Kjo i volitej sepse atij i duhej të ndalonte në Fushë Krujë për të marrë urbanin për Krujë.

Në sheshin qendror të Krujës, atje ku ndalojnë urbanët desh të marrë të përpjetën ku Skënderbeu i hipur mbi kalë dukej sikur do të hidhej në fluturim drejt detit, tek pallati në qosh të të cilit, lart, kishte bujtur sa e sa herë në shoqëri të mikut të tij. Qendra e qytetit kishte ndryshuar, në ballë ishte kinemaja dhe shtëpia e kulturës kurse në të djathtë një godinë e re mbi portën e së cilës shkruhej "Komiteti Ekzekutiv i Rrethi Krujë". I bëri përshtypje pamja ndaj, para se të ngjitej ndali hapin dhe pyeti një kalimtar. Shqiptoi emrin e mikut dhe pyeti se ku e kishin shtëpinë djemtë e tij. Kalimtari, i cili me sa dukej e njihte mirë njeriun dhe vendin, i tregoi një portë fare pranë duke i thënë të kalojë qemerin dhe pasi të ngjitej në një palë të vetme shkallësh të trokiste në portën majtas ku shënohej emri i njeriut që donte.

I ngjiti shkallët me parafabrikate me mozaik dhe, pasi mori thellë frymë e u mundua ta drejtojë trupin, shtypi lehtë butonin e ziles. Një cicërimë zogu pasoi përkuljen e dorezës së derës për ti nxjerr para syve një grua me shami të zezë mbi flokë e një shprehje që tregonte bujari në tërë qenien e fytyrës.

- Urdhëroni, i tha gruaja duke e hapë derën aq sa u dëgjuan takimi me murin e korridorit.

- E shoqja e...

- Po, i tha, urdhëro, të mbaj mend mirë kur vije në Peshkopi, por edhe kur vije tek shtëpia e vjetër. Mirë se të pru Zoti!

Burri pa u përkulur, me një të mëshuar thembrave, hoqi këpucët dhe i shtyu paksa në një kënd të sallonit. Një palë çorape leshi thurur e qëndisur me kujdesin e nuses së djalit, të pastra, përcollën mbi dysheme trupin e tij në dhomën e pritjes ku do të pushonte në një kolltuk nga ata të modelit të vjetër, kolltuk që ishte ulur e ngritur sa herë kishte trokit e bujte në atë shtëpi.

- Më fal se do të lë nja dy minuta vetëm, sa të bëj kafen. Djali dhe nusja janë në punë, kurse nipërit janë në shkollë.

- S'ka gjë. Ulu se e kam një fjalë, pastaj e pimë edhe kafen.

Tha këtë dhe pasi zgjidhi nyjën e shervetes lidhur për brezi dhe e shtroi mbi tavolinën e vogël përpara kolltukut, hapi me kujdes një qeskë e prej saj nxori një nga një dhjetë pako të mbështjella me letër të zakonshme ambalazhi, ngjyra e së cilës kishte kohë që kishte mbetur pa emër.

- Nuk munda me ardhur në varrim - tha me kokën ulur. Më erdhi fjala vonë dhe nuk munda të vij me shokët. Vonë është por...

- Miku jot thoshte që mik më i mirë është ai që e ruan dhembjen. Dhe tregonte një mesele dibrane. Ju jeni dhe do të jeni mik i nderuar i kësaj familje. Ne gati e harruam kurse ti për një vit e ke mbajt në zemër e në shpirt...

- Desha të vij edhe ma para por hapin ma ndalën këto pako të shkreta. Mu desh një vit ti mbledh, një e nga një, nga një pako në muaj, për të bërë kilen. Nuk mund të vija pa një kile kafe për mikun tim e të familjes time, njeriu që më shpëtoi jetën dhe nderin e familjes. Kafja ka kuptim të madh në Dibër...

- Një vit ke mbledhë muaj pas muaji racionin e kafes? Nuk e ke vu xhezven në zjarr, vetëm për...

- Po, po, një vit. E tash merre një pako kafe dhe na e piq ta pimë bashkë në kujtim të bashkëshortit tënd, e të mikut tim...

* * *

Atë natë, në atë shtëpi të zakonshme dibrani larg Dibrës, u mblodhën të gjithë; djem e nuse, nipër e mbesa...

Ata i thanë se sonte na e ngjalle babën...

Ai u tregoi se si lindi miqësia me Të, si Ai i shpëtoi jetën...

Portret me fjalë

Nga **AGIM BAÇI**

"Ç'mund ta bënte vallë Bujar Kapexhiun që të ulej e të shkruante një libër prej 400 faqesh për një personazh?" - Këtë pyetje i bëra vetes teksa mora në dorë librin "Burri i Odës Dibrane". Po, teksa nis ta shfletosh, menjëherë ndeshesh me një emër që ka mundur të mbledhë brenda vetes një pjesë të rëndësishme të fytyrës së Dibrës, duke kandiduar qetësisht përmes veprës së tij për një portret Eshtë Hazis Ndreu! Nuk mund t'i vësh vetëm një emër. Askush nuk mund të pretendojë se mund të thotë gjithçka për të. Por Kapexhiu, si një skenarist, apo siç parathotë dhe vetë "i ngatërruar në lëmshin artistik", ka vendosur të ndërtojë një portret me fjalë. E ndoshta, aty këtu, ku fjala "ngec", të përdorë dorën e artë të ilustrimit.

Por duket se një hambar etnografik, si Hazis Ndreu, i ka dhënë lehtësi Kapexhiut, teksa ka përdorur një stil si në karusel, duke e ndërtuar shkallë-shkallë portretin e njeriut që fliste me valle, me vargje, me humor e me folklorin e mbledhur si bletët. Pasi ka përshkruar historinë e librit, të nisur nga një spektakël përvjetori për emblemën dibrane, Kapexhiu sjell qëndrimet e kolegëve, studiuesve dhe bashkëqytetarëve të tij, botuar në vite në revista e gazeta. Ky prezantim është edhe hyrja që i jep pasaportën për të kuptuar se, një ditë patjetër duhej shkruar për atë burrë, që dibranët e kanë krenari, por që i takon thuajse të gjithë shqiptarëve.

Pastaj, me rradhë, nga gjërat më të vogla familjare, deri te qëndrimet e vëzhguesve shkencor, vjen e merr formë portreti i njeriut që duket si një lumë i pashtershëm artistik, ku janë larë thuajse të gjithë ata dibranë që u bënë "qytetarë të artit". Eshtë një portret që Kapexhiu e ka marrë përmes fjalësh dhe kujtimesh të emrave si Skënder Sallaku, Dritëro Agolli, Luftar Paja, Agron Xhangolli, Afërdita Onuzi, Ramazan Bogdani, Agron Tufa, Veli Rada e shumë të tjerë. E duket sikur Hazis Ndreu ka mundur "t'i pushtojë" nga pak të gjithë. Njëri ka patur më shumë kontakte e biseda. Tjetri ka patur më shumë njohje për veprën. Të tjerë dëshirojnë

> Pas shumë faqesh të kësaj biografie kupton se pas fjalëve të Kapexhiut, është portreti i një njeriu që thuajse qëndron në heshtje, në oxhakun e shtëpisë së tij të mendimit. Ndonjëherë, shumë më i rëndësishëm se sa e përshkruajmë, sepse ndoshta këta njerëz nuk kanë tentuar të vetëshkruhen, por vetëm të japin. I përkasin më shumë një zëri që, edhe pse na buçet, nuk ja mësojmë kurrë fuqinë e burimit, sepse duket se vjen nga të gjitha anët.

të ndërtojnë një figurë që bart humorin e hollë, apo siç thonë: "kunjat dibrane".

E megjithatë, asgjë nuk duket e plotë pa tjetrën. Janë si tullat e një ndërtese, që duhet të mbajnë njëra-tjetrën. Ndaj dhe zgjidhja e Kapexhiut duket se i ka dhënë të drejtë, teksa ja ka besuar të gjithëve nga pak, për të dhënë më pas atë më të rëndësishmen- Muzeun Hazis Ndreu! Një muze njerëzor, ku guri i vetëm janë veprat!

Pas shumë faqesh të kësaj biografie kupton se pas fjalëve të Kapexhiut, është portreti i një njeriu që thuajse qëndron në heshtje, në oxhakun e shtëpisë së tij të mendimit. Ndonjëherë, shumë më i rëndësishëm se sa e përshkruajmë, sepse ndoshta këta njerëz nuk kanë tentuar të vetëshkruhen, por vetëm të japin. I përkasin më shumë një zëri që, edhe pse na buçet, nuk ja mësojmë kurrë fuqinë e burimit, sepse duket se vjen nga të gjitha anët.

"Ndër njerëzit më të rëndësishëm të fëmijërisë dhe adolleshencës sime, ndikimin e të cilit e pata rregullisht, kohë pas kohe, bashkë me rritjen time, një ndikim të shumanshëm që jeton brenda meje e që pasqyrohet vetëdijshëm apo pavetëdijshëm në ide apo kapriço krijuese", shprehet shkrimtari Agron Tufa, teksa rrëfen takimin e vetëm të tij me Ndreun në qershor 1998, vetëm pak pas kthimit të studimeve në



Moskë. Një përshkrim që i bashkëngjitet atyre që kanë thënë shumë, e që mendojnë ende se kanë shumë për të thënë.

Ndoshta deri më sot e kanë njohur bashkëqytetarët dhe specialistët e fushave ku ai ka notuar pa u ndalur. Por Kapexhiu tashmë e ka lëshuar emrin e Hazis Ndreut në detin e një debati tjetër, për të mos lënë thjesht në një përkujtim ata njerëz që e kthejnë emrin e tyre në një rrugëtim shpirtëror.

BOTIME TE REJA



XHAFER MARTINI
Kanuni i Dibrës - *Trashëgimi etnojuridike*
ISBN 978-9928-172-77-8
480 faqe/ Çmimi: 1500 leke

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit" dhe me "Kanunin e Skënderbeut" (me variantet dhe invariantet e tij), – "Kanuni i Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t'i gjeni në "Hyrjen" e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t'i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta" si "Gjakmarrja", "Hakmarrja", "Gjaku", "Xhipi"etj.

Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik. "Kanuni i Maleve të Dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "Atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit. Jehona dhe energjia pozitive e kësaj "vatre civilizimi" dërgon impulset veta sipas ligjësish të ndërdukshme në momente krizash e gjëmash sociale. Vigjilenca intuitive dhe ndjeshmëria e komunikimit me këtë kod të lashtë etiko–social, lyp, para së gjithash, të jesh një recipient jo banal, përkundrazi: ta përceptosh veten në epiqendër të interferencës së këtyre valëve me urtësi mijëvjeçare dhe të dish ta transfigurosh këtë trashëgimi të vyer sipas një evolucioni "krijues" ndërpersonal.

Agron Tufa



MUNIR SHEHU
Dibra në shekujt e sundimit osman
ISBN 978-9928-172-95-2
124 faqe/ Çmimi: 700 leke

Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti nga populli. Ato e kanë një burim, për këtë as që mund të dyshohet. Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri.

Burimi është populli, vetë historia e tij. Pra, mund të konsiderohen si dokumente historike për ngjarjet që përshkruhen në to.

Çështja e folklorit me burim shumë të vjetër është si puna e muzikës. Nuk mund ta lexosh melodinë pa parë më parë çelsin e muzikës në krye të pentagramit.

Ashtu si për muzikën, që, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në muzikë, po ashtu edhe për folklorin, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në folklor, d.m.th., në popull.

Munir Shehu

LIBRAT E BOTUAR NGA BOTIMET M&B MUND T'I GJENI NË LIBRARINË E SHTËPISË BOTUESE TE SELVIA (PËRBALLË HOTEL VILA VERDE), RRJETIT TË LIBRARIVE ADRION OSE MUND TA POROSISNI PRANË ÇDO LIBRARIE NË LAGJEN TUAJ. NË TIRANË JUA SJELLIM EDHE NË SHTËPI. TEL / VIBER. 069 20 68 603 / TEL/WHATSAPP : 068 65 08 441

"Katër kongreset kombëtare për alfabetin e shqipes"

Nga **BEQIR SHEHU**, *studiues*



Meritë e veçantë e Arjan Kadiut është pasqyrimi i kontributit të familjeve të mëdha shqiptare, të djemve të tyre patriotë, të ditur e të pasur, të klerit fetar e intelektualëve që drejtonin shoqëri patriotike e shtypin e kohës, të cilët krijuan lidhje e marrëdhënie edhe me faktorë relevent të botës dhe organizuan, udhëhoqën e morën vendime të guximshme, edhe në këto ngjarje të mëdha, duke mos kursyer as pasurinë e as jetën e tyre...

Është një kontribut me vlera të veçanta në fushen e historishkruarjes, libri i Prof.dr. Arjan Kadiut, "Katër Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes" pasi vjen në një kohë kur historishkruarja shqiptare, krahas arritjeve të pamohueshme, po përjeton edhe probleme të cilat po cënojnë objektivitetin e besueshmërinë në vërtetësinë shkencore të saj.

Orientimi permanent i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i përcaktuar nga rilindasit tanë ka qenë dhe mbetet zgjidhja përfundimtare e çeshtjes kombëtare mbarë shqiptare. Kjo ka qenë, është dhe mbetet edhe pika e referimit mbi të cilën gjykohet serioziteti dhe vlera e punimeve shkencore historike në vlersimin apo rivlersimin e ngjarjeve historike, e personaliteteve drejtues e pjesmarrës në këto ngjarje si dhe produktin kombëtar e shoqëror që ato kanë sjellur.

Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes që u mbajtën njëri pas tjetrit në një hark të ngushtë kohor në pragun e shpalljes së Pavarsisë kombëtare, ishin ngjarje të rëndësishme për historinë e popullit tonë. Vendimet historike të tyre kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në shekuj në rrethet arsimore e kulturore të kombit shqiptar. Për rëndësinë dhe vlerat atdhetare, shkencore e kulturore të Kongreseve Kombëtare për alfabetin e gjuhës shqipe janë kryer punime të mirefillta shkencore deri nga Akademia e Shkencave të Republikës ku kanë hulumtuar edhe personalitete me emër si Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, Gazmend Shpuza, Qazim Xhelili, Naum Prifti, Gjovalin Shkurtaj, Qenan Manastiri, Sejfi Vllamasi, si dhe mjaft personalitete të botës akademike e klubeve kulturore, në një shtrirje kohore shekullore, por këkimi historik ësht i hapur dhe nuk mund të themi se ky proçes ka përfunduar.

Historishkruarja për rëndësinë, vlerat dhe produktin kombëtar e shoqëror të sejcilit nga këto kongrese në fuksion të orientimit permanent, zgjidhjes përfundimtare të çeshtjes kombëtare mbarëshqiptare, ka patur edhe dukuri që i kanë shpëtuar normalitetit duke mos pasqyruar me vërtetësi historike zhvillimin e ngjarjeve, madje në vitet e diktaturës, përveç ideologjizmit e politizimit të tejskajshëm ka patur edhe seleksionim të materialit lëndor historik që ka sjellur njëanshmëri, tjetërsim, mohim, mbulim e shtrëmbim faktesh, denigrime figurash e lartësime të pabazuara, dukuri këto të pseudohistorisë që kan sjellur edhe mbrapështi në zgjidhjen e çeshtjes kombëtare.

Dr.Prof. Arjan Kadiu, "për të shkundur e pastruar këtë pluhur të mbishtresizuar që historia jonë kombëtae e mbartë me dhimbje prej shumë vitesh"(siç shprehet autori i librit) dhe për të sjellur në normalitet vërtetësinë historike në zhvillimin e këtyre ngjarjeve tepër të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar, duke u bazuar në rregullat e parimet shkencore të historishkruarjes na dhuronë sot në prag të festave të nëntorit, librin "Katër Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes". Ky libër me trajtime e synime historike e gjuhësore të një akademiku ma aftësi të admirueshme argumenton e mbështet por edhe rishikon, plotëson e saktëson duke shvleresuar e hedhur poshtë qëndrime e vlersime të njëanëshme të shprehura në botime të ndryshme kushtuar kongreseve të alfabetit të gjuhës shqipe.

Cilat janë disa aspekte të refleksioneve dhe thellimit të Arianit për sjelljen në normalitet të vërtetave historike mbi zhvillimin e këtyre ngjarjeve të rëndësishme dhe produktin historik që ato sollën në hullinë e Orientimit Strategjik të lëvizjes kombëtare mbarëshqiptare?

Me librin "Katër Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes" Dr. Prof. Arian Kadiut vjenë me një qasje të re në fushën e historishkruarjes. Nëpërmjet sintezës së rrugës kongresore, me trajtime e synime historike të pandara nga ato gjuhësore atdhetare e kombëtare, argumenton, qartëson e saktëson se katër Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes që u mbajtën në harkun kohorë të dy vjetëve, nga nëntori i vitit 1908 deri në prill të vitit 1910, ishin kuvende, mbarëkombëtare shqiptare, dhe jo krahinore e fetare siç janë konsideruar nga pseudopatriot e perfaqësues të interesave grabiqare të monarkive fqinje të ballkanit.

Nisur nga fakti se historishkruarja si shkenca e pasqyrimit të vertetave historike nuk pranon shtrëbrime e zbukurime e aq më tepër plotësime të hamendësuara e të paqena. Për të siguruar besim dhe bindje në vertetësinë historike të zhvillimit të ngjarjeve të paraqitura në këtë studim, Ariani është bazuar në radhë të parë në dekumentet autentike arkivore, duke marrë në përparsi, dëshmitë e pjesmarrësve në këto ngjarje. Këto dëshmi të interpretuara me përgjegjësi shkencore e çojnë lexuesin në mjediset kohore të zhvillimit të këtyre ngjarjeve duke krijuar besim në të vërtetat historike kohore të zhvillimit në këto ngjarje, por edhe duke davaritur pasaktësitë e keqinformimet e akumuluara.

Meritë e Arianit është edhe fakti se edhe nga dëshmitë e pjesmarrësve në këto ngjarje ka hulumtuar me përparsi dëshmit e atyre personave që kanë patur pozita të rëndësishme në proçesin e organizimit dhe drejtimit në këto ngjarje, por jo vetëm kaq, duke gjykuar edhe nga niveli dhe aftësitë e tyre intelektuale e kulturore. Një nga dëshmitë që autori i këti libri i referohet me shumë besim dhe që i ka dhënë besim të pa dyshimtë edhe pasqyrimit të ngjarjeve në këtë libër është relacioni i hartuar me të dhënat e mbledhjes me dyer të mbyllura të komisionit të alfabetit nga Gjergj Qirjazi,antar i këtij komisjoni dhe nënkryetar i kongresit të Manastit, pjesmarrës dhe figurë kryesore edhe në kongresin e Dibrës. Ky relacion prej 20 faqesh të datës 20 janar 1909, në gjuhën angleze,që autori i librit "Katër Kongreset Kombëtare të alfabetit të shqipes", thote se është i vetmi burim i drejtpërdrejt, sot për sot, i komisionit të alfabetit shkruan:"Po të mos përfillnim njërën apo tjetrën anë, do të shkaktohej pengesë e madhe për përparimin e Kombit dhe meqë këto (alfabete) qënë përdorur në shkolla, njëri në Gegëri dhe tjetri në Toskëri, ne vendosëm me vota të plota të adaptojme dy alfabetet." Dhe përse e bënë këtë; sepse detyra kryesore ishte ruajtja e unitetit kombëtar pa të cilin edhe po të vendosej në Kongresin e Manastirit, ai nuk do të zbatohej kurrë në jetë;.ndërsa ruajtja e këtij uniteti solli atë që pa kaluar as një vit, u krijuan kushtet që në Kongresin mbarkombëtar të Dibrës u vendos njësimi i alfabetit shqip më shkronjat latine.

Në kapitullin mendime të kundërta për dy alfabetet, autori i këti libri na bën të ditur edhe paknaqësinë e disa patriotve; si të alfabetit latin edhe të alfabetit të Stambollit por thjeshtë shprehnin paknaqësi. Kurse historjani dhe studjuesi H.Myziri paknaqësinë për njësimin e alfabetit e shpreh : "Komisioni nuk pati vullnet të hekurt që ta mbaroi e t'i jap fund njësimit të alfabetit."

A nuk ishin këta rilindas të shquar, Atë Gjergj Fishta, kryetar i komisionit të alfabetit dhe Mithat Frashri, kryetar i Kongresit dhe nënkryetar i komisionit të alfabetit, Gjergj Qirjazi,Vehbi Dibra,etj; që për mënjanimin e përçarjes në radhët kongresistëve dhe të vetë Lëvizjes Kombëtare patën aftësinë, për të marrur vendime të tilla historike.Vetëm popujt me zhvillim kulturorë e vetëdije të lartë kombëtare nxjerrin udhëheqës të aftë për vendime historike. Por në mjra faqe për studimin e kongreseve gjuhësor për alfabetin emri i këtyre burrave është fshirë e zëvendësuar me të tjerë. Këtë të vërtetë historike na e sjell Arjani, si tepër të denjë për tu rregjistruar në memorjen historike të kombit.

Merit e veçantë e Arjanit është pasqyrimi i kontributit të familjeve të mëdha shqiptare, të djemve të tyre patriot, të ditur e të pasur, të klerit fetar e intelektualve që drejtonin shoqëri patriotike e shtypin e kohës, të cilët krijuan lidhje e marrdhënje edhe me faktor relevent të botës dhe organizuan, udhëhoqën e morën vendime të guximshme, edhe në këto ngjarje të mëdha, duke mos kursyer as pasurinë e as jetën e tyre. Ndërsa, historishkruarja e kësaj periudhe jo vetëm që i kishte fshirë nga faqet e saj por edhe i kishte denigruar për arsye klasore por edhe se kanë bashkëpunuar me pushtuesin.

Bashkëpunimi me pushtuesit dhe përbërja klasore ka qenë "arsyeja " jo vetëm e fshirjes nga faqet e historishkruarjes dhe denigrimit të organizatorve dhe drejtuesve klerik e pashallarë, por edhe fshehja e tjetërsimi i produktit që kanë sjellur këto ngjarje, e në veçanti produkti i kongresit mbarë kombetar të Dibrës vendimet e të cilt sollën përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e gjuhës shqipe dhe mësimin e gjuhës shqipe në shkolla.

Po kush ishin Xhonturqit, pushtuesit, me të cilët thuhet se bashkëpunuan drejtuesit e kongresit të Dibrës ,për shkak të cileve u mohua dhe u tjetërsua produkti historik kombëtar që ky kongres solli?

Turqit e ri(xhonturqit) ishin intelektual përparimtarë turq.,shkruhet në historinë e shqipërisë. Të ndihmuar nga 20 mijë shqiptar të armatosur, të Dibrës, Pollogut e Kosovës me 23 korrik 1908 ata detyruan Sulltan Abdyl Hamitin e II. të shpalli Kushtetutën duke rrëzuar regjimin absolut të Sulltanit. Turqit e Ri premtuan se do të njihnin të drejtat kombëtare të popujve të perandorisë. Për kohën ky qe një lajm i mirë edhe për .patriotët dhe atdhetarët shqiptarë të cilët u hodhën në veprim për realizimin vetë të këtyre të drejtave, mes të cilave ishte edhe mësimi e përhapja e gjuhës shqipe. Në këtë hulli veprimesh u zhvilluan edhe Kongreset Kombëtare për alfabetin e shqipes, mes të cilëve edhe Kongresi i Dibrës, vendimet e të cilit shkonin plotësisht në hullinë e orientimit të Lëvizjes Kombëtare mbarë shqiptare duke mos patur asgjë të përbashkët me qëllimet e pushtuesve xhonturq , numri i të cileve nuk përbënte as 5% të pjesmarrësve në kongres u përdor per zhvillimin legal të tij.

Motivi i bashkëpunimit me pushtuesit ka bërë që të fshihen nga faqët e historisë sonë kombetare edhe produkti i ngjarjeve të rëndësishme, siç ishte bashkimi në vitin 1941 deri më1945 i tokave shqiptare të lëna padrejtësishtë, jashë kufirit shtetëror më 1913, i cili ishte jo vetëm realizim i orientimit strategjik të Lëvizjes Kombëtare, por edhe një ristart në ndëgjegjen kulturore kombëtare të popullit tonë, ku u hapën shkollat shqipe e u vendos administrata shtetërore shqiptare. Shtrohet pyetja; a duhet që historia jonë të studjoi e pasqyroi produktin e bashkëpunimit me komunistët Jugosllav gjatë luftës nacional çlirimtare, që solli rikthimi i pushtuesve serb dhe vrasjen e shpërguljen me forcë të mijra shqiptarve me preteksin se kishin bashkëpunuar me fashizmin.

Trajtimi në një libër si punim shkencor i Katër Kongreseve për alfabetin e gjuhës shqipe duke ju referuar mbi 100 titujve studimor që kanë shkruar për këto kongrese dhe dhjetra dokumenteve të gjetura dhe kohët e fundit, mund të themi se Prof. Ariani jo vetëm që ka " sjellur në normalitet" historishkruarjen për këto ngjarje të rëndësishme në historinë e popullit tonë por edhe na ka dhënë një ndihmë të vyer metodike shkencore për hulumtime të mëtejshme në fushën e historishkruarjes, pasi ajo mbetet gjithmonë e hapur.

Ky himn i dibranëve që mban gjallë historinë e lavdinë dibrane, idealin e gjithë atyre që krah më krah e një për një lidhën besën për liri e vatan, do të qëndrojë si i tillë sa të frymojë shqip edhe vetë kombi.

botim i ri

Kënga e Hajredin Pashës, “pasaporta” e çdo dibrani”

Nga **ARSIM KOLARI**

Thesari popullor i Dibrës është tepër i pasur dhe i mjaftueshëm për të zënë vend meritor në mesin e thesarit kombëtar. Në këtë thesar hyjnë vargje lirike, këngë historike, e shumë këngë me motive të tjera. Populli dibran njerëzit historik i ka gdhendur si të thuash në kujtesën e tij, një pjesë për të cilët ka thurrur dhe këngë. Këngët historike dibrane kujtojnë “motin e shkuar” apo betejat kundër pushtuesve të huaj, ku populli është larë me gjak për liri dhe për trimat kanë thurrur këngë. Madje, për disa ngjarje kulmore e me rëndësi të madhe historike, këngëtari popullor ka ngritur dy këngë, mbase edhe më shumë: “Hajredin Pasha po vjen Radikës”, “Elez Isufi arusha e malit”, pastaj edhe “Luftën Dibra seç e nisi”, “Ç’po i bjen era retë e zeza”, e të tjera varg...

Si kurorë e gjithë historisë së lavdishme dibrane, dashtë e pa dashtë qëndron kënga e Hajredin Pashës. Kjo ndodh për vetë motivin, melodinë që është e kapshme dhe për një fëmijë të vogël, e kjo falë mjeshtërisë së “gdhendur” nga artisti shekullor Hazis Ndreu. Ishte viti 1957 kur i ndjeri tashmë Hazis Ndreu, e redaktoi tekstin, punoi muzikën me një orkesër prej 6 çiftelish, të kësaj kënge që e rregjistroi në Radio Tiranën. Pra, i pari dhe ai që i dha origjinalitetin kësaj kënge himn, është i vetmi, mjeshtri i madh Hazis Ndreu, nën përcjelljen e çiftelisë që i përgjigjet çdo shkronje të tekstit të kësaj kënge, e mbi të gjitha që të mbush me emocion të padeshifruar brendësisht.

Fillin e luftës së rrëfyer në këngë e gjejmë menjëherë pas përfundimit të kryengritjes në Kosovë e në Pollog. Ushtria osmane, në vjeshtën e vitit 1844, u përqëndrua në sanxhakun e Dibrës, sepse populli dibran ishte hedhur në kryengritje kundër zbatimit të reformës ushtarake dhe vetëqeverisjes lokale të krahinës. Meqë forcat e komanduara nga Rexhep pashë Tetova u thyen nga kryengritësit në fushën e Mavrovës, Stambolli hodhi në këtë krahinë ushtri të shumta, të komanduara nga Hajredin Pasha me 12 mijë ushtarë. Në nëntor 1844, përfaqësuesit e nëntë maleve të Dibrës: Çidhën, Reç, Dardhë, Lurë, Muhurr e Selishtë, Luzni, Grykë e Vogël, Grykë e Madhe dhe Bulqizë, me në krye Sheh Mustafa Zerqanin, u thirrën në kuvend në një kullë të fushës së Gjoricës. Në kuvend u vendos që me kryengritje të mbroheshin të drejtat lokale, që popullsia i gëzonte prej kohësh. Rrugëtimin e ushtrisë së Hajredin Pashës përreth lumit Radikë që derdhet në Drinin e Zi, na e përshkruan këngëtari popullor:

Hajredin Pasha po vjen Radikës,
pëjt: Ku jen malet e Dibrës?

Nga dy vargjet e para vërehet qartë se komandanti turk nuk ka hasur në pengesa nëpër Rekë, meqenëse kryengritësit dibranë e matjanë, të komanduar nga Cen Leka, u zunë rrugën ushtrive osmane pikërisht në grykë të Radikës. Komandanti turk, pasi e hetoni qëndresën e kryengritësve, shpalli se të gjithë ata që do të dorëzonin armët, do të liheshin të lirë dhe se nuk do të rekrutonte nizamë.:

-Moj Gjuric’, moj kasaba,
çon pasha e t’bon rixha:

Historia e kultura dibrane është aktualizuar kurdoherë me “sokolat” e saj të ardhur nga nderi, mençuria e heroizmi.
Ky himn i dibranëve që mban gjallë historinë e lavdinë dibrane, idealin e gjithë atyre që krah më krah e një për një lidhën besën për liri e vatan, do të qëndrojë si i tillë sa të frymojë shqip edhe vetë kombi...

për rixhaja s’i osht ndëgjo
i thkej topat me lufo.

Ky premtim nuk zuri vend te shumica e krerëve, të cilët e vazhduan qëndresën, e bënë luftime të ashpra plot pesë ditë e pesë netë në fushën e fashatit Gjoricë, ku krahas burrave luftuan edhe gratë e fëmijët. Pastaj këngëtari popullor vazhdon:

Hajredin Pashë o mër hutaç-e,
S’rëjfet Dibra me kërbaç-e!

Pra, dibranët e bënë me dije pashain turk se nuk është e kollajshme lufta me dibranët, ashtu siç ishte me të tjerët, kur dijmë se para se të hynte në Dibër, ai hapi rrugë dhe e mori Selanikun, e deri në Prilep, që na e dëshmon edhe kënga:

Hajredin Pasha, tha, mër krejshënëjk,
nuk osht Dibra Selanëjk.
Selanëjk e as Përlep-e
çish gërkove, në Dibër xhete.

Luftimet përfunduan me humbje të mëdha për të dyja palët, sidomos për ushtrinë osmane, e cila u detyrua ta përjashtojë krahinën e Dibrës nga reforma ushtarake. Kjo luftë e vendosur e popullit dibran pati jehonë në viset e tjera shqiptare. Pas 6 muajsh, në maj të vitit 1845 rreth 2 mijë malësorë të krahinës së Gjakovës me kryengritje e detyruan qeveritarin e saj të largohej, me çrast filluan kryengritjet dhe u çliruan edhe Reka, Bytyqi, Gashi, Tropoja, etj. Sulltani, për ta qetësuar gjendjen i liroi mbi 2 mijë shqiptarë të burgosur në Stamboll dhe e ndaloi për disa vjet zbatimin e sistemit të ri në Shqipërinë Veriore.

Nga e gjithë kjo nënkuptohet ajo më e rëndësishmja, se krerët e të dy anëve të Dibrës, agallarë, pasanikë e gjithë shtresat e tjera, kur bëhej fjalë për kombin e fatet e tij, zinin pozicionin kundër pushtuesve dhe luftonin krah më krah. Çdo dibran identifikohet me bëmat e qëndresën e paraardhësve të vet, me këngën origjinale nga vetë artisti – hero Hazis Ndreu, por jo nga ata që e huazuan dhe e shfrytëzuan këtë këngë për të bërë emër. Historia e kultura dibrane është aktualizuar kurdoherë me “sokolat” e saj të ardhur nga nderi, mençuria e heroizmi. Ky himn i dibranëve që mban gjallë historinë e lavdinë dibrane, idealin e gjithë atyre që krah më krah e një për një lidhën besën për liri e vatan, do të qëndrojë si i tillë sa të frymojë shqip edhe vetë kombi.

Poezia si derdhje **e lirë** imazhesh

Nga **Qazim SHEHU**



Poezia e Erviolës vjen përmes dlirësisë së shpirtit të saj vajzëror në një derdhje imazhesh transcedentale, të cilat përvijojnë pamjet e ditës, shqetësimet dhe kujtesën vizuale, ashtu si dhe kujtesën emocionale për gjërat që e rrethojnë dhe kalojnë me reflekset e tyre nëpër shpirtin e saj të butë dhe të ndjeshëm.

Kështu, kjo poezi bëhet e prekshme aq edhe frymore, e rrjedhshme me varg tëçliruar që përcjell impresione e digresione, shpreh shqetësimet e femrës në botën e trazuar maskiliste dhe e rrethon hapësirën me dashurinë e nënës për fëmijtë. Po kështu në këtë lloj poezie, tematika degëzohet dhe merr krahë në kujtime për gjyshen, babain, vendet e lindjes, dhe gjithçka ajo e thotë me mall e dhimbje, me një dëlirësi të prekshme që të frymëzon dhe të shpie larg. Kjo është një poezi që nuk sajohet, po ngrihet në tonalitete të përditshmërisë dhe përmes tyre zbret në thellësi të ndjenjave, duke qenë kështu në shtratin e vetvetes krejtësisht e pangjashme dhe e përcjellë nëpër shqetësime dhe e trasuar në ide që shpalosin këto shqetësime. Kështu, mesazhi bëhet i kapshëm dhe troket në vetëdijen e çdo lexuesi që e do jetënpoezinë, që ndjenjën nuk e topit nëskajshmërinë e indiferencës.

Poezia e saj nxit dhe të merr me vete përfytyrimeve të saj. Në raportin midis motivit dhe transhendencës, Erviola herë zgjedh në përparësi motivin e herë kushton më tepër vëmendje frymës, gjendjeve shpirtërore që dalin dhe krijojnë atmosferën e përjetimeve të brendshme dhe të hapura. Kështu, motivet përdtitësohen dhe gjendja (frymëzimi, brenga, malli, dhimbja, dashuria, lumturia, harresa dhe kujtesa) u vesh atyre rroben e duhur të hijeshisë dhe bukurisë së paraqitjeve. Është një poezi që të rrëmben pikërisht për këto çaste të përditësisë njerëzore shikuar me syri n e një femre të kulturuar dhe të shqetësuar, ku filtri intelektual dhe ndiesor shkrihen e njenjtësohen bashkë, përmes këndvështrimeve të ndryshme poetikë.

Kjo poezi e mbart ngarkesën e figurës në mënyrë të natyrshme dhe synon të shprehurit intelegjent, e, këtu ftillohet e jetësohet toni i filozofimit dhe meditacionit, sepse poetja është një grua që kërkon në jetë;vetënisja e udhës poetike është kërkimi mëi pastër për ta rritur shtatin dhe profilin e personalitetit të vet si aspekt integrues në shoqëri dhe në rrafshe më të gjëra kulturore. Ky tentim shpreh gjithashtu arritjen një suksesi që në librin e parë, sepse ne shohim një dorë të stërvitur në shkrimin e poezisë, organizimin e strukturës së vjershës, kujdesin për fjalën dhe kumbimin e saj, sensin e masës dhe të shprehurit elokuent, jashtë sloganeve të mërzitshme. Poezia e saj bëhet një kredo e fortë morale në udhë të ngjitjes, po edhe një kredo ndiesore që poezia ndikon sadopak për të zbutur shpirtrat e vrazhdë të kësaj bote të murrme.

Duke iu rikthyer fillimit, mund të përsërisim pa drojë se poezia e saj e shpreh pikërisht këtë dhe kjo derdhje e lirë e imazheve dhe ngulitje e figurave vjen si veçori e stilit të saj dhe e shqetësimit poetik për botën, jetën, të ardhmen. Kjo derdhje e lirë imazhesh është shenjë talenti dhe jo spazmash për të krijuar poezi, dhe është e rëndësishme se ajo e nis dhe e shpalos këtë veçori që në librin e parë, tregues se do ta vazhdojë udhën e bukur të poezisë.

Derdhja e lirë e imazheve shpreh forcën e fjalës përmes kufijve realë dhe irealë të përfytyrimit, përmes trazimit të ndjenjave, dhimbjes, mërzisë, vemisë, po edhe dashurisë për fëmijën dhe fëmijët, për të afërmit dhe gjithçka të mirë në këtë botë, të cilën e shohim me sy kritik, po gjithësesi ajo mbetet e bukur dhe na afron shumë gjëra, të cilat duhet jo vetëm t`ia duam, po edhe t`ia rrisim. Fraza e fundit, mendoj se është mesazhi qëndror i vëllimit “Pres mëngjeset e mia”, një vëllim që mund të lexohet me një frymë dhe mund të marrësh prej tij aromën e ndjenjave të pastra, të cilat, mbeten larg çdo sofistikimi dhe dukje hipokrite. Ky vëllim përmbush më së miri këto aspekte të analizës së sipërpërmendur dhe vjen si një buqetë lulesh të freskëta në duart e kujtdo që e do të bukurën. Udhë të mbarë autores në rrugën e gjatë të poezisë.

BASHKË ME SHIUN

Qenka errur, pikat e shiut mërmërisin
Mbi çadrën time,
Si mijëra gishta trokasin,
Pika shiu...
Shi vezullues vetëtimash
Nga gojë të çliruar të qiellit
Që i flasin njeriut
Gishta rrezesh të ndezura,
Imagjinatash qiellore,
Bashkë me shiun balerin
Hidhem dhe ndjej,
Trokitjen e tij njerëzore...

POEZIA IME

Tokën pjellore të fjalës
E lëroj me dlirësi,
Dhe nga vargjet si livadhet
Çelin lule hijeshi.
Dhe vetes i kam premtuar
Vetullat kurrë mos i ngrys,
Se vjen vargu i bekuar
Si dallëndyshe poshtëçatisë.
Dhe në mua ngre fole
Si dallëndyshje fole ngre,
Ndaj do mbetet kaq e re,
Kjo poezi që më mbërthe...

BABAI

Ti je dashuria ime e parë
I bukur si atëherë dhe tani,
Mbret të ka çdo vajzë
Zemrën tënde pasuri.
Ti babai im,
Prania jote gjithnjë,
Një bekim.

histori

Gjuric Vladani nuk ishte një figurë e panjohur në mjediset e aristokracisë shqiptare. Barleti shkruan se ai ishte një "burrë prej parisë Skënderbeut.

Konti **Gjuric Vladani**, **komandant** i shquar i ushtrisë së **Skënderbeut**

Skënderbeu e kishte ndarë ushtrinë e vet në tri pjesë, - shkruan Barleti, - prej të cilave njërës i kishte vënë në krye Moisiun nga Dibra, tjetrës Gjuricin, nip prej motre, burrë trim e shpirt njeriu..." (faqe 537). Arbërorët shfaqën edhe këtu një faqe të ndritur heroizmi dhe fama e tyre i kapërxeu edhe kufijtë e Italisë.

Nga **Avni ALCANI**

Gjuric Vladani njihet në histori si një nga komandantët dhe luftëtarët më të shquar të ushtrisë shqiptare të shek. të 15-të. Për fat të keq, për këtë Aranit dhe luftëtar të madh të ushtrisë së Skënderbeut nuk ka shumë të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e tij, ç'ka e ndërlikon edhe më shumë biografinë e këtij aristokrati shqiptar. Në vitin 1981 Prof. Dr. Ak. Dhimitër S. Shuteriqi, në një studim kushtuar Aranitëve, të titulluar "Aranitia në vitin 1467" dhe të botuar në revistën "Studime historike", Nr. 1 (Tiranë 1981), shkruan se Gjuric Vladani, një ngë luftëtarët më të afërm të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ka qenë vëllai i Muzakës së Angjelinës.[13] *"Me vrasjen e Mojsi Golemit, - shkruan Dh. Shuteriqi në studimin e tij, - të Muzakës së Angjelinës me të vëllanë Gjuric Vladanin* (shënimi im-A.A.), *që të tre nipa të Gjergj Aranitit, - dy të fundit edhe të Skënderbeut, - dhe të pesë kapedanëve të tjerë shqiptarë, zhdukej një pjesë e zotërve dhe komandantëve më të njohur..."* (faqe 134). Për hir të së vërtetës duhet ta themi se mendimi e prof. Shuteriqit nuk pati gjetur përkrahje në tre nga monografitë më të njohura të shkruara për Skënderbeun, të botuara vitet e funtit, të autorëve Kristo Frashëri, Kasem Biçoku dhe Oliver Shmid. Por po aq e vërtetë është se kjo e dhënë as nuk është kundërshtuar prej tyre, gjë që na lejon të themi se deri diku ata e kanë pranuar (në heshtje) mendimin e Shuteriqit.

Është fakt se Marin Barleti dhe Gjon Muzaka, në veprat e tyre, nuk e përmendin Gjuric Vladanin si vëlla të Muzakës së Angjelinës, pasi, kur flasin për Vladan Aranitin dhe Angjelina Kastriotin dhe fëmijët që kishin lindur nga martesa e tyre, ata përmendin vetëm njërin prej fëmijëve të lindur prej tyre, i cili është Muzaka i Angjelinës. *"Prej asaj të lartpërmendurës Zonjës Angjelinë dhe të përmendurit Zot Vladan Komnenit*, - shkruan Gj. Muzaka, *- u lind i poshtëshënuari Muzak Komneni, i thirrur nga populli i Angjelinës, që ishte nip i Skënderbeut"* (Memorie, 1996, faqe 45).

Gjuric Vladani nuk ishte një figurë e panjohur në mjediset e aristokracisë shqiptare të kohës. Ai, shkruan Barleti në librin "Histori e Skënderbeut" (Tiranë 1986), ishte një *"burrë prej parisë së tij* (Skënderbeut) *dhe shumë i zoti"* (faqe 258). Kur e përshkruan Gjuricin, si një nga ushtarakët më të sprovuar të ushtrisë shqiptare, Barleti thotë për të se ai ishte *"trim dhe shpirt njeriu"* (faqe 537). As fama që kishte si luftëtar në ushtrinë shqiptare dhe as prestigji si një burrë i madh i parisë së Skënderbeut, nuk e bënin që ai të qëndronte nën hijen e vëllait të tij, apo të luftëtarëve të tjerë të fisnikërisë shqiptare.

Barleti, ndonëse nuk e pohon se Gjuric Vladani ishte vëlla i Muzakës së Angjelinës, ai nga ana tjetër shkruan se Gjurici ishte nip prej motre i Skënderbeut, ashtu siç ishte edhe Muzaka. Në librin e tij "Histori e Skënderbeut" ai shkruan se Gjuric Vladanin*"ishte në lidhje gjaku me Skënderbeun"* (faqe 604) dhe *"nip prej motre"* (faqe 537) i tij, por pa e saktësuar se i cilës motër. Ky është një informacion shumë i rëndësishëm, pasi e përcakton Gjuricin si të afërm të familjes së Kastriotëve, por që nuk është i plotë, pasi nuk e përcaktoi se i cilës motër.

Një tjetër burim, që dëshmon se Vladan Gjurici ishte nip i Skënderbeut, vjen nga një tjetër autor shqiptar, Dhimitër Frëngu, i cili ka qenë bashkëkohës i Skënderbeut dhe, për disa kohë, edhe si shoqërues i tij. Fan S. Noli, i cili ka cituar Dh. Frëngun dhe veprën e tij "Comentario de le cose de Turchi et del S. Giorgio Scanderbeg, Principe d'Epirro", kap.XXI, faqe 24, shkruan se: *"Kont Jurici, nip i tij shumë trim"* (Noli, 1967, faqe 91). Nga kjo dëshmi mësohet se Gjuric Vladani mbante titullin e fisnikërisë "Kont".

Lind pyetja: Cila nga motrat e Skënderbeut ishte nëna e Gjuric Vladanit? Skënderbeu ka pasur pesë motra, të cilat ishin Mara, Jella, Angjelina, Vlajka dhe Mamica. Mara ishte martuar me sundimtarin e Malit të Zi, Stefan Cernojeviçin, dhe kishte pasur dy djem, Gjergji dhe Gjoni. Jella ishte martuar me Stres Balshën dhe kishte tre djem: Gjergji, Gjoni dhe Boiku (Barleti, 1983, faqe 122). Angjelina ishte martuar me Vladan Komnen Aranitin dhe, siç e kemi përmendur, kishte pasur Muzakën e Angjelinës. Vlajka ishte martuar me Gjin Muzakën, por Barleti e të tjerë nuk japin asnjë informacion nëse kishin pasur fëmijë nga martesa e tyre. Gjuricin e përjashtojmë që të kishte qenë fëmija i tyre, për shkak se ai, së pari, do të duhej mbante mbiemrin e familjes "Muzaka" dhe, së dyti, sipas traditës, ai duhej gjithashtu që të kishte pasur si mbiemër emrin e të atit (në këtë rast "Gjini"), ndërkohë që dihet se ai nuk i ka pasur kurrë asnjë nga këto dy mbiemra. Kurse motra më e vogël e Skënderbeut, Mamica, kishte qenë e pamartuar deri ne kohën kur ky i fundit ishte kthyer në Shqipëri (viti 1443). Skënderbeu, për arsye të konjukturave politike, e martoi motrën e tij të vogël me Muzak Topinë, kështu që Gjurici nuk mund të kishte qenë as djalë i saj. Atëherë, i kujt motre të Skënderbeut kishte qenë Gjurici? Duke u nisur se ky i fundit mbante mbiemrin "Vladani" dhe ishte nip i Skënderbeut, siç na thotë Barleti, atëhere ai duhet të ketë qenë djali i Vladan Aranitit dhe i Angjelinës, motrës së Skënderbeut. Në fisnikërinë shqiptare të shekullit të 15 ishte traditë që djemtë të merrnin si mbiemër emrin e babait të tyre. Kështu, p.sh., djali i Jellës dhe i Stres Balshës, Barleti shkruan se quhej Gjergj Stresi (faqe 120).

Po përse Gjon Muzaka nuk e përmend Gjuric Vladanin në "Memorien" e tij si djalë të Angjelina Kastriotit dhe Vladan Aranitit, apo dhe si vëlla të Muzakës së Angjelinës? Shkaku duhet kërkuar te qëllimi që kishte pasur Gj. Muzaka kur shkroi "Memorien", të cilën e kishte hartuar për të vërtetuar se ku i kishin pasur pronat anëtarët e familjes së tij dhe të rrethit të tyre. Muzakën e Angjelinës ai e kishte kunat, burrin e motrës, pra dhe një pjestar të familjes së tij.

Barleti dhe Muzaka në veprat e tyre nuk e përmendin familjen e Gjuricit, nëse ai kishte qenë i martuar dhe nëse kishte lënë trashëgimtarë. Nëse mendohet se ai nuk kishte lënë trashëgimtarë, atëherë Gj. Muzaka e kishte lënë qëllimisht Gjuricin jashtë "Memories", duke mos e përmendur. Të njejtën gjë ai kishte bërë edhe me tre djemtë e Gjergj Aranitit, Thomain, Kostandimin dhe Aranitin, të cilët Gj. Araniti i kishte pasur me një grua italiane, në një kohë që i kishte përmendur të 8-të vajzat e tij, që kishte pasur nga martesa e mëparshme me Maria Muzakën, hallën e Gj. Muzakës.

Të dy vëllezërit, Muzaka dhe Gjurici, ishin ndër të parët fisnikë që u radhitën në ushtrinë e Skënderbeut, dajës së tyre, dhe qenë ndër komandantët më të shquar dhe më besnikë të tij. Pas kthimit të Skënderbeu në Shqipëri në vitin 1443, Muzaka i Angjelinës, shkruan Barleti, ishte ndër të parët nga krerët e fisnikërisë shqiptare që mbërriti në Krujë për ta përshëndetur, për t'i dhënë mbështetje dhe për t'i dhënë përkrahje. *"Kështu u mblodhën shpejt e shpejt pjesa më e madhe e krerëve më bujarë*, - shkruan Barleti, *- sidomos të afërmit e tij, me një fuqi ushtarake të pashoqe. Ndërmjet të tjerëve ishin: Muzaka i Angjelinës, nip nga e motra Angjelinë..."* (faqe 93). Dy vëllezërit qëndruan në ballë të betejave kundër osmanëve dhe në shumicën e tyre ata kishin luftuar sëbashku krah për krah me njëri-tjetrin. Në çdo betejë që zhvilloi ushtria shqiptare, si brënda por edhe jashtë kufijve të atdheut të tyre, që dy fatosat Aranitas treguan një guxim dhe trimëri të rrallë.

Skënderbeu u besonte dy nipërve momentet më të rëndësishme të betejave të tij që ai kishte zhvilluar kundër ushtrisë osmane. Gjatë rrethimit të 2-të të Krujës, kur Sulltan Murati II u vu vetë në krye të ushtrisë otomane, Skënderbeu dërgoi Muzakën e Angjelinës dhe Gjuric Vladanin për të vëzhguar kampin e ushtrisë rrethuese, për të vëzhguar situatën dhe për të parë vendin lidhur me sulmin e mundshëm të ushtrisë osmane kundër qytetit të Krujës. *"Për të vërejtur kampin e armiqve dhe për të parë mirë gatitjen e tyre lidhur me sulmin kundër qytetit*, - shkruan Barleti, - (Skënderbeu) *dërgoi më parë Muzakën dhe Gjuric Vladenin... ndërsa vetë qëndroi atje dhe po priste në një heshtje varri, gjersa të vinin ata dhe të merrte vendim se ç'duhej të bënte"* (faqe 258). Momenti më i rëndësishëm dhe më i vështirë për të dy vëllezërit Araniti ka qenë kur ata luftuan kundër Moisi Golem Aranitit, i cili ishte djali i xhaxhait, por që kishte tradhëtuar Skënderbeun, dajën e tyre, dhe ishte bashkuar me Sulltanin. Skënderbeu e kishte ndarë ushtrinë e tij në dy pjesë. Njëra pjesë komandohej nga Muzaka i Angjelinës dhe tjetra nga Gjuric Vladani. *"Ushtria jonë*, - shkruan Barleti, - *ishte ndarë më dy krahë, nga të cilët njërin e mbajti Muzaka, i quajturi i Angjelinës, tjetrin Gjuric Vladeni"* (faqe 461). Dy vëllezërit, me forcat e tyre të armatosura, u vendosën përballë ushtrisë turke, që ishte e komanduar nga Moisiu. Pas kërkesës që i bëri Skënderbeut për dyluftim, Moisiu nuk mundi që të përballej me prijësin e shqiptarëve dhe u largua me turp nga fusha e betejës. Kjo strategji e Skënderbeut pati qenë e jashtëzakonshme, pasi, duke i vënë Aranitët përballë njëri-tjetrit, e shmangu dyluftimin vëllavrasës, i siguroi fitoren e ushtrisë së tij dhe çoi në humbje e në fundin e turpshëm të M. Golemit. Pas kësaj beteje, Moisi Golemi i kërkoi ndjesë Skënderbeut dhe, pas faljes, ai i qëndroi besnik Kastriotit deri në fund të jetës së tij.

Gjuric Vladani u shqua si ushtarak dhe kapiten i sprovuar gjatë invazionit ushtarak që zhvilloi Skënderbeu në Itali, kur shkoi që të ndihmonte mbretin Ferdinant të Napolit. Mbretëria e Napolit rrezikohej nga Duka Johan, djali i mbretit Renat i Francës, i cili kishte luftuar kundër mbretit Alfons i Aragonës, atit të Ferdinantit. Skënderbeu në Itali, shkruan Barleti, e kishte ndarë ushtrinë e vet në tri pjesë. Njërën pjesë e drejtonte vetë, kurse dy pjesët e tjera i komandonin Moisi Golemi dhe Gjuric Vladani. *"Skënderbeu e kishte ndarë ushtrinë e vet në tri pjesë*, - shkruan Barleti, - *prej të cilave njërës i kishte vënë në krye Moisiun nga Dibra, tjetrës Gjuricin, nip prej motre, burrë trim e shpirt njeriu..."* (faqe 537). Arbërorët shfaqën edhe këtu një faqe të ndritur heroizmi dhe fama e tyre i kapërxeu edhe kufijtë e Italisë.

Tre Aranitët e famshëm, Moisi Golemi, Muzaka i Angjelinës, Gjuric Vladani dhe disa prej kapedanëve më të shquar të ushtrisë së Skënderbeut, patë një fund të hidhur dhe të tmerrshëm. Këta kapedanë në Betejën e Vajkalit, shkruan Barleti,*"të rrëmbyer nga furia e Marsit dhe vrulli i luftës, shkuan më tej nga ç'duhej..."* (faqe 604) dhe ranë në kurthin e ngritur nga Ballaban Pasha. Ndër të parët u hodh në sulm Moisi Golemi, që Skënderbeu i kishte besuar komandën e përgjithshme të ushtrisë. Pas tij u hodhën Gjuric Vladani, Muzaka i Angjelinës, Gjin Muzaka, Gjon Perlati, Nikollë Berisha, Gjergj Koka dhe Gjin Maneshi, të cilët, pasi u kapën të gjallë, u dërguan të lidhur këmbë e duar në Stamboll dhe atje u turturuan deri në vdekje. *"Me vdekjen e tyre*, - shkruan M. Barleti, *- e bënë Arbërinë më të përlotur se ndonjëherë më parë, sepse që të gjithë shquheshin shumë si për fuqinë e trupit, si për forcën e shpirtit dhe për dijen ushtarake"* (faqe 604).

Emrat Muzak, Gjuric, apo Gjurice, duket se ka qenë emra i zakonshëm në atë kohë në fshatrat e krahinës së Çermenikës, që kishin qenë nën zotërimin e familjes së Vladan Aranitit. Në regjistrin kadastral osman të vitit 1467 në fshatin Neçte (Neshtë) ishte regjistruar një banor me emrin *Gjurece, biri i Gjergjit*, i cili është i njejtë me emrin e kontit Gjuric Vladani. Në fshatin Gurakuq ndodhet ende një fis që mban si mbiemër *Muzhaqi*, kurse në fshatrat Kuturman dhe Shmil të Çermenikës gjendet edhe sot e kësaj dite fisi me emrin *Gjura*, i cili sështë tjetër veçse shkurtimi i emrit Gjurici apo Gjurece. Mali më i lartë në krahinën e Cermenikës quhet Guri i Muzhaqit, i cili ngrihet si një përmendore gjigande, në përkujtim të lavdisë së Muzakës së Angjelinës, Gjuric Vladanit dhe të Aranitëve të tjerë.

Tregime të jetuara.
Çdo ngjashmëri me emra realë njerëzish ose vendesh është rastësi.

Prova e besës

Nga **XHELAL ROÇI**

VRASJA E DIKËS

Sigurimi i Shtetit ka qenë një ndër institucionet e kohës komuniste më të errëta dhe më të egra.

Shumë nga krimet e asaj kohe janë gatuar në ato zyra, dhe sot, pas 25 vjetësh, loja me hapjen e tyre vazhdon. Pjesë-pjesë ato janë hapur, sipas orekseve të politikës, ndërsa në tregimet e jetuara të Xhelal Roçit ato "hapen" të plota: tregohen detaje, ngjarje, biseda. Por Xhelali nuk ka marrë përsipër t'i tregojë dhe zbulojë dosjet, por i sjell për lexuesit në formën letrare, si dëshmi të asaj që ka ndodhur.

Por edhe si mesazh se e kaluara nuk duhet përsëritur dhe edhe brezat e rinj duhet ta njohin siç ngjarjet kanë ndodhur. Vetëm kështu e kaluara nuk do të përsëritet.

Rrëzë malit me dru ahu, në fund të një shullëri, në fund të një lëndine që të krijon përshtypjen e një stadiumi të madh, rrethuar nga të gjitha anët me kodra, gjendet Katundi i Epërm. Përrenjtë që zbresin nga mali grumbullojnë ujin dhe në fund të fshatit. Ata bashkohen në një të vetëm, duke formuar një kanion, në mes të dy kodrave, që, nga banorët e atjeshëm, quhet Gjurra. Po të mos ishte përroi i Gjurrës, që shkarkon ujin në drejtim të lumit Drin, uji do të kishte mbushur këtë lëndinë dhe do të ishte kthyer në një liqen.

Shtëpitë e fshatit Katund i Epërm janë ndërtuar përreth kodrave, të veçuara nga njëra-tjetra, e të ndara në lagje sipas fiseve.

Fusha në mes mbillet me bimë bujqësore. Secila familje në këtë fushë ka një ngastër tokë që e punon, e mbjell, e vadit me ujin që zbret nga mali, i cili i plotëson nevojat e gjithë fshatit.

Përveç kodrave që janë më të ulëta, shumë shtëpi janë ndërtuar në faqen e shullërit, deri afër malit. Tokat afër shtëpive, fshatarët i kanë tarracuar dhe i kanë kthyer në ara, ku mbillen bimët e perimet, ndërsa mezhdat i kanë mbjellë me pemë si: kumbulla, mollë, arra, qershi, gështenja e hardhi. Ato, paralel me njëra tjetrën, duken breza-breza.

Në fund të shullërit, në një kodër, përkarshi diellit, me dyer nga jugu, ndodhet shtëpia e Kalosh Sulës. Familja e tij është një nga më të hershmet e këtij fshati.

I ati i Kalosh Sulës ishte burrë i përmendur për trimëri, bujari dhe zgjuarsi natyrore, bujk e blegtor i mirë. Ai kishte një sasi toke të mjaftueshme, nga e cila siguronte bukën e vitit për familjen dhe ushqimin për bagëtitë. Fjala e tij dëgjohej jo vetëm në fshatin e tij, por edhe në të gjithë krahinën. Sëmundja e rëndë dhe mungesa e ndihmës mjekësore e ndau atë nga fëmijët e tij; tre djemtë dhe dy vajzat, si dhe nga e shoqja, Fatimeja, në moshën 65 vjeçare.

- "Shkoi... shkoi, - e përmendte shpesh nënë Fatimeja, - atëherë kur ai duhet të jetonte, të gëzonte e të shikonte ditë më të mira. Nga paraqitja, rahmetliu, - vazhdonte Fatimeja, - dukej se kishte shëndet të mirë. Fëmijët iu rritën, djalin e madh dhe dy vajzat i martoi. Të gjithë iu bënë të zotët e punës. Për tri javë e mori ajo sëmundje e mallkuar. Ai e la shtëpinë me mall e me pasuri dhe me emër të mirë, pa gjak në derë, pa borxhe e pa ngatërresa. Dera e tij qëndroi gjithmonë hapur për miq e për dashamirë. Edhe armiqtë ia kishin zilinë".

Atë vit vjeshta kishte filluar me vranësira e me shira të përkohshëm. Ishin orët e pasdites. Një tufë sorra, mbasi u shkëputën nga lisat në kodrën përkarshi, fluturuan mbi lëndinën e mbjellë me misër, i erdhën rrotull fushës në fluturim dhe qëndruan në plepat para shtëpisë së Kalosh Sulës. Ata krrokatnin, sikur thërrisnin njerëzit e asaj shtëpie të dilnin jashtë për gjëmën e madhe që po ndodhte.

Nënë Fatimeja doli në derë e trishtuar. Iu krijua një parandjenjë e keqe, por përsëri e mblodhi veten. Ndoshta kanë ardhur të hanë rrush në hardhitë që iu kacavirreshin plepave. Ata, atë vit, kishin bërë si asnjëherë tjetër dhe veshat e rrushit trupmëdhenj vareshin poshtë e shndrisnin si margaritarë.

Dy krisma pushke në kodrën nga ana e veriut i trembën ata dhe sorrat fluturuan në anën tjetër të fshatit.

- E hairit daltë! – bëri me vete nënë Fatimeja. Lufta afër dy vjet që ka mbaruar, njerëzit akoma i kanë armët në krah e veshët të ngritur.

Disa burra u turrën me vrap njëri pas tjetrit andej nga u dëgjua krisma e armës. Kalosh Sula, siç ishte duke kositur, la kosën në mes të jonxhës, shkoi me nxitim në shtëpi, rrëmbeu pushkën, fishekët dhe u nis me shpejtësi andej nga erdhi krisma, për t'u bashkuar me grupin e burrave.

Nuk vonoi shumë dhe, nëpër të errur, filluan të futen në shtëpinë e Kalosh Sulës njëri pas tjetrit, miq e dashamirës të kësaj familjeje. Ata qëndronin kokulur. Asnjeri nuk fliste.

Fatimeja, e tronditur, kishte shastisur dhe kishte ndrojtje të pyeste se ku ishte Kaloshi.

- Mbahu, moj hallë! – i foli djali i vëllait Fatimesë. Ajo mbeti si e ngrirë në këmbë, s'mori guxim të pyeste se ç'kishte ndodhur.

- Kryet shëndoshë e të kesh djemtë e tjerë!

- Çfarë ka ndodhur, ore nip, me hallën?

- Bëhu e fortë, hasmi aq pat në dorë të bëjë. Ai na vrau. Ne na vranë Dikën.

- Oh, bre, shpirti i nënës! Lofka e zemrës! A ka mbet?

- Po... po. Për të mbet i ka shti dhe e vrau atë. I ka rënë dy herë mbas shpine. E ka vrarë duke u kthyer rrugës së mullirit. Ka shti në të i fshehur mbas ferrave, drejtpërdrejt mullirit. Kur shkuam ne tek vendi, ai kishte ikur. Dika ishte ftoh me kohë, i kishte kulluar gjaku. Ka vrarë veten, oj hallë... Nuk e bëmë beh këtë të keqe. Nuk e prisnim këtë punë nga Dulkallarët.

- Oh, e vraftë pushka e Zotit! – foli ajo dhe dy pika loti iu mblodhën poshtë gushës. Më djegka zemrën, oh i lasha zotin!

U mblodhën njerëzit e fisit, gjithë futeshin brenda kokulur. Ata takonin nënë Fatimenë në heshtje dhe lotët u shkonin për faqesh.

- Ishte i ri, bre, ishte i ri, shkoi pa e shijuar jetën, shkoi për kot, - fliste Fatimeja. Ndërkohë, një turmë me burra po sillnin në krah kufomën e Dikës. Ata e ulën në mes të dhomës. Një ulërimë e madhe shpërtheu në ato çaste. E ëma me ulërima përpiqej t'i shikonte plagët dhe me lotët që i shkonin krua iu ul te koka. Kalosh Sula i hodhi sytë të ëmës dhe i foli: - Bëj gajret e mos u ligështo, se do ta paguajë me kokën e tij, do t'i marrim hakun Dikës. Hasmi ka vrarë veten e tij...

- Jo, ... jo, nuk qaj nëna pa i marrë hakun, se i bëhet qejfi hasmit.

Ditët kalonin njëra pas tjetrës. Njerëzit vinin, takonin, ngushëllonin nënë Fatimenë e shkonin.

- Për një shpullë, për një grindje ma vrau djalin, e vraftë Zoti! - mallkonte ajo. Ne përgatiteshim ta martonim Dikën. E çuam në varr. Tmerr! Dhe qante me zë e me lot.

Sa herë binte shi e borë, nënë Fatimeja dilte në driture dhe hidhte sytë nga varret. Ajo gjithmonë qante dhe çdo ditë që kalonte i dukej se dhimbja për djalin veç shtohej. Kujtonte të kaluarën, vuajtjet që kishte hequr për t'i rritur fëmijët.

Dika, - u fliste shoqeve Fatimeja – më erdhi më i mbarë nga të gjithë fëmijët. Nuk është sëmurur asnjëherë, - dhe vazhdonte të qante e të ulërinte.

Barra për t'i marrë hakun i binte Kaloshit. Kishte edhe nga ata që e pyesnin se çfarë po bëhet? Çfarë thotë Kaloshi?

Ai shprehej se e ka marrë qeveria në dorë, ndërsa nënë Fatimenë, njerëzit që hynin dhe dilnim, më keq e ngacmonin në nerva, me biseda pafund për gjakmarrjen, të cilat ajo i kishte dëgjuar me qindra herë.

Me të qara dhe me ulërima, me hyrje e dalje njerëzish, kaloi viti i parë. Kalosh Sula merrej me detyrat që i ngarkonte pozita shtetërore. Ai gjithmonë ishte treguar i gatshëm ndaj thirrjeve që i bëheshin nga shteti i ri i sapodalë nga lufta. Kaloshi shkoi në hekurudhë vullnetar, por kur erdhi e gjeti nënën më të mërzitur e më të dobët nga shëndeti. Si të bënte? Gjaku i vëllait duhej të merrej patjetër. Gjaku lahet vetëm me gjak. Fatimeja e kishte në majë të gjuhës, se nuk më tret dheu djalin pa i marrë hakun dhe pa e çuar edhe atë, gjakësin, tek Dika, në atë dynja. Kaloshi disa herë i kishte shprehur se gjakësi është burgosur dhe është dënuar. Nënë Fatimeja shprehej se qeveria ka punën e vet, ndërsa ne kemi tonën. - Ai ka vëllezër të rinj e të një moshe me Dikën tim, të qajë edhe nëna e atyre si qaj unë!

Kaluan dy vjet e gjaku nuk ishte marrë. Shteti po forcohej gjithnjë e më tepër. Ai nxori ligje të forta që ndalonin gjakmarrjen. Kalosh Sula, për meritat që kishte treguar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, kishte fituar respektin dhe nderimin e shtetit të ri. Ai që në ditët e para ishte zgjedhur në jurinë e gjykatës për dënimin e kriminelëve të luftës në këshillin popullor të fshatit dhe në instanca të tjera. Kishte filluar pajtimi në çdo fshat dhe në shkallë zone. Nga shteti propagandohej se gjakmarrjen dhe hakmarrjen i nxiste elementi armik, për të prishur unitetin e për të përçarë popullin.

Kalosh Sula duhej të jepte vetë shembullin personal për pajtimin dhe faljen e gjakut, aq më tepër që vrasësin e vëllait të tij, Dikës, shteti e kishte dënuar. Por kush ishte ai që e bindte nënë Fatimenë për pajtim?!

Ajo ulej në sofër për të ngrënë dhe ngrihej pa ngrënë, duke qarë e ulëritur për Dikën. Kalosh Sula njihej se ishte ndër aktivistët e parë për zbulimin e për kapjen e kriminelëve të arratisur. Kujtdo që hynte e dilte në shtëpinë e Kalosh Sulës, nënë Fatimeja u ankohej se djali im, Kaloshi, nuk po lëvizte. Ai nuk po e merr hakun e vëllait të vrarë. Ai nuk e prish punën dhe rehatllëkun e tij.

- Dihet, - thoshte ajo, - ato punë për keq bien. Edhe më përpara: po të vrisje - do të të vrisnin. Edhe sot: po vrave - do të vritesh. Po nuk i dihet, pse nuk e vranë atë që vrau djalin tim! I gjalli ka selamet!

- Nuk u gjet një dashamirës të na dalë krah, fishekun ia jap unë – pëshpëriste nënë Fatimeja.

Kalosh Sula ishte anëtar në komisionin e pajtimit të gjaqeve, por nuk kishte të drejtë morale t'u fliste të tjerëve për pajtim, kur ai akoma nuk kishte pajtuar e nuk kishte falur gjakun e vëllait të vrarë.

Acarimi i nënë Fatimesë arriti kulmin, kur pas 5-6 vjetësh, gjakësi, duke përfituar nga amnistitë e ndryshme të bëra nga Kuvendi Popullor, u lirua nga burgu dhe erdhi pranë familjes. Shtëpia e tij, në vijë ajrore, ishte një kilometër larg, në kodrën tjetër përkarshi, në të njëjtën lartësi me shtëpinë e Kalosh Sulës. Kodrat, si kurorë, rrethonin lëndinën. Asnjë njeri nuk mund të falë gjakun e djalit tim e të pijë kafenë, se, për një zot, bëj namin e nishanin dhe e merr vesh e gjithë bota!

Nënë Fatimeja vazhdonte të qante e të ulërinte. Ajo ishte gati të nisej vetë e të shkonte tek shtëpia e gjakësit: të vriste atë ose të vdiste në duar të atyre njerëzve.

- Si nuk kam një armë e të dal vetë të qëlloj mbi të. Ajo dënonte e mallkonte ish burrin e saj, që kishte pasur disa armë dhe nuk i kishte lënë asnjë. Çdo natë me nënë Fatimenë bëheshin të njëjtat biseda, i njëjti avaz dhe e njëjta kërkesë.

– Në shtëpinë tonë – thoshte gruaja e Kalosh Sulës, - nuk ka qetësi, por ka vaje e ulërima, kritika e mallkime, se mbeti pa marrë gjaku i Dikës, dhe, mbi të gjitha, këto fjalë bien mbi burrin tim, Kaloshin.

(vijon)

Kërkohen korrespondentë në PESHKOPI dhe DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën **< rrugaearberit@gmail.com >** ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

Shkëputur nga libri me sonete
"Kashta e Kumtrit". Librin mund ta gjeni në librarinë M&B, Adrion
dhe mund ta porosisni pranë çdo librarie në lagjen tuaj

Sonete nga Naim Berisha

UJI I MURRËS SHKON I QETË

Uji i Murrës shkon i qetë
Dalëngadalë derdhet në Drin
Ah, sikur të isha vetë
Sall, një gjethe që fëshfërin

Sall një gjethe, deg'z a fletë
E kësaj vjeshte të verdhë si ftua
Të mbytesha unë në Drin e det
Për inat t'vashës që dua

Dhe të dilte të kërkonte
Djalin që preu në besë
Qiell' i vjeshtës ta tmerronte
Me gjëmimet e rrufesë

Ujë i Murrës rrjedh i qetë
Dalëngadalë mbytet në det.

NJE LULE E PARAKOHSHME PRANVERE

Më rrëshqiti këmba, befas, mbi dëborë
Dhe një lule vere, ndërkohë, seç pashë
Embëlsisht, e putha, e mora në dorë
Pasi në gjunjë mbi të unë rashë

Papritmas, dëbora në bjeshkë u shkri
Dhe lulet, gjithkund, sythet i çelën
Ndërkaq, m'u ndërmënd e para dashuri
Me vajzën si gonxhe, Entelën

Kështu, mendova se dashuria s'vyshket
Ngase mijëra sythe çelin në çdo stinë
Për mua dhe Entelën, mosha përtërihet
Se çdo ditë që vjen na shton dashurinë

Qyshkur isha djalë, kur kaptoja malet
Për dashurinë pashë, se edhe jeta falet.

PASKA MBIRË NJË MOLLË

Faqemollë, buzëshegë
Frut i pjekur në një degë
S'i gjej fjalët, ç'të të them
Faqekuqe, mollë në gem

Goja jote, shegë e çarë
Më ka lënë në gushë një varrë
S'qenka vragë, një blu e hollë
S'më le shteg, moj faqemollë

Ra një vesë përmbi rrafshnaltë
Mollë e ëmbël porsi mjaltë
M'u në mes yllsisë së krushqve
Paska mbirë një mollë e kuqe

Paska mbirë një mollë e kuqe
Thashë, ta marr për nuse.

PEIZAZH ME KASHTËN E KUMTRIT

Në prag të një avllie
Aty, në shteg të Kurtit
Sajojnë një korije
Vashat shtatselvi



Mbi krena ç'm'u digjet
Flakë Kashtë e Kumtrit
Ç'm'u bënë vajzat valë
Të lumit Drin i Zi

Ç'm'u bënë vajzat valë
Valë shkumëpërndezura
Në sevda ç'më ranë
Me Malet e Zeza

Mbi Malet e Zeza, n'Korijen e Kurtit
Digjet shkulm i Drinit me Kashtën e Kumtrit.

BUKA E VJETËR

Do vete vrik një ditë në Sqezhë
Të pjek dikë, një ish-dashnore
Pa do të vesh kostumin bezhë
T'i sjell në mend vjeshtën malore

Kumbull e bardhë, unë do ta thirr
Qeshke, ende, si një rrushkuqe
Porsi në baltë një xhevahir
Shndritke me erën posi burbuqe

Qe kohë e keqe kur unë të doja
Ose, më saktë, qe zi e bukës
Asgjë më shumë s'do të mund të bëja
Sikur t'më shtynin me qytë të pushkës

Nga bukë e vjetër në paç thërrime
Do të vish me mua! Je nusja ime.

TË DIGJESH PËR DASHURINË

Do të shtrihem, tani
Barkas, përdhe ...
Qe të ndiej nga afër
Erën e tokës, afshin e ugarit

Të vijnë zogjtë e qiellit
Me gaz dhe hare
Dhe të më mbulojnë
Me flatrat e tyre dhe fijet e barit

Ashtu i shtrirë
Do të doja të flija gjatë
Si, dikur, në plevicë
Mbështjellë me pendët, barin e kashtën

Në muzg, në mëngjes, në mbrëmje a mesnatë
Le të vijnë vajzat e fshatit dhe të më vënë flakën.

FLUIDITET

Në sytë e tu, seç shoh një dritë
Që s'e kam parë në mijëra vjet
Ndaj më magjeps imazhi yt
Më lumturon, më mbush me jetë

Bëj të të prek, po s'të prek dot
Se ti fluide bëhesh, ndërkaq
Por unë nuk di të qaj me lotë
Ashtu kokulur si një humbaç

Rishtaz, rishfaqesh si valë e Drinit
Një shkulm rrëkeje seç më lë pas
Bashkë me aromën e lules së blinit
Lë një ofshamë, një buzagaz

Tash sytë e tu ku ndrijnë, vallë
Gjithkund, besoj, si në përrallë.

MALLI I SHKRETË

Dhe sythet e brishtë, që selit natyra
Dhe kopshtet me mollë ku të çmend aroma
Shto dhe tërë peisazhet, krejt, ngjyra-ngjyra
S'qenë më të bukura se gjithë vajzat tona

Mes vajzave të bukura, ajo qe e rrallë
Një yll i largët, që koha s'e treti
Për këtë, ndoshta, e ndiqja me mall
Yll i largët qe, yll i largët mbeti

Nis e kujtoj ditët kur ishim studentë
Netët me hënë, me zogj dhe me flutura
Siluetë e saj s'më shqitet nga mendtë
E thjeshta, e ndritshmja, e bukura

Ah, ky mall i ngratë, ky malli i shkretë
T'kisha qënë dhe shkëmb, do t'më kishte tretë.

NJË PENG BUKURIE

I gëzohem jetës sime, ngaherë
Jetës së ngritur me duart e mia
Mendoj si dimrin e kthej në pranverë
Teksa marr fuqi veç nga dashuria

A thua se askush s'qenka, vallë, si unë
Përderisa ndihem mirë në strehën time
Shkoj e vij nga puna dhe prapë jam në punë
Ngre kështu të ardhmen me një mal mundime

Ngre kështu të ardhmen në një kënd të botës
Ngroh dashuritë njësoj sikur dielli
Teksa puth të dashurën në prani të gotës
Diç më gërvish zemrën si ferrë trëndafili

Njësoj sikur gurin pika e thërmon
Një peng bukurie, fshehtas, më lëndon.

NJË VRUG I GJALLË

E zënë në faj, herë pas here
Si vetëtimë ndizesh, në të rrallë
Unë, një mugull i blertë pranvere
Ti, një shkretim, një vrug i gjallë

Tani, të të flas është e kotë
Se ti po lut një tjetër jetë
Detin në këmbë s'e marr dot
Sikur të bëhem edhe me fletë

E humbe freskinë vajzërore
Nuk të feks më në sy e faqe
Dhe buzët e tua epshore
U zbehën si dimrat në parqe

E di, prej kohësh, ke lojtur mendsh
Ik, pra, shko, si bëfsh, gjetsh.

NËPËR ZJARRE VJEN PRANVERA

Do t'i shtrydh retë e qiellit
Dhe me shiun do të flladis
Luleborën e brishtë të prillit
Lulebardhën si oriz

Se nëpër zjarre vjen pranvera
Shpirtra e pemë përtërin
Të thatin gjeth seç e merr era
Rij e njoma në kopshtin tim
Rij e gjelbra në vjershërime
Si cijasjet në fllad të erës
Le të digjet kjo zemra ime
Bashkë me pajën e pranverës

Bashkë me pjalmin e zjarrmisë
Digjet shpirt' i dashurisë.

PËR SHKAK TË ËNDRRËS

Për shkak të ëndrës, s'e kam njohur frikën
Kundër saj kam shkruar dhe në shputë të dorës
Në lëvore plepash, shpesh, e ngulja thikën
Dhe shkruaja mbi të, në vend të fletores

Endrrën të mbushur me jetë e kam pasur
Si mali me lisat, si deti me valët
Sa herë që me muret, natën, jam përplasur
Endrrat, ndërkohë, më shëronin plagët

Endrrën e kam pasur, ngaherë, të shenjtë
Me shpirt e kam dashur dhe e dua shumë
Vetëm me ëndrën kam çarë në jetë
Kam ecur pa ngrënë, kam pritur pa gjumë

Si gjënë më të shenjtë e ruaj në shpirt
Vetëm me ëndrrën, natën e bëj ditë.

VAJZAT E RADOMIRËS

Vajzave të Radomirës
Të mirat nuk iu ranë prej qielli ...
Me qumështin që i mjelin hënës netëve me hënë
Mëngjeseve mëkojnë çdo rreze dielli

Pastaj ngjiten Korabit, shpatit të thepisur
Një nga një, ngjitin Shkallët e Vjetra
Secila, ndjesimolisur
Secila, më e bukur se tjetra

Sapo mbërrijnë
Një kënd të Lëndinës së Lotëve
Djegur mallit për djemtë e Kalasë ...
Vajzat e Radomirës kthehen në lule zonje

Kthimi i vajzës në lule dhe i lules në vajzë
Eshtë motiv i lashtë, viseve të Kalasë.

tregim/poezi

Në kuadër të Festivalit Letrar për të Rinj "Tirana 2016", organizuar nga Botimet Toena, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe bashkisë së Tiranës, Alban Tufa fitoi çmimin e dytë në prozë. Për lexuesit tanë po sjellim këtë numër tregimin me të cilin Albani u nderua me çmim.

Festivali Letrat për të rinj është një veprimtari e përvitshme që synon evidentimin e talenteve në fusha të ndryshme të artit: prozë, poezi, ese, video-art, fotografi, art-grafik, etj.



Tinguj qe thyhen

Pikërisht kështu i ndodhi të birit të Ajaz Çelikut në fshatin Shterpë: tek luante me gurë në lumin e Veleshicës, i cili nuk pushonte së gurgulluari as verë, as dimër, zhytet në një valë mendimesh e fantazish, se ku shkon e tëre ajo Veleshicë, pastaj ajo me gjithë Drinin e Zi. Ç'rezervuar i nxë?Goxha mendime të pjekura i vinin në rradaken e tij rrumbullake, njëjtë si kungulli i papjekur. Nuk dihet ekzakt se sa kohë u përhumb i biri i Ajazit në mendime, por mjafton fakti se lopët e tij nuk i nxinte syri kund, që ai të dilte nga ai pellg mendimesh, të mallkonte veten pse ra sërish pjesë e këtij dështimi, realisht përsëri katastrofal.

Gjëma i mbiu në derë (këtë rast në gurë) djaloshit të ri. Në mendje si me magji, iu shfaqën paralajmërimet e të atit, britmat e tij, dhe më pak herë ndonjë shpullë surratit. Kjo e fundit dhimbte më fort.

Varianti i parë që rrëfimtari rrëfen herë pas here është që: Asimi, u çua nga guri ku qe këmbakryq, dhe i ra rrotull gjithë fushës, e në të perënduar, me kokën ulur u kthye në shtëpi ku e ëma i thotë që lopët i kanë zënë Cungët në arën e tyre. Por ka dhe një variant tjetër i cili thotë që, ai, i paska gjet lopët në vathën e Halit Cungut, dhe se djemt e tij i paskan thënë që po nuk pagujte dëmin, harroi lopët. Madje-madje, nëse ndodh sërish, ata do ia thernin dhe gabimi s'do mund ta shlyhej nga kurrkush me asgjë.

Gjithsesi, ai e mori guximin t'i dalë sërish të atit përballë, si burrë. Qëndroi para portës për një kohë të majme e pasi e kuptoi që veç po humbte kohë u fut brenda për t'ia thënë të atit që lopët i ishin humbur, e pastaj i kishin marrë Cungët, dhe se ky ishte aty me duar në xhepa.

Flitet që Asimi paska qarë, por gjithsesi e paska gjet forcën të futet brenda.

-Siii the? Prapë? Turp, turp, turp...se mos ke turp ti! -hakërreu Ajazi.

-Po si merrja dot mor babë, se ata ishin tre vetë. Pastaj unë jam fajtorë. Lopët bënë dëm.- u përgjigj me lot në sy Asimi, përballë babës së tij.

-Mos mu përqull- thirri ai, pastaj vazhdoi, - dil e mos më hajde brenda me duer në xhepa.

-Po s'di... Si t'i marr... -fjalët iu mekë në gojë.

-Një zot e di kujt i ngjave. Nuk janë kështu as ata të tët ëme, - sos ai

Asimi ngeli i gozhduar para të atit.Nuk e shihte nga fytyra, s'kishte sy e faqe ta shihte ashtu, madje as guxim, por e pa me vëmendje nga duart tek dredhte një cigare, e cila i doli e trashë, e fryrë si hardhucë barsë.Ia kishte qejfi fort ta thithte, ndoshta jo më shumë për kureshtje se sa ngaqë kish dëgjuar se zehëri del me zehër. Po vdiste nga dëshira t'ia kapte prej duarsh atë cigare obezë, ta ndjente në mushkëri, ta dehte në palcë, dhe si përfundim kjo historia e tij të mos ishte pjesë e jetës së lopëve dhe e anasjellta, as ato të mos bëjnë më pjesë në jetën e tij.

-Mos humb kohë, do vish me lopët sonte.- urdhëroi Ajazi, tek mustaqet e tij u drodhën cepash.

Ai u kthye dhe eci me një hap të vendosur.Ra në bodrum dhe doli pa u venë re.

Mund të kish dalë nga dera e madhe, por një zot e di pse zgjodhi të dalë nga pas. Rrugës mund të ketë qarë, madje mund ketë dënesur me gulçime ose mund të ketë vrapuar duke thithur ajrin siç donte të thithte cigaren, nëpër mushkëri duke e dehur veten me dëshirë.

Drini dhe Veleshica putheshin me epsh mes tyre (këtë rrëfimtari kurrë s'e harroi) dhe krijonin një zhurmë si rënkim. Tingujt e puthjeve të tyre rrihnin shpatet përreth e dëshira aty merrte përmasa të trasha. Këto rënkime që ia merrnin kohën Asimit e kishin çuar atë sot në një ngatërresë fijesh të mendimit, në një dimension tjetër perceptimi ku jeta dhe vdekja ngjyejn duart me dinamit të zier.

Trillimi i trurit të tij, kishte marrë një mision të mundur në mendjen prej 13-vjeçari.Në një mpiksje logjike kishte vepruar si një kompjuter dhe u gjend mekanikisht para të atit për një orë.

-Bab' Lopët i ke posht. Unë nuk jam qullë

Në shtëpinë e Ajaz Çelikut ra termet. Do ta donte fort një tërmet tjetër Ajazi, por veç ky mos t'i binte. Nga tavani i çarë e bërë kërpudha-kërpudha ra një copë suvaje mu para syve të tij. Mustaqet prap iu drodhën, por këtë herë ndyshe, diç më rëndë, diç më thellë, e diç më frikshëm.

Më i vogli i Çelikëve, 4-vjeçar atëkohë, trazonte në botën e tij të ëmbël e të pastër, me një shufër hekuri vatrën e zjarrit në oxhak.Askush nuk e vinte re, sepse të gjithë e kishin mendjen te i madhi, e kështu ai vazhdonte lojën e tij të preferuar, duke trazuar zjarrin. Fundja ai po shfrytëzonte rastin dhe as që i interesonte lopa, i ati, i vëllai, e aq më pak burrëria. Buzëqeshtte.Sytë e tij tregonin një botë të re, si diçka krejt ndryshe në odën e tyre që kishte gatuar veç trimëri.

Duart e tij të vogla të nxira nga shufra e hekurit e cila kushedi sa herë ishte zhytur në hi, dilnin hapur kundra zjarrit, si me thënë, po kryenin betejën e ekzistencës. Ai donte ta shuante zjarrin me shufër, por çuditërisht ai çartej më tepër dhe në prrafëllima e sipër dilnin shkëndija mbi flakë.

Posht fshatit, Veleshica ashtu nuk reshtte së ecuri, si një burrneshë. Gjithë jetën penetrohej nga Drini, e në moment shfaqeshin shkumëzime që në çast pilleshin e ngordheshin si të mos kishin qenë dhe të dy lumenjtë bashkë merrnin rrugën për në Shkodër, ku divorcoheshin në fund të Kalasë.

Asimi nuk e njihte Shkodrën, as detin. Emrin e këtij qyteti, që as e dinte se ishte qytet, e kishte dëgjuar njëherë nga dritarja e një konaku, ku një zë i forte plaku kish shpallur: "Mendja, or burra, ka lind në Shkodër, ka bujt në Mirditë dhe asht vendos në Dibër. Dhe jo në pak raste ky ishte arsyetimi që i jepte vetes sa herë mendonte se i vinte një ide në kokë.

Ai thjesht kish rënë thellë në dashuri më lumin e tij nën këmbët e fshatit, i cili ngrehte e shkrehte histori e bëma pafund, ku më e reja, ishte kjo e tij.

Mu aty mbi gurin ku ulej këmbakryq, kohët e fundit e kish marrë malli për fëmijërinë. Ai nuk ndjehej më fëmijë. I ati ia kishte bërë bindje që tashmë është rritur, e kjo bindje si padashur i ishte bërë ndjenjë. I kish fol për nderin, për besën, sedrën e shumë-e-shumë tipare të tjera malësori. Gjithë ç'i ishte thënë ia kish rrahur fort butësinë e tij, dhe sot, gjendej ballë të atit, tek po i jepte faktin e shekullit që realisht ishte rritur. Sot po i jepte të atit brumin që ai kish gatuar.

I shtangur para tij, i kocktë, pa butësi, me pushkën në dorë si një çmim që po ia dorzonte të atit ia shtriu përballë.

-Urdhno pra! I vrava Cungët.

-Ah ça m'bane... më shtive në gjak -rënkoi Ajaz Çeliku

Ndërkohë prrafëllimat e krandeve të zjarrit vetëm shtoheshin, ndersa vogëlushi ngacmonte qetësisht vatrën si me dasht të thyejë kohën.

Nga **Argen CIBAKU**

NDRYSHE PREJ TJETRIT LIND

Diell
që u tremb
prej fërk-fërkesh
të këpucëve të ashpra
shkelë në veshje të zorit,
prej rrugetire stërkëmbesash
që kishin dalë si kthesë e beftë.
papritur-pa sinjal-pabesisht.90 gradë.

duar që më bien pas shpatullave e flasin.
"asgjë ska ndodhur. jam atje.ika me ambulancën"
në morfinë krejt thjesht aromat e barnave miksohen
thyhen nga reflektimi i një grumbulli bisturish për n'sallë.
që mblidhin rrezet e dritave anekënd, thua thjerra transportonin?!
dhe sikur përplasesihin qepallave të ulura dhe i ftonin në agun e nji dite t're.

ASGJA MA TEPËR SE ERR'SINA

Edhe në u nistë përzymt,
e ardhmja ime,
s'do ta ndjek.
si një kristal anizotrop
ka gërvishtun
cifla-cifla kazanë vagonësh
për me dal' jasht trupit tand.

Edhe n'm'a mbuloftë errsina
fije-shpresën e mbetun n'hava,
më shkund që veten ta përmend,
që kundërshtimthi ma mori galeria.

Ndërkohë që pres të fundit vagonë
ti përcjell-
se mos në pakujdesje -
mbushen n'frym'kambime t'shpeshta
e *marrin naj pneumoni*.-
emën i nji plage t'vjetër
e bame shtraze,
prej nji plage ma t're.
(pa shpresë se do kalojë ndonjë vagon,
me e qitë jashtë)

Edhe me m'prite e varun mbi derë
veshje e kurdisun si për aristokratë
un' i krrusur jam,
si përkulet gozhda e mbetun n'nogë,
prej force t'pa përballueshme t'çekicit.
- e ma mir kish me m'ra me kenë jo i futun n'ta',
se ja heki bukurin',
po me kenë i varun njaj n'mu!
- se asht ma i shtrejt !

IMAZH

Sytë
Kristale-blu
Ishin rrokada botësh
Pa kurrefarë kushtesh,
Që tregonin si mund të falet
ai që kurrsesi s'duhet as vetë ta kërkojë.
-si mund të presë një tavolinë darkën-bosh?
-si mund ta tregojë një ngjarje njeriu me sy?
kjo darke ka vetëm 11 thërrime dhe 1 tas t'uritur
Si nga copëza pasqyrash thyen nga nje fëmije
Vijëzimin skalitur nga vuajtjet-përvijëzojnë
E përcjellin si fragmente fotografimesh.
Stërkala dhimbje ne trajtë kujtimesh.
Histori,që zbatice detin e bëjnë
me dallgë shkumëzuese.
Derisa e fundit pikë
Ra prej syve të tua
që e ngjyen
Blu.

ese

Bashkia Dibër me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Agjencive të OKB-së në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë në bashkëpunim me Qendrën Agritra Vizion dhe AZHR me datë 9 dhjetor 2016 zhvilluan para Pallatit të Kulturës Peshkopi mbylljen e fushatës ndërgjegjësuese: "16 Ditë Aktivizim kundër dhunës ndaj gruaj dhe dhunës në familje". Me këtë rast, Zamira Gjeleshi, një nga organizatoret e veprimtarisë, përzgjodhi për gazetën disa krijime në poezi dhe prozë të nxënësve, të cilat kanë në qendër dhunën në familje. Redaksia vendosi t'i botojë këtë numër dhe numrat e ardhshëm. Ritheksojmë se gazeta mbetet e hapur për botimin e tregimeve, poezive dhe krijimeve të tjera artistike të nxënësve dhe talenteve të reja nga të gjitha shkollat e qarkut të Dibrës.

Unë zgjedh të **jetoj pa dhunë**

Nga **Ilda MUKA**

UNË ZGJEDH TË JETOJ PA DHUNË

Unë e di çfarë do t'i tregoj vëllait; nuk kam nevojë që më mësoni. Ka kohë që i kam zgjedhur fjalët.

Unë i tregoj , që kur kam qenë e vogël, e brishtë, e më thirrnin engjëll, ndërsa ai ishte djalli që më pushtoi trupin. Atë ditë të acart dimri, në një eskursion në mal, unë e humba pafajësinë – më vranë. Aty më poshtëruan e më nxorrën shpirtin.

Ai vetëm sheh e nuk më kupton, por unë nuk do të ndalem.

Çdo natë prej asaj dite të mallkuar lahem me ujë të nxehtë, duke u munduar që të pastroj trupin prej shenjave nga goditjet.

Çdo natë fle me dritare hapur të marr ajër, sepse akoma më zihet fryma.

Sytë e tij mbushen me lot, ndërsa unë tregoj plagët e hapura në lëkurë dhe në zemër.

Me siguri mendoni, që jam e ashpër, por shpirti im nuk ka me mundur me mbajtë të fshehur në xhepa barrën e rëndë të kujtimeve.

E puthi në ballë Engjëllin, që më nxjerr nga kasolljae dhimbjes, ku kam mbyllur veten.

Mami është ajo, që më mjekonplagët dhe mbjell lule në brinjët e mia të thyera prej dhimbjes.

Babi nuk më sheh asnjiherë si viktimë, po si luftëtare; plagët m'i sheh si shenja të bekuara të mbijetesës.

Vëllai im më sheh ashtu si unë kurrë nuk mund të shoh veten – si qenie e paqtë, e cila kurrë nuk është ndotur nga ndyrësia e krimit.

Kur shoh veten në pasqyrë, është ai që këmbëngul që një qenie kaq e bukur si unë kurrë nuk ka shkel në këtë tokë.

Ai më fal një pjesë të pafajësisë dhe të lumturisë që mëvodhën.

Unë e dua vëllain tim dy herë; nji herë se e kam vëlla, dhe nji herë se ai është Engjëlli që më do, kur unë nuk mund të dua veten.

Pra, unë i kam zgjedh fjalët, prandaj nuk dua që të më tregosh se çfarë do t'i them unë vëllait tim, po dua të më tregosh se çfarë do t'i thuash ti, motrës tënde!

Nga **Besjana MAZARI**

DHUNA, NJË PARAZIT I PËRHAPUR KUDO

Shpesh herë kemi dëgjuar nëpër media fjalën "dhunë" ... dhe nga kjo fjalë tepër "shurdhuese" për personat e vëmendshëm, shohim shkaqet e më pas pasojat e tmerrshme. Gjithkush mund të thotë: -O Zot na ruaj! Këta s'janë njerëz! Por ... a është e mundur që dhuna të jetë një lloj parazit i vogël i cili pickon këdo, por efekti apo sëmundja që shkakton të shfaqet në kohë të ndryshme?!

Kjo është një pyetje tepër delikate, tepër e ndjeshme,si një rrjetë e hollë merimange, që mund të shkatërrohet edhe nga një pikël e vogël uji. Po të marrim shembull gruan, nje krijesë tepër delikate, e bukur, e ndjeshme, një natyrë krejtësisht ndryshe nga ajo mashkullore, do të vërejmë se keqtrajtimi, diskriminimi e ka perndjekur atë kudo dhe kurdo. Që në kohët e lashta e deri në ato moderne. Por kjo gjë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e drejtë.

Si ka mundësi që një grua, një krijesë aq delikate, të pësojë aq shumë probleme, aq shumë keqtrajtime sa zemra, mendja dhe shpirti nuk mund të durojnë dot më?! Si ka mundësi që në këtë botë ka nga ato njerëz të ligj sa përveçse grave, keqtrajtojnë edhe fëmijët. Si ka mundësi që këta njerëz të mos kenë një zemër?! Këto pyetje të gërryejnë thellë në shpirt. Por, për sa kohë që kjo dukuri shkatrrimtare vazhdon,si do të vazhdojnë jetën aq gra, aq vajza të cilat kanë një jetë përpara për të jetuar.

Për këtë unë them se duhet të bëjmë një ndalesë në fillim, e më pas, të gjithë gratë, vajza së bashku, të themi me një zë të lartë që ta dëgjojë e gjithë bota:

STOP DHUNËS NDAJ NESH!

Nga **Argen CIBAKU**

BUZ'QESHJA JOTE

Pasuria kish zbythë të tjera ndenjëse,
Varfëria e pagojë e fajtore,
fati skish qenë dhe aq zotri sipas rastit dhe i skëterrtë
madje,as koha s'kish pritë,në udhëtim të vet!

Prapëseprapë,
ne mbetemi thjesht Sizifë!
-që do të luftojme me frymën e fjalës
apo thjesht me një ves të hershëm: një qeshje
si të luftosh nanoteknologjinë me thikë guri të mprehtë.

Por as snobizmi i jetës,
s'e përlyen dot buz'qeshjen tënde!
As cungala padrejtësie se ç'formëzuan
buz'qeshjen tënde cullake,
të vetmen lodër atavike
marrë peng femijërie.

Ti mbetesh statujë qeshë-ndritë,
si fener trotuari që mezi ngopet n'elektrone
që s'nguron m'e pyt':
-kush është në prag gijotine?

AGU I NJI DITE T'RE

I vura tërkuzë diellit dhe e hodha pas malit,
E prita rojtar natën me perçe të zezë,
Kuvend bashkë me orën zile-kali
Kohën s'e vrava krejt fillikat.
Ora ngadalë kish prekë n'5,
Dielli çjerrë kish qiellin,
Kish heqë perçe-zezë.
Kishte zgurdulluar
Sytë pa përtese ,
Nata ish bërë
Ag' e vese,
Ish bërë
Diell

Nga **Flamur DARDESHI**

TI FLE

Ti fle atje ku edhe qielli fjetur ka
Ne sendiljen ngjitur,mbi timin krah
Ti fle dhe ëndërron kush e di ç'ish
E ëndrrat e tua mbi krah rëndojn dyfish

Por un' dot s'përgjumem, nuk mundem dot
Ëndrrat e tua duhet ti ruaj,ti ruaj me kokë
Ngadal e përhumbur ti shflihesh lehtësisht
Mua ëndrrat e tua më ngrijnë ndër gisht

Dhe nga ajo ngrirje mpin,
Të lumturin krah

Por nga kjo mpirje ti mos u shqetëso
Ti përgjumu e dashur,ëndërro
Dhe krejt sikur te mpihem ti mos u trishto
Më i lumtur jam e dashur kur mbi mua ëndërro

E nëse pas gjumit të ngrirë më gjen
Ti mos u frikëso,mua menjëher gjaku më zjen
Nga zjarri yt do shkrihem sërish
Flak,zjarr e llav do nxjerr ndër gisht.

Nga **Ygerta GJELESHI**

UNË ZGJEDH TË JETOJ PA DHUNË

Këtë mëngjes emërharruari nëntori dëgjoj melodinë më pikëlluese të Universit, dëgjoj të qarën e nënës sime. Shoh lotët e saj të pikojnë një nga një, e ndjej dhimbjen e saj aq të madhe. Ajo po na shikon me sytë e saj prej engjëlli të skuqur nga e qara sikur do të na thotë të largohemi, të ikim prej aty e të gjejmë një strehë lumturie fëmijërore diku mes shoqërisë tonë të lagjes.

Kjo nuk ndihmon. Nuk ndihmon aspak të harroj atë që kam parë pak më parë. Dy engjëjt e mi në luftën mes zemërimit, goditjeve e përuljes. Kam parë dy engjëj në flakët e ferrit.

A është e mundur vallë?

Unë nuk u besoj syve të mi. Babai im është zemëruar, tiparet e fytyrës së tij duken të vrenjtura, shumë më të vrenjtura se zakonisht. Ai qëndron përballë nënës e po bërtet me sa zë ka. Të ëmbla duken britmat krahasuar me goditjet e shumta që pasojnë. Lëviz e godet pa mëshirë me duar e shkelma, nuk ndalon, nuk dëgjon. Duket se nuk sheh asgjë tjetër përveç zemërimit të tij, nuk i intereson asgjë më tepër.

E në tërë këto vuajtje, në vrazhdësinë e goditjeve nëna qëndron e brishtë, mes shkelmave të tij ajo na kërkon ne dhe me atë pak forcë që i ka mbetur na përgjërohet të mos e shikojmë atë skenë të errët që shfaqet para nesh. Jam përhumbur në këtë skenë, siç duket babai im ka humbur në alkool, në shishet e shumta që ka zbrazur dhe ka hedhur mbi tavolinë, kështu duke ndarë në copa lumturinë e familjes tonë e me zë të vrazhdë ulërin: " Ikni që këtu, kjo është mes meje dhe nënës suaj!"

U mundova të veproj ashtu siç nëna ime thotë mes të qarave të saj, filloj të lëviz këmbët në një vrap thuajse të shuar, por nuk më binden edhe aq larg, thjesht deri tek korridori i ngushtë e i gjatë, përballë një pasqyre me reflektim të zhburosur. Aty shoh fytyrën time mes një mjegulle të dendur, mjegull e krijuar nga uji dhe kripa e dy deteve të kaltër që rrjedhin e jetojnë në ballin tim.

Sa pyetje e mendime më vërshojnë nga të gjitha anët e atij korridori ku kam tërë ato copëza jete. E si mund të ik dhe të lë nënën time në atë gjendje të frikshme zemërthyese? Si mund të lë babain tim të shndërrohet në njeri të tillë ? Çfarë të bëj unë, thua mund të bëj diçka?

"Më ndihmo t'i shpëtojmë ata, më ndihmo t'i ndihmojmë ta duan njëri-tjetrin përsëri"- dëgjoj të më thotë ngadalë e me një grimë shprese vëllai im i vogël tek më mbështjell në një përqafim strehues me duart e tij të vockla në ecejaket korridorit....

Tani të gjithë e dinë se në familjen tonë ka plasur sherri.

Aq deshi sa mami të flasë me komshien, që gjoja erdhi për "farë kosi" dhe ajo hapi lajmin...

Kalamajtë u mblodhën duke qeshur e sharë me zë të lartë...

Në shkollë vendi ynë është në fund, të fundit e të fundmëve, por dhe të pafuqishëm për të ndryshuar gjendjen.

Disa nga komshijtë u vjen keq për mamin, lajmëruan dhe në polici, por babai u tha se është çështje" e brendshme".....dhe durimi i tyre u kthye në zemërim: "Pse dreqin nuk e lë?"

Ne u bëmë epiqendra e talljeve: "buzëqesh vogëlushe, pa – pa – pa, ç'na duhet televizori kur kemi komshinjtë!"

Unë jam e sigurt se do të mbijetojmë kësaj periudhe të turbullt:

S'ka rëndësi çfarë ndodh, mes dhimbjesh mësoj se nuk duhet të mbaj turpin dhe fajin e të tjerëve edhe pse ato janë prindërit e mi.

Unë zgjedh të jetoj pa dhunë!

Dyzet e dy vitet e punës së Hasan Hoxhës rrezatojnë mund, djersë pa fund për shërimin e të sëmurëve...

Lamtumirë i dashur Xhevat SPAHIU

Me hidherim te thelle, percjellim Xhevatin tone te shtrenje per ne banesen fundit ate te Zotit.

Xhevati yne u lind dhe u rrit ne gjirin e familjes Spahiu, nje familje tregtare me tradita te shkelqyera qytetare e ardhur ne Tirane nga Dibra e Madhe 85 vjet me pare.

Ai u edukua dhe u shkollua ne familjen e tij, prane Rruges se Dibres, si si biri i pare i saj, u be shtylla dhe shembulli i njeriut te mire ne Familje.

Xhevati studioj ne Tirane, shkencat ekonomike



dhe kontriboi me profesionin e tij, te Ekonomistit si nje nenpunes i perkushtuar, dhe njohes i mire i profesionit te tij, duke punuar me ndershmeri, me zell, dhe vullnet ne Institucionet me ne ze te vendit ne fushen e arsimit dhe te shkences.

Per nje periudhe per rreth 35 vjecare ai drejtoi Zyren e Planifikimit Financiar te Universitetit Shteteror te Tiranes, gjithashtu drejtoi dhe Zyren e Planifikimit Financiar te Akademise se Shkencave te Republikes se Shqiperise, ku u shqua per nje pune shume korrekte dhe mardhenie te shkelqyera me figura te rendesishme te Arsimit dhe Shkences Shqiptare.

Xhevati ishte nje bir i ralle per prinderit e tij, nje vella dinjitoz por gjithashtu ai ishte nje bashkeshort shembullor per zonjen e tij Zeliha, dhe nje prind model per vajzat e tij Elida dhe Shpresa si dhe djalin e tij Alban.

Me virtutet e ralla te njeriut si urtesia, qetesia, mencuria, paqja, ai diti te ndertoje mardhenie te shkelqyera kudo, ne familjen e tij, me te afermit e tij, si dhe me te gjithe shoket e miqte e rrethit te tij miqesor e shoqeror.

Xhevati le pas nje familje te madhe plot niper, mbesa e sterniper e stermbesa, te cilet nderohen me emrin e nderuar te Xhevat SPAHIUT.

Femijet e tij, bashkeshortja, niper e mbesa, te cilet kane ardhur nga larg sot, te aferm miq e dashamires te tij, ardhur nga Dibra e madhe, Tirana, e familjes Spahiu perkulen me respect sot, per t'i dhene lamtumiren e fundit, njeriut te tyre te dashur dhe shume te shtrenjte Xhevat Spahiu,

Trupi i Xhevatit do te prehet ne varrin e babait te tij te ndritur Muharrem Spahiu.

Shoqata "Bashkesia Dibrane", Komuniteti Dibrane ne Tirane, si dhe "Keshilli i te Urteve" i shprehin ngushellimet e sinqerta familjes Spahiu dhe te aferme te tij.

Shpirti i tij u prehte ne paqen e perjetshme.

Qofte i Xhenetit, qofte per jete i kujtuar.

Lamtumire Xhevati yne i shtrenjte.

Hasan Hoxha, ndihmësmjeku që shëroi mijëra jetë njerëzish

Nga **Destan RAMA**



Me Hasanin jam njohur disa vite më parë, atëherë kur punomin të dy në Fushë-Bulqizë; ai në profesionin e nd/mjekut dhe unë në atë të mësuesit. Edhe sot e kujtoj atë, të veshur me bluzën e bardhë si bora e Malit të Bardhë, që na rrinte mbi kokë gjithmonë deri nga fundmaji i vitit.

Çdo ditë kaloja përpara qendës shëndetësore Fushë-Bulqizë. Dera gjithmonë ishte e hapur. Në të hynin e dilnin njerëz të moshave të ndryshme; burra, gra e fëmijë. Dikush vizitohej, dikush maste tensionin, dikush bënte gjilpanën, dikush mjekonte plagën tek doktor "Hasani". Kështu e thërrisnin pacientët fushëbulqizas, pasi ai ishte njeri i mirë, i sjellshëm, gojëembël, e mbi të gjitha profesionist shumë i mirë. Ashtu siç ma përcaktoi sëmundjen doktor "Hasani", ashtu më thanë edhe në Peshkopi, bile edhe në Tiranë, - shpreheshin të entuziasmuar pacientët. Doktori vinte edhe në shkollën tonë. Kontrollonte nxënësit për higjienën dhe pastërtinë dhe me mjaft takt e fjalë të ëmbla dinte t'i këshillonte ata veçmas se ç'duhet të bënin më tej.....

Hasan Hoxha u lind në fshatin Valikardhë, sot Njësia Administrative Zerqan, rrethi Bulqizë në një familje të varfër me tradita atdhetare. Mësimet e para i mori në vendlindje ndërsa atë 7-vjeçar në Zerqan. I kujton edhe sot me shumë respekt e dashamirësi mësuesit e tij të parë të cilët sa nuk u falnin edhe shpirtin e tyre fisnik, vetëm për tu dhënë dije nxënësve. Si të tillë ai përmend: Hysen Shehun, Ferit Lukun, Aqif Muren, Mehmet Arapin, Erifili Tavanxhiun, Idriz Bibën, Ali Pucën, Riza Novakun, Myslim Bratën, Jeshar Kamberin, Skënder Sharkun etj. Shkollën e mesme e mbaroi në Politeknikumin Mjeksor në Tiranë. Ai kujton se në këtë shkollë kishte rregull e disiplinë të fortë. Mësimin e bënin dy orë teori dhe në vazhdim praktikë në spital. Atje i pritnin pedagogë profesionistë. Ata i vlerësonin me notë si të ishin në klasë. Më 1960 mbaroi shkollën e mesme mjekësore me rezultate të mira dhe u diplomua nd/mjek. Po në këtë vit, në shtator, u emërua nd/mjek në Lokalitetin Klenjë (Dibër). I duhej të mbulonte me shërbim mjekësor dhjetë fshatra. Aty iu desh të përballej me shumë vështirësi, pasi kushtet e punës ishin mjaft të vështira. Dhoma e vogël që quhej "Ambulancë" ishte pa xhama, krevati i vizitës i shkatërruar, pa karrige, një bluzë e bardhë, një çarçaf, një primus për të zier shiringat e gjilpanat dhe asgjë më shumë. Qarkullimi në atë zonë bëhej vetëm me pasaportë e leje kufitare. Mjete transporti nuk kishte. Vetëm tri ditë në jave lëvizte një makinë transporti për pasagjerë. I duhej shpeshherë të lëvizte me këmbë edhe në dimër nga Klenja në Shupenzë, kur shkonte në mbledhje në Peshkopi, por edhe për furnizim me ato pak ilaçe në Shupenzë një herë në muaj. Tipike për atë zone ishte sëmundja e mushkërive dhe bajamet e barku i verës tek femijët. Rastet e urgjencave edhe në atë zonë, si kudo, ishin të pashmangëshme. Ishte dimër. Kishte rënë deri në një metër borë. Në fshatin Sebisht që ishte një ore larg Klenjës, ndodhi një rast djegieje tek një person. Iu desh të shkonte disa ditë atje për ta mjekuar. Me mjekim lokal dhe antibiotikë arriti ta shërojë plotësisht. Fjalët më të mira dhe falenderimet e përzemërta ishin të pafundme për të. Shpiriti i gjallë i atij populli kërkonte shërbim mjekësor dhe ai ndonëse me sakrifica ia dha. Pas një viti punë në Klenjë më 1961 e transferuan në Lokalitetin Selishtë. Edhe këtu thuajse kushtet e punës ishin si në Klenjë. I duhej të përballonte vizitat, injeksionet, vaksinimin plus problemet higjienike dhe epidemiologjike. Këtu ai kujton një rast sëmundjeje që i ka lënë shumë mbresa. Një fëmije 6-vjeçar i ishte bllokuar kanali i urinës. Kishte dhimbje të forta dhe nuk urinonte dot. Rruga për në Peshkopi ishte e bllokuar nga dëbora. Me ilaçe qetësuese, me kompresa të ngrohta dhe me thihje të kalemit ia nxora gurin që ishte sa një kokërr fasule,- tregon Hasani. Nga Selishta transferohet në Fushë-Alie më 1962. Duhejt tu shërbente dhjetë fshatrave. Problemet dhe detyrat ishin të njejta si më sipër. Iu desh të bënte punë sqaruese e bindëse me nxënësit dhe prindërit e tyre për problemet e parazitëve dhe të zgjebes. U largua nga aty më 1963 për në Trebisht me përshtpjet më të mira. NëTtrebisht gjeti disi kushte pak më të mira. Problemet shëndetësore dhe rastet e urgjencave qenë të shumta. Këto ai i përballoi vetëm me punë të palodhshme. Në vitin 1964 e tranfserojne në spitalin e Bulqizes. Këtu ai punoi me mjekun Dilaver Sinani. Fituan shumë nga përvoja e njeri-tjetrit. Kur ai mungonte vizitat në spital i kryente Hasani, ndonëse detyra e tij ishte të furnizonte me ilaçe spitalin dhe të mjekonte pacientët sipas mjekimeve që u jepte mjeku. Më 1968 pasi u kthye nga shërbimi ushtarak filloi punë në qendrën shëndetësore Fushë-Bulqizë. Aty bashkë me të punonte edhe një infermiere mami e cila mbulonte gjithë zonën. Aty ai kryente edhe detyrën e mjekut. Shumë punë u desh të bënin për higjenën e pastërtinë në familje dhe në shkollë. Pas një pune intensive më 1969 transferohet në qendrën shëndetsore të fshatit Peladhi, Këshilli i Bashkuar Zerqan. Shërbimi mjekësor duhej shtrirë në të gjithë fshatrat e Shullanit. Edhe këtu, si kudo, kishte problem të ndyshme, por në sajë të punës së bërë bashkë me kolegët ja arritën qëllimit. Më 1973 e transferuan në spitalin rural Zerqan. E caktuan përgjegjës për vaksinimin e fëmijëve plus punën që bënte në spital. Në tremujorin e fundit të vitit 1974 punoi në qendrën shëndetsore Tërnovë. Më 1975 përsëri e emëruan në qendren shëndetësore Fushë-Bulqizë. Aty u desh ta ndërronin disa herë lokalin derisa u vendos në ndërtesën e re që ndërtoi ferma në Fushë-Bulqizë. Këtu ai punoi me mjekët: Leonard Ceta, Idajet Deda, Aqif Lleshi dhe Maksim Cauli. Më 1984 u transferua në Dispanserinë e rrethit Peshkopi me përgjegjës dr. Laim Pucën. Kishte në patronazh zonën e Zerqanit dhe të Bulqizës. Pas vitit 1987 e emëruan ndihmës mjek në minierën e Bulqizës në zonën e parë dhe në zonën D, për të pritur urgjencat që vinin nga galeritë. Në vitin 1988 e riemëruan në qendrën shëndetësore Fushë-Bulqizë. Aty punoi me mjekun Bardhul Guçe. E caktuan përgjegjës për profilaksinë e sëmundjeve ngjitëse dhe vaskinimin e popullsisë. Me ndryshimet që ndodhën në ato vite në vendin tonë edhe në qendrën shëndetësore Fushë-Bulqizë u larguan dhe erdhën disa mjekë: Astrit Xhemali, Anila Beqiri, Roland Keta, Arian Cani, Shemsi Krashi, Rozeta Shehu. Shpeshherë i duhej atij që të kryente vizitat në vend të mjekëve që vonoheshin për të ardhur në pozicionin e punës. Në Fushë-Bulqizë i mbushi vitet e moshës dhe të punës dhe doli në pension. Të gjitha këto sa sipër unë i mora nga biseda që bëra me Hasanin në një ditë të bukur fundgushti. Ai u emocionua shumë dhe pasi u mbush mirë me frymë tha: "Të faleminderit shumë për interesimin dhe bisedën që bëmë. Sot ti më ke bërë 20 vjet më të ri". Por nuk kishte treguar një të fshehtë, se u kishte shërbyer krejtësisht në mënyrë vullnetare banorëve të fshatit të tij, Valikardhë në çdo kohë. Dhe, që nga viti i daljes në pension vazhdon vizitat në shtëpinë e tij. Kur e pyet për këtë të përgjigjet me një shprehje të bukur: "Tani jam i moshuar, por prap nuk kthej njeri prapë për vizitë". Për meritat që ka treguar ndër vite në punë, në nëntor 2014 në një simpozium në Peshkopi i dhanë një Certifikatë Mirënjohjeje me këtë motivacion: I jepet Z. Hasan Hoxha nga urdhëri i infermierëve të Shqipërisë për kontributin e çmuar , humanizmin dhe vetmohimin e treguar me punën e vet si infermier ndërvite, në shërimin e mijëra jetë njerëzëve Tiranë, nëntor 2014.

Të shkruash për Hasan Hoxhën është pak, pasi nuk i ke thënë të gjitha. Nuk mund t'i përshkruash dot ecejaket e tij në rastet e shumta të urgjencave apo të vaksinimit, në qendrat shëndetsore, a nëpër shtëpi, kudo ku punoi, deri në skajet më të largta të Dibrës, në kohë të mirë, apo edhe të keqe. Dyzet e dy vitet e punës së tij rrezatojnë mund, djersë për shërimin e të sëmurëve pa fund. Gjurmët e punës së tij kanë mbetur prapa në Klenjë, Trebishtë, Selishtë, Fushë-Alie, Fushë-Bulqizë, kudo ku punoi, si udhërrëfyese për brezat në vazhdim...

homazh

Homazh për intelektualin shumëdimensional, profesionistin politeknik, ndër drejtuesit më të aftë të Minierës së kromit

Bujar Pata, 40 vite jetë në minierën e Bulqizës

Nga **Halil RAMA**

Më 10 Dhjetor 2016, familjarët, miqtë dhe të afërmit, përcollën me shumë dhimbje në banesën e fundit, inxhinierin Bujar Pata, një figurë të nderuar të Bulqizës dhe të Dibrës, me një kontribut të madh në zhvillimin e industrisë së kromit. Ai lindi në Peladhi në vitin 1940. Shkollën fillore dhe unike i kreu në Zerqan me rezultate të shkëlqyera, ku dallohej për zgjuarsinë e tij. Shkollën e mesme e kreu në Politeknikumin "7 Nëntori", ku përsëri mbaroi me rezultate të shkëlqyera, degën e minierave. Në Politeknikum e donin Bujarin pasi ishte i urtë, i sjellshëm dhe i dashur me shokët. Ai gjithkujt i bënte respektin që i takonte. Filloi menjëherë punën si teknik miniere në Bulqizë, ku shpalosi çdo ditë aftësitë e tij në kryerjen e detyrave deri në vitin 1965, kur nisi studimet në UT, në Fakultetin e Minierave. Edhe këtu u shqua si student i përkushtuar për të arritur rezultate të shkëlqyera.

Gjithashtu ai kishte marrëdhënie shumë të afërta me shokët studentë dhe me pedagogët që e vlerësonin si një ndër specialistët e rinj që do të jepte kontribut të rëndësishëm në zbatimin e teknologjive të reja në nxjerrjen e mineraleve nga nëntoka. Biri i një familje me tradita e emër të mirë, ku gjenden të kombinuara mençuria, bujaria, fisnikëria e zemërgjerësia, do t'i mishëronte e perfeksiononte ato gjatë gjithë karrierës së tij prej afro pesë dekadash. I porsadiplomuar inxhinier minierash, ai fillon punën në vitin 1970 në Minierën e Kromit në Bulqizë, ku afirmoi veten si specialist rezultativ në personelin inxhiniero-teknik të kësaj ndërmarrje, që në atë kohë ishte bërë miniera më e madhe në Shqipëri. Rezultatet e suksesshme në punë shpejt sollën dhe vlerësime për guximin e rrallë, qëndrimin heroik në frontet më të vështira dhe në kujdesin e mirëmbajtjen e mekanikës së minierës.

Autori i dhjetra projekteve për modernizimin e minierës më të madhe të kromit në vend, drejtuesi i talentuar, miku më i shtrenjtë i minatorëve, nderohej gjithnjë prej tyre. Të tillë do ta portetizonte atë edhe ish bashkëpunëtori e bashkëqytetari i tij, Ing.Hamza Gurra, në librin "Bulqiza, një minierë me histori". Në vitin 1973 Bujar Pata emërohet Kryeinxhinier në Minierën e Kromit në Bulqizë, ku drejtoi për shumë vite. Krahas punës ai ushtroi edhe detyrën e mësuesit të lëndëve profesionale në Shkollën e Mesme të Minierave në Bulqizë.

Gjithashtu ai ishte këshilluesi më i besuar në mbledhjet e personelit inxhiniero-teknik. Fjala e tij dëgjohej me vëmendje në frontet e prodhimit ku haseshin vështirësi të mëdha në zbatimin e rregullave të prodhimit të mineralit në frontet e thella të puseve dhe traverbangjeve të ndërtuara për hapjen e minierës në të gjithë masivin, tashmë të vërtetuar të kromit. Ishte një profesionist politeknik dhe mjaft i thelluar në njohuritë për minierat. Dallohej për projektimin e fronteve të thellësive, në kushtet e infrastrukturës mizerabile të kohës dhe gjithnjë ia dilte të korrte suksese.



KARRIERA NË NGJITJE E NJË INTELEKTUALI SHUMËDIMENSIONAL

Bujar Pata, ky intelektual shumëdimensional do të kishte një karrierë gjithnjë në ngjitje, të admirueshme për kolegët e bashkëpunëtorët e tij të shumtë. Në vitin 1981 emërohet Drejtor i Minierës të Kromit, Bulqizë, por ai mbeti gjithnjë ashtu, i thjeshtë e i dashur me shokët dhe llogjik në trajtimin e problemeve deri në zgjidhjen e plotë të tyre. Në këto vite u rrit me shpejtësi mekanizimi e modernizimi i minierës duke zbatuar teknollogji që i përgjigjeshin realizimit të planit të prodhimit e të kërkimit dhe futjes në funksion të fronteve të reja të nxjerrjes së kromit. Në këtë minierë u hapën rreth 18 km galeri, puse, furnele e rampa dhe u nxorrën rreth 20 milion ton krom, duke qenë një faktor i rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë. Në vitin 1984, Bujarin e emërojnë Sekretar të Parë të Komitetit të Partisë së Rajonit të Bulqizës. Edhe këtu ai ruajti po ato tipare të thjeshtësisë e të komunikimit me drejtues, minatorë e qytetarë me të cilët qante hallet e tyre të punës e të jetës. Pas një viti përsëri kthehet kryeinxhinier në minierë, ku shifrat e realizimit të planit të prodhimit kishin arritur në nivelin e një përgjegjësie të jashtëzakonshme. Në vitin 1989 Bujari emrohet Sekretar i Komitetit të Partisë të rrethit Dibër. Në këtë kohë ai pati edhe probleme shëndetësore me zemrën që i kaloi me sukses. Në mars 1991, në Kuvendin e parë pluralist, B.Pata zgjidhet deputet deri në marsin e vitit 1992. Aty ai dha kontributin e tij në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë. Pas vitit 1992 filloi punë përsëri në minierën e Bulqizës në repartin e cilësisë. Nga viti 1998 deri 2001 kur doli në pension punoi specialist në Albkrom në Tiranë.

40 VITE KONTRIBUT SI SPECIALIST DHE DREJTUES I MINIERËS

Në vitin 2003 Bujar Pata ngre zërin e tij në shtyp për gjendjen e gjigantit të kromit të Bulqizës, ku paralajmëron vështirësitë e mëdha që sjell keqmenaxhimi i kësaj miniere. Larg klisheve e slloganeve përçarëse, edhe në këto vite ai iu përkushtua profesionit, duke bërë më të mirën e mundshme. Bujari, një profesionist politeknik dhe mjaft i thelluar në njohuritë për minierat, mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha. Kështu vlerësohet kontributi i tij si specialist dhe drejtues për 40 vite, ku mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha. Gjithmonë ishte një burrë me shpirt të jashtzakonshëm, simbol i nëpunësit të drejtë e të përkushtuar, inxhinieri pasionant i minierave të kromit shqiptar, njeriu shumë i dashur për të gjithë minatorët dhe popullin e Bulqizës dhe një vlerë e vërtetë e qytetarisë. Bujar Pata ishte mjaft dinamik, në lëvizje e kërkim të pasosur njohurish dhe vlerash. Ai ishte shumë i lidhur me punën dhe mjaft i shoqëruesheëm; lexonte e shkruante, fliste bukur në kuvende, takime e festa. Në bibliotekën familjare i gjeje të gjitha librat shqip të kohës si dhe koleksionet me revistat përparimtare. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, në vitin 2005 i dha inxhinierit Bujar Pata titullin "Qytetar Nderi" për kontributin e tij në 40 vite si specialist dhe drejtues, që mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha për ecurinë e prodhimit të mineralit të kromit në minierën e Bulqizës. Gjithë ky aktivitet i dendur e mjaft produktiv i një personaliteti me përmasa shumëdimensionale si Bujar Pata, na bën të hulumtojmë më shumë rreth jetës dhe produktit që ai lë pas, në të mirë të shoqërisë dhe të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të Bulqizës dhe krejt Dibrës. Në realitetin e kohës që jetoi Bujar Pata përpiqej gjithnjë të ishte në harmoni me vetveten dhe ky ka qenë orientimi më i mirë i tij, orientim drejt lirisë së qënies dhe gjykimit të pandikuar. Pikërisht një orientim i tillë do ta çonte atë në kufijtë maksimalë të cilësimit si një individ i veçantë.

PROMOVUES I VLERAVE QYTETARE

Bujar Pata kultivoi dhe promovoi vlera qytetare, që në etapa dhe forma të ndryshme, në ecjen e njerëzve me kohën e për kohën, nëpërmjet kontributit të tyre modest dhe historik, kanë komunikuar dhe vazhdojnë të komunikojnë, mesazhe modeste e komplekse, dialogimin e së kaluarës, qartësinë e së tashmes dhe udhën e së ardhmes; ndjenja të shpallura këto, për të kuptuar vazhdimësinë e jetës, krenarisë, dhe përjetësisë..., vlera që sigurojnë identitetin e qytetarisë dhe inteligjencës dibrane. ...Lajmi i trishtë se një nga personalitetet më të shquara dibrane, Bujar Pata, u nda nga jeta, u prit me dhimbje e dëshpërim të thellë nga familja, bashkëshortja e fëmijët, nga të afërmit dhe miqtë e shumtë, jo vetëm në Bulqizë e Dibër, por në gjithë Shqipërinë, veçmas nga ata që kanë patur fatin ta njohin, ta kenë mik dhe koleg. Ata shprehën ngushëllimet dhe dhimbjen e tyre në rrjetet sociale e shtypin shqiptar. Në një bisedë ngushëlluese telefonike që pata me djalin e tij, mikun e kolegun shembullor, gazetarin e talentuar, Ylli Pata, përpos kërshërisë sime për të ditur më shumë rreth babait të tij, ndjeva dhimbjen e thellë, respektin dhe një moment homazhi, malli, mungese, dhimbje, dashurie dhe admirimi, për njeriun që e pati pjesë të jetës së tij për 40 vjet, duke e vlerësuar edhe si një tribun promovues dhe përcjellës të vlerave njerëzore dhe qytetare. Me ndarjen e tij nga jeta, Bulqiza humbi një inxhinier të talentuar e qytetar shembullor, familja e shoqëria ndahen me të shtrenjtin e tyre. U prehtë në paqe shoku dhe miku ynë i paharruar Bujar Pata. Dheu qoftë i lehtë për të !

(Marrë nga FB/halilrama)

NEKROLOGJI

Ndahet nga jeta Profesor Doktor Agim Tërshana

Më 30 nëntor të vitit 2016 u nda nga jeta njeri nga specialistët më të mirë të Institutit të Studimeve e Projektimeve të Gjeologjisë në Tiranë, Profesor Doktor Agim Tërshana.

Agimi ka lindur në Tiranë më 21 shkurt të vitit 1933 nga familja e shquar intelektuale, arsimdashëse e me tradita patriotike e Tërshanave të Dibrës. Arsimin unik e të mesëm në ish Politeknikumi "7 Nëntori" i kreu me rezultate të larta në Tiranë. Në vitin 1959 mbaroi arsimin e lartë në Universitetin e Tiranës ku u diplomua si inxhinjer gjeolog i specializuar për petrograf. Pas mbarimit të shkollës së lartë ka punuar në Ndërmarjem Minerare të Rubikut, në Muzeun e Shkencave të Natyrës dhe në Laboratorin e Komitetit Shtetëror të Gjeologjisë, në Institutin e kërkimeve Gjeologjike në Tiranë, në Ndërmarjen Gjeologjike të Pukës dhe në 15 vitet e fundit në Institutin e Studimeve e Projektimeve të Gjeologjisë deri kur doli në pension në vitin 1994. Gjatë punës së tij 35 vjeçare ka kryer si autor kryesor e bashkëautor mbi 55 projekte, relacione, raporte e studime gjeologjike si dhe ka botuar mbi 37 artikuj, referate e kumtesa në Buletinin e Shkencave Gjeologjike e Buletine të tjerë jashtë vendit. Ka marrë pjesë në shumë aktivitete shkencore brenda e jashtë shtetit ku dhe ka referuar për Petrologjinë dhe metalogjeninë e masivit gabror-peridotitik të Lovrushkut, për lëndët e para zjarrduruese (magnezit e kaolinë) në rajonin e Pukës dhe për shumë minerale të tjerë të dobishëm metalorë e jo metalorë të vendit tonë.

Në vitin 1982 mbrojti disertacionin "Petrologjia dhe metalogjenia e kompleksit gabro-peridotit të rajonit Kashnjet-Qelëz" me të cilën fitoi gradën Kandidat i Shkencave (Doktor). Ka marrë pjesë në koferenca shkencore brenda e jashtë vendit si në Bullgari, Itali, Austri, Turqi, etj. Në vitin 1995 fiton titullin Profesor Doktor (Drejtues Kërkimesh). Për shumë vite deri kur doli në pension ka punuar si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minjerave në Tiranë. Është autor i librit "Vendburimet e mineraleve të dobishme jo metalore dhe kërkimi i tyre" i ribotuar në vitin 2012.

Në sajë të kualifikimit të lartë të tij si shkencëtar në fushën e gjeologjisë ai ka udhëhequr mjaft diplomantë në shkollën e lartë e disertantë në kualifikimin shkencor pas universitar si dhe ka marrë pjesë në komisionet e dhënjes së këtyre diplomave dhe gradave e titujve shkencorë.

Ai ishte edhe një aktivist i dalluar shoqëror. Si anëtar i kryesisë së shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, në fundin e viteve 90-të e fillimin e viteve 2000, së bashku me mikun e bashkëpunëtorin e tij të ngushtë, ish kryetarin e kësaj shoqate, intelektualin e personalitetin e shquar dibran Feti Borova, shtuan rradhët e kësaj shoqate me dibranë nga të gjitha krahinat e Dibrës. Ai ishte i urtë, i zgjuar, i drejtë, ishte modeli i familjarit, mikut e shokut shumë të mirë.



Ai ishte edhe një aktivist i dalluar shoqëror. Si anëtar i kryesisë së shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, në fundin e viteve 90-të e fillimin e viteve 2000, së bashku me mikun e bashkëpunëtorin e tij të ngushtë, ish kryetarin e kësaj shoqate, intelektualin e personalitetin e shquar dibran Feti Borova, shtuan rradhët e kësaj shoqate me dibranë nga të gjitha krahinat e Dibrës. Ai ishte i urtë, i zgjuar, i drejtë, ishte modeli i familjarit, mikut e shokut shumë të mirë.

Profesor Doktor Agim Tërshana është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Medalje pune në vitin 1962 dhe me Urdhërin e Punës së Klasit të II-të në vitin 1990. Gjithashtu është vlerësuar me Medalje Nderi të Argjendtë nga Qendra Ndërkombëtare Biografike (IBC) në Kembrixh, Angli, për arritjet e tij si një Intelektual i shquar i shekullit të XX-të.

Me ndarjen nga jeta të Profesor Agim Tërshanës, familja humbi njeriun e tyre më të shtrenjtë, ndësa ne kolegët e gjeologjisë një nga bashkëpunëtorët më të mirë si dhe një nga shkencëtarët më të shquar të kësaj fushe.

Bashkim Lleshi , Aleks Vranai, Andon Grazhdani, Afat Serjani, Tonin Deda, Ilir Alliu,Vesel Hoxha, Xhemal Hadroj, Naim Karaj

Rruga e Arbërit

Aty ku fjalët nuk i merr era!

+5° C — Hi: +5° Lo: 0° — Peshkopi — Friday, 16 December — See 7-Day Forecast

Sat	Sun	Mon	Tue	Wed	Thu
+1° -7°	+5° -7°	+3° -8°	0° -7°	-5° -12°	-9° -15°

KRYESORE | AKTUALITET | OPINION | INTERVISTA | KULTURE | ARKIVA NE PDF | PETICIONI | PAJTOHU / NDIHMO EDHE TI

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për këtë website:
info@rrugaearberit.com
Informacioni për gazetën:
rrugaearberit@gmail.com
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.
Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës. Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky website është komplet një kontribut (donacion) në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

© Copyright Rrugaearberit.com & Gazeta "Rruga e Arbërit". Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare

Nga Gëzim Alpion Më datë 28 tetor 2016, nga një lajm i revistës Monitor1, dhe më pas nga disa media »





NUMRI I RI



Shtyp foton për versionin në pdf ose abonou për versioni print.

GAZETA

Gazetën mund ta gjeni në pikat kryesore të shitjes në Tiranë, Durrës, Fushë Krujë, Elbasan, Shkodër, Burrel, Klos, Bulqizë, Peshkopi dhe Dibër të

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kadriu, Ahmet Përlat, Albana Vata, Albert Zholi, Aleksandër Cipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Andi Balla, Andon Andoni, Andrea Dhrami, Andrea Qirjazi, Andrea Qorri, Andrea Xhaxho, Arbër Lleshi, Ardian Reçi, Ardit Selami, Ardita Abdiu, Aria Sukniqi, Arian Avrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tollja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Axel Alcani, Axel Kronholm, Bajtar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Dervishi, **Bashkim Lleshi**, Bedri Rama, Bedri Tahiri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Kërluku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Pllloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zaçe, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejanq Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimitër Beqiri, Dhimitër Kosta, **Dionis Xhafa**, Donita Tafa, Dritan Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylber Reçi, Edmir Sinoti - Qendrimi, Edmond Basha, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Engjëll Musai, Enver Halili, Ermal Hoxha, Ermir Kaloshi, Ermir Rraba, Eralda Sharra, Erion Sadiu, Ermir Dizdari, Ermir Hoxha, Ermira Kurjai, Esmir Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Kosta, Evi Baci, Evi Laçe, Evi Mema, Fadil Kraja, Fadil Sadiku, Fadil Shaba, Fahri Xharra, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hajri Mandri, Hajri Shehu, Hajrush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përmeza, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hagji Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Lleshi, Hiqmet Kamberi, **Hysen Likdisha**, Hysen Mehmeti, **Hysen Uka**, Ibrahim Kaçupi, Ibrahim Kamberasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sukuçi, Iljaz Boba, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Çipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgji Dajti, Jozefer Frashëri, Kadri Kozeli, Kadri Kozeli, Kamber Golloguzhi, Kasto Zhulali, Kastriot Kosta, Kastriot Kujtim Qafmolla, Kastriot Sharra, Kastriot Hoxha, Kastriot Uka, Kastriot Sharra, Kastriot Uka, Kastriot Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Janguli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Meral Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Hysa, Mimoza Hysa, Mimoza Yzeiri, **Miranda Goleci**, Mirvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nikoll Kaçorri, Nikolla Mucaj, Nikolla Tola, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Petraq Anastasi, Petraq Papajorgji, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Rasim Totraku, Resul Bendo, Rexhep Dedaj, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezeshana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reci, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Kraja, Rrok Reçi, Rrok Reçi, Rrok Reçi, Rrok Reçi, Sabah Kraja, Sabah Kraja, Sabah Kraja, Sabah Kraja, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, **Shaqir Skarra**, Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shpëtim Luçi, Shpëtim Pepa, Shpëtim Tafa, Shpëtim Tafa, Shpëtim Taf